RAPORTI PËRFUNDIMTAR

Auditim Financiar

Tiranë, tetor 2026

PËRMBAJTJA		Faqe
I.	**PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE**	3-3
1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	3-3
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-6
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	7-8
II.	**HYRJA**	9
1	Objektivat dhe qëllimi	9
2	Identifikimi i çështjes	9
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9-10
4	Përgjegjësitë e audituesve	10-11
5	Kriteret e Vlerësimit	11
6	Standartet e auditimit	11
7	Metodat e auditimit	12
8	Dokumentimi i auditimit	13
III.	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	14-129
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	14
2	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	14
3.1	Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	15-26
3.2	Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	26-37
3.3	Auditim mbi të ardhurat	37-57
3.4	Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025	57-112
3.5	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	112-129
IV.	**REKOMANDIME**	129-143

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ka kryer auditimin financiar në Bashkinë Dropull, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aspekteve të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit vendor, mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit e miratimit të pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore, dokumentimit të transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në kontabilitetin e bashkisë, sigurimit të të ardhurave vendore dhe zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi mbi këto drejtim etj..

Nga auditimi konstatohet se për vitin 2025 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 300,646 mijë lekë buxheti i rishikuar ka vlerën 372,729 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 259,851 mijë lekë ose në masën 69,7%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 187,793.98 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 172,446 mijë lekë ose në masën 91,8% . Zëri shpenzime operative (602) dhe Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën 70,076. mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 48,658 mijë lekë ose në masën 69,4%. Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 (artikulli 230-231) është planifikuar në vlerën 99,328.88 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 27,808 mijë lekë me një mosrealizim të këtyre fondeve prej - 112,878 mijë lekë, ose realizimi në nivelin 69,7%

Gjatë periudhës së auditimit nga data 10.04.2025 deri në datë 22.05.2025, në subjektin Bashkia Dropull, për periudhën objekt auditimi financiar nga data 01.01.2025 deri në 31.12.2025,

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 5 (pesë) akt-konstatime të cilat janë protokolluar në subjekt me 22.05.2025. Nga subjekti i audituar, nuk janë paraqitur observacionet mbi akt konstatimet e depozituara zyrtarisht në subjektin e audittuar.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" nenit 50 "Auditi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjorë".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Dropull si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

b. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimet e auditimit të tij:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi veprimtarinë financiare të Bashkisë me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Dropull. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.*

- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
-Auditim mbi burimin e krijimit të të ardhurave.
-Auditim mbi pasqyrat financiare të vitit 2025.
-Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

c. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.
Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar transaksionet e likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme.

d.Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:
Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej dreitimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 20 gjetje dhe ka dhënë 21 rekomandime.

e. Paraqitja e gjetjeve kryesore.
Nga auditimi i programeve buxhetore rezultoi se, nga 20 programe buxhetore të miratuara nga Ministria e Financave për përgatitjen e PBA 2025-2027, ka disa programet buxhetore të lidhura me 6 (gjashtë) funksione/nënfunksione të cilat nga ana e Bashkisë Dropull nuk janë marrë në konsideratë dhe nuk janë parashikuar fonde në buxhet, si p.sh për: funksionin/nënfunksionin nr. 23/1; 23/2; 23/3; 27/3; 27/4 dhe 28/6, të lidhura me funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike si dhe në fushën e zhvillimit ekonomik vendor, etj. Sa më sipër, në moszbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 7, datë 25.05.2022 "*Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018* "*Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*" shtojca 1 dhe Udhëzimit të MF nr.3, datë 28.02.2024 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027"*, (shtojca 4).
-Regjistrat për Taksat dhe Tarifat për çdo NJA dhe fshat, ku janë përfshirë listat e tatimpaguesve dhe detyrimet sipas kategorive të tatimeve nuk janë protokolluar dhe arkivuar në momentin e mbylljes së vitit ushtrimor dhe para hapjes së regjistrit të vitit pasardhës. Nuk është dokumentuar me procesverbal niveli i detyrimeve të papaguara për taksat dhe tarifat vendore sipas kategorive, në datën 31.12.2025.
-Procesi i popullimit të Regjistrit Elektronik të tatimpaguesve dhe procesi i përpunimit dhe përgatitjes së evidencave kryhet nga të njëjtët përdorues, në mungesë të ndarjes së aktiviteteve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar dhe Manualit të MFK.
- Rregullorja e brendshme për krijimin, mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit elektronik të tatimpaguesve vendorë të Bashkisë Dropull, është miratuar në fund të vitit 2025, dhe nuk ka parashikuar kriteret dhe aspektet e gjenerimit/printimit e arkivimit të të dhënave periodike e vjetore; afatet dhe mënyrën e rakordimit të të dhënave të këtij regjistri me strukturat e brendshme e të jashtme dhe mënyrën e dokumentimit të çdo përditësimi të të dhënave, në funksion të saktësisë dhe ruajtjes së gjurmës së auditimit në këtë institucion të vetëqeverisjes vendore.
- Nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e saktësisë së procesit të popullimit të regjistrit elektronik, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga ky regjistër në evidencat format *Microsoft Excel* për njoftim detyrimi drejtuar tatimpaguesve, raportime midis drejtorive apo për titullarin e Bashkisë.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi realizimin e të ardhurave (taksa e tarifa vendore), për periudhën objekt auditimi, 01.01.2025 deri më 31.12.2025, rezulton se për vitin 2025, planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 71,513 mijë lekë dhe niveli i realizimit është në vlerën 66,969 mijë lekë, ose 94 %, me një diferencë mosrealizim të të ardhurave gjithsej kundrejt planifikimit të tyre në buxhetin vendor në vlerën - **4,544 mijë lekë.** Nga auditimi rezulton:
-Treguesi i miratuar i planit vjetor të vitit 2025 është programuar dhe miratuar më i ulët sesa plani i një viti më parë (2024), në shumën -9,290 mijë lekë, ose 11%;
-Treguesi i realizimit të planit vjetor të vitit 2025 rezulton më i ulët sesa realizimi i të ardhurave i një viti më parë (2024) me diferencë -10,755mijë lekë, ose 14%;
-Niveli i realizimit të të ardhurave faktike ndaj planit vjetor të vitit 2025 është 94 %, nga 96 % që është niveli i realizimit të tyre për vitin paraardhës, (ose 2% më i ulët sesa raporti fakt / plani për të ardhurat e vitit 2024).
- Rregullorja e brendshme nuk përshkruan në mënyrë të plotë proceset kryesore të punës, rrjedhën e tyre, raportimin dhe vendimmarrjen;
-Për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës bazuar në "Kodin punës" nuk janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë, mënyra apo kriteret e rekrutimit/largimit për çdo pozicion.
-Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me Vendimin nr.1 datë 19.01.2025 e Kryetarit të Bashkisë, por nuk është hartuar një rregullore për funksionimin e tij.
-Nga ana strukturave përgjegjëse nuk është hartuar dhe miratuar një udhëzim i brendshëm për monitorimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe mungon një plan veprimi i MFK-së për të monitoruar realizimin e objektivave të institucionit.
-Nuk ka një strategji të miratuar të menaxhimit të riskut apo identifikim të tij, sipas nenit 21 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 16, dt. 31.12.2024 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e grupit të menaxhimit të risqeve në njësitë publike".
Mjedisi i kontrollit nuk ka përfshirë rregulla dhe procedura të qarta, dhe si pasojë aktivitetet e kontrollit rezultojnë të pamjaftueshme për të siguruar funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
-Mungojnë politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, të cilat përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA, stafit menaxherial dhe punonjësve të këtij institucioni
Nga auditimi mbi vlerësimin e procesit të rakordimit dhe përputhjes së të dhënave të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënës Vjetore (PFV) të hartuara nga ana e njësisë shpenzuese Bashkia Dropull e të dorëzuara zyrtarisht në Degën e Thesarit, me të dhënat e Pasqyrave Financiare të gjeneruara nga Ministria e Financave në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë *(SIFQ),* kanë rezultuar disa mospërputhje, si vijon:

- ✓ Shuma e aktiveve neto sipas PFV për *vitin 2024* në Pasqyrat Financiare të Bashkisë Dropull është 1,809,695,277 lekë, kurse sipas SIFQ vlera e aktiveve neto/fondeve neto rezulton 1,733,257,367 lekë. Diferenca e pa kuadruar, pasi hiqet vlera e llogarisë 520 "*Disponibilitete në thesar*" është 10,051,918 lekë.
- ✓ Shuma e aktiveve neto sipas PFV për *vitin 2025* në Pasqyrat Financiare të Bashkisë Dropull është 1,983,732,908 lekë, kurse sipas SIFQ vlera e aktiveve neto/fondeve neto rezulton 1,843,225,491 lekë. Diferenca e pa kuadruar, pasi hiqet vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" është 23,009,929 lekë.
- ✓ Nga krahasimi i të dhënave të pasqyrave financiare të ngarkuara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) rezultoi se, në të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara

me nr. 744 prot, datë 22.04.2026, ekzistojnë mospërputhje të tepricës së llogarive për 7 (shtatë) llogari kontabile, pjesë e PFV të dorëzuara zyrtarisht nga ana e Bashkisë Dropull në Degën e Thesarit Gjirokastër sipas shkresës nr. 744, datë 22.04.2026, për një diferencë prej 43,081,918 lekë, pasi hiqet teprica e llogarisë 520.

- ✓ Nga auditimi mbi informacionin shpjegues pasqyruar në Formatin nr. 5 të Pasqyrave Financiare Vjetore, "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, viti 2025", në rubrikën "*Diferenca midis pasqyrave financiare të njësisë raportuese dhe PF të gjeneruara nga Ministria e Financave në SIFQ",* nuk ka asnjë shënim mbi këto diferenca të rezultuara.

Sa më sipër, veprime në kundërshtim me përcaktimet e pikës 14, Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ", të Udhëzimit të MFE nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar si dhe pikën 10, të UMF nr.127, datë 19.12.2025 "Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025", që përcakton se "*Të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara duhet të jenë të njëjta me të dhënat e gjeneruara nga SIFQ", etj.*

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Kryetari i Bashkisë Dropull, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa për përmirësimi e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me qëllim funksionimin e tyre dhe plotësimin me aktet e nevojshme dhe të merren masa për;

- ✓ Hartimin e planeve operacionale të konsoliduar të punës, me tregues performancë, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
- ✓ Përditësimin e regjistrit të konsoliduar të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.
- ✓ Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike.

Monitorimin e vazhdueshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

Bashkia Dropull, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa për zbatimin e një procesi të detyrueshëm rakordimi dhe verifikimi paraprak të Pasqyrave Financiare Vjetore me të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), duke siguruar që të dhënat e raportuara të jenë të njëjta, si dhe analizimin, dokumentimin dhe korrigjimin e të gjitha diferencave të konstatuara para protokollimit dhe depozitimit të tyre në Degën e Thesarit, krahas pasqyrimit të këtyre diferencave nëse ato ekzistojnë, në Formatin nr. 5 "Pyetësor dhe shënime shpjeguese", të Pasqyrave Financiare Vjetore.

Titullari i Bashkisë Dropull, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të marrë masat për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Pronave Publike Vendore dhe të Rregullores për Menaxhimin e Aktiveve, si dokumente bazë për administrimin, mbrojtjen, inventarizimin, vlerësimin dhe përdorimin me efektivitet të aktiveve publike të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Strategjia për Menaxhimin e Pronave Publike Vendore të miratohet nga Këshilli i Bashkisë Dropull me qëllim forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe garantimin e një menaxhimi efektiv, ekonomik dhe transparent të aktiveve vendore.

Bashkia Dropull të standardizojë dhe dokumentojë procesin e inventarizimit të aktiveve, duke siguruar zbatimin e të gjitha fazave të tij *(inventarizim, vlerësim, rakordim, nxjerrje jashtë përdorimit dhe asgjësim),* si dhe të vendosë mekanizma monitorimi për administrimin e dokumentacionit financiar të entiteteve ku Bashkia zotëron pjesëmarrje. Në këtë kuadër, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të Bashkisë Dropull, të marrin masa për ngritjen e komisionit për vlerësimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të dëmtuara

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Opinion mbi auditimin financiar[1]: *i kualifikuar*
Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Dropull, për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të fluksit të mjeteve monetare (cash flow), të ndryshimit të aktiveve neto/flukseve neto dhe shënimet shpjeguese.
Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:
Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe d*ëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit,* nga auditimi në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Dropull kemi arritur në përfundimin se janë evidentuar disa raste të mospërputhshmërisë apo *devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi*, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë *materiale, por jo të përhap*ura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të ***kualifikuar, modifikuar***[2], e shprehur kjo sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Baza për opinionin:
Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*", pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI- P1, "Deklarata e Limës", INTOSAI -P10 "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe ISSAI 130 - Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Përshkrimi i çështjeve kryesore:
Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit të llogaritur nga

[1] - Mbështetur në ligjin nr. 154/2014 "Për organizmin dhe funksionimin e KLSH-së".
[2] - Sipas Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së miratuar me Vendimin nr. 246, datë 19.12.2022 të Kryetarit te KLSH-së, Kapitulli VII, pika 4.2, (fq 54, 60-61): "Opinioni i modifikuar" do të jepet në rastet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;

audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së që për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 është: për shpenzimet 4,665 mijë lekë dhe për të ardhurat 989 mijë lekë si dhe mangësitë/ anomalitë e mëposhtme:

- Nga auditimi mbi vlerësimin e procesit të rakordimit dhe përputhjes së të dhënave të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënës Vjetore (PFV) të hartuara nga ana e njësisë shpenzuese Bashkia Dropull e të dorëzuara zyrtarisht në Degën e Thesarit, me të dhënat e Pasqyrave Financiare të gjeneruara nga Ministria e Financave në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë *(SIFQ)*, kanë rezultuar disa mospërputhje për një diferencë prej 43,081,918 lekë,

-Nga auditimi i gjendjes së e llogarisë 210 *"Toka, troje, terrene"* rezulton se nuk është përfshirë vlera e truallit të aktiveve afatgjata materiale *(llog.212)* në pronësi të Bashkisë Dropull me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari.

-Në llog. *210 "Toka, troje, terrene*, llog. 211*"Pyje, kullota, plantacione"* , llog. 212 "*Ndërtesa dhe Konstruksione*" *dhe llog. 213* "*Rrugë, rrjete, vepra ujore",* nuk janë përfshirë asetet e transferuara me VKM për Bashkinë Dropull, pasi procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie janë të papërfunduara nga ASHK dhe nuk është bërë rivlerësimi i atyre të pajisura me titull pronësie.

-Nga auditimi i gjendjes së llogarisë 212 "*Ndërtesa dhe Konstruksione*" (kosto historike) u konstatua se Bashkia Dropull ka të evidentuar objekte të cilat janë të pa analizuara.

-Nga auditimi i llogarive të Klasës 20-të, *"Aktivet afatgjata materiale"* rezultoi se Llogaria 211 *"Pyje, kullota, plantacione"* në datën 01.01.2025, është kontabilzuar në vlerën 0 lekë me vlerë neto. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime dhe gjendja kontabël sipas kostos historike e kësaj llogarie më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën zero lekë.

- Bashkia Dropull ka në administrim 1 (një) banesë të llojit *apartament*, me numër pasurie 3/58+3-1 dhe numër hipotekimi 603069, regjistruar në ZK 3833, por që nuk rezulton i kontabilizuar në llogarinë 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* dhe nuk janë përfshirë në Regjistrin e Aktiveve të kësaj Bashkie.

- Nga auditimi i gjendjes së llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore"* rezultojnë 6 objekte në vlerën 932,669,760 lekë, të cilat janë asete të Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër. Nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat për transferimin e aseteve të ujësjellësit sipas kostos historike, në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022.

- Nuk ka gjetur zbatim rekomandimi për saktësimin e vlerës së llogarisë 26 mbi aktivet financiare me pjesëmarrje, me ndikim në saktësinë e informacionit kontabël.

- Nga auditimi i dokumentacionit të llogarisë 466 *"Kreditorë për mjetet në ruajtje*", rezulton se për 13 (trembëdhjetë) objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Dropull janë ngurtësuar fonde në vlerën 4,569,489 lekë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit

- Vlera neto totale e aktiveve në dokumentin "*Regjistri i Aktiveve"* nuk përputhet me vlerën neto të aktiveve në Pasqyrat Financiare të Llogaridhënies Vjetore (Formati 7/b) me datën 31.12.2025. Regjistri i Aktiveve i vitit 2025 nuk ka përfshirë të gjithë zërat e aktiveve afatgjata materiale, jomateriale, llogaritë e pjesëmarrjes në kapital dhe afatshkurtra, si dhe nuk është i plotësuar sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë përgjegjëse për financat.

- Sistemi i kontrollit të brendshëm në Bashkinë Dropull vlerësohet *pjesërisht efektiv*, pasi komponentët e MFK-së nuk funksionojnë plotësisht.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH"*, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. nr. 376/1 prot., datë 09.04.2026 *"Auditim Financiar në Bashkinë* Dropull*"*, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 10.04.2026 – 22.05.2026, në subjektin Bashkia Dropull u krye "*Auditim Financiar*" për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2025 - 31.12.2025, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Q.C, *përgjegjës grupi*
2. I.U, *auditues*
3. V.K, *auditues*

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Auditimi Financiar në Bashkinë Dropull kishte si objektiva kryesore: - Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij; - Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315); - Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Dropull është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

2. Identifikimi i çështjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Dropull, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Dropull.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Dropull janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Kryetari i Bashkisë Dropull *(Administratori i Përgjithshëm),* në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës dhe Buxhetit, në cilësisë *e Nëpunësit Zbatues* (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Dropull, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3. *Ato janë përgjegjës për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret ligjore duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kuadrin rregullues mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiar* të llogaridhënies vjetore; ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Dropull në raport me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI (sipas INOTSAI), të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar Parimet e Auditimit Financiar; kërkesat Etike dhe pavarësinë, Kontrollin e Cilësisë, Menaxhimin e grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, etj.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Dropull është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH-së kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafët 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera si dhe kritere përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

-Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 "*Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit*".

- Ligji nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore";*
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar*;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;*
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë",* i ndryshuar*;*
- Ligji nr. 152-2013, "*Për nëpunësin civil",* i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar*;*
- Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 *"Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë",* i ndryshuar
- VKM nr.500 datë 14.08.2001 *"Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendor"*
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*;
-VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", me ndryshime*;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore",* i ndryshuar;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar*;*
- Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 "*Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike"*
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar,
-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.127, datë 19.12.2025 "*Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025"*,
-UMF nr. 2, datë 27.09.2019 "*Procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore*".
-Udhëzimi nr. 5, datë 27.02.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", i ndryshuar;
-Udhëzimi nr. 1, datë 04.06.2021 "*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit*";
-Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar;
-Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
-Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut, etj.

6. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

- INTOSAI P1- Deklarata e Limës me udhëzuesit për kryerjen e auditimit.
- ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*" .
- ISSAI 1300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*";
- ISSAI 200 "*Parimet e auditimit financiar*" dhe
- ISSAI 2000-2200 "Aplikimi i stadardeve te auditimit financiar"
- ISSAI 1000-2999 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*";
- INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*" si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilisteve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*".
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Rregullore e brendshme *"Mbi procedurat e auditimit në KLSH"*;
- Rregullore e brendshme "*Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së"*;

7. Metodat e auditimit*:*

Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me evidence dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Sa më sipër, audituesit kanë aplikuar auditim *i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje, mbi bazën e riskut të vlerësuar.* Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, janë marrë në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe - Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Nga ana e grupit të auditimit auditohen procedurat, mbi këto aspekte si më poshtë:

- *Kontrolli aritmetik.*

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë gabime. *(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)*

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.*

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të Udhëzimi i MF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.*

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse,

por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

- *Kontrolli i vlerësimit.*

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.*

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- *Kontrolli sipas një treguesi*.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales",* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- Intervista

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Dropull me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

- *Raporte dhe Informacione*

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

- Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të 17 influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja . Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose ne trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mirë informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar dhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, me ndryshimet. Gjithashtu, është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", duka administruar dokumentacion të mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar

natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit si dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve.
Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

- Sipas shkresës së KLSH-së me nr.376/2 prot., datë 25.06.2026, në subjektin e auditimit Bashkia Dropull është dërguar Projekt Raporti i auditimit.
- Bashkia Dropull nuk ka përcjellë pranë KLSH-së komente, shpjegime apo observacione *(në formë shkresore dhe elektronike)* mbi Projekt-Raportin e Auditimit brenda afatit 1-mujor nga data e marrjes në dorëzim nga personat përgjegjës, referuar parashikimeve të neneve 26 dhe 29, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".* Për rrjedhojë, në mungesë të reagimit zyrtar brenda afatit ligjor të përcaktuar, Projekt-Raporti i hartuar është konsideruar i mirëqenë dhe mbi këtë bazë është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit.

II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

2.1. Informacioni i Përgjithshëm:

Auditimi në subjektin "Bashkia Dropull", u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t'u audituar.
Bashkia Dropull është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore".

Profili i Bashkisë Dropull[3]

Bashkia Dropull ndodhet në Qarkun e Gjirokastrës dhe shtrihet në pjesën juglindore të vendit, në një sipërfaqe prej 466.67 km² me një densitet prej 48.61 banorë/km². Ajo përbëhet nga 3 njësi administrative, të cilat janë: Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm dhe Pogon. Bashkia ka nën administrimin e saj 41 fshatra: Dropull i Poshtëm me 16 fshatra, Dropull i Sipërm me 18 fshatra dhe Pogoni me 7 fshatra.



Nr.	NJA	Qytete dhe Fshatrat në përbërje
1	Dropull i Poshtëm	*Dervican, Goranxi, Vanistër, Haskovë, Dhuvjan, Sofratikë, Terihat, Goricë, Frashtan, Lugar, Grapsh, Peshkëpi e Sipërme, Peshkëpi e Poshtme, Glinë, Vrahogoranxi, Radat*
2	Dropull i Sipërm	*Jorgucat, Zervat, Bularat, Bodrishtë, Kërrë, Vodhinë, Pepel, Klishar, Selo, Likomil, Llovinë, Krioner, Sotirë, Llongo, Koshovicë, Dritë, Kakavie, Vrisera*
3	Pogon	*Poliçan, Skore, Sopik, Çatistër, Mavrojer, Hllomo, Selckë*

[3] http://bashkiteforta.al/ëp-content/uploads/2021/02/Raporti-Performanc%C3%ABs-Dropull-FINAL.pdf

Bashkia e Dropullit ruan një pasuri të rrallë etno-kulturore. Zona ka ruajtur dhe transmetuar mikpritjen, gjuhën, letërsinë dhe qytetërimin helen, vallet e bukura, polifoninë, kostumet e pasura, motivet epirote të klarinetës, kishat dhe manastiret, sitet arkeologjike, punimet e gurit, artizanatin, zejet, përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, gastronominë e ndërlidhur me traditën etj. Në territorin e Bashkisë ka kopshte fëmijësh dhe shkolla të mesme të bashkuara, respektivisht në Dervician, Goranxi, Jergucat, Dervician dhe Bularat, Dervician.

III. PËRSHKRIMI REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Auditimi u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Bashkia Dropull ushtron funksionet e saj në zbatimin e Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Të dhëna të përgjithshme të bashkisë Dropull janë dhënë si më poshtë:

Qarku	Bashkia Dropull	Njësitë Administrative	Numri i fshatrave	Numri i popullsisë
Gjirokastër	Qendra (Jorgucat)	Dropull i Sipërm	18	23,131
		Dropull i Poshtëm	16	
		Pogon	7	

I. Komponenti: Mjedisi i Kontrollit.

Mjedisi i kontrollit përbën bazën ku ngrihen të gjithë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit duke siguruar disiplinën dhe strukturën. Mjedisi i kontrollit përbëhet nga disa elementë: Integriteti dhe Vlerat Etike, Qeverisjen, Stilin të vepruarit dhe filozofinë e menaxhimit, Qëndrimin mbështetës, Strukturën organizative, Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore, Profesionalizmin e stafit, Delegimin e detyrave, etj.

a) Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike.

Bashkia Dropull për vitin 2025, ka funksionuar mbi bazën e rregullores së brendshme, "*Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Dropull."* miratuar me Vendimin nr.16 datë 23/08/2024 të titullarit dhe konfirmuar me Vendimin e KB nr.17 datë 28.03.2025. Nga auditimi është konstatuar se nuk ka një Kod të Etikës, por në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë rregullat "Për zbatimin e parimeve të etikës gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike". Në nenin 33 të kësaj rregulloreje janë parashikuar rastet e mosrespektimit të cilat përbëjnë shkak për procedim disiplinor për çdo Nëpunës dhe Punonjës të institucionit.

Me Urdhrin Nr.22/3., datë 07/01/2020 të Kryetarit të Bashkisë është miratuar Rregullorja *"Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për "mbrojtjen nga hakmarrja"*. Në këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat për procedurën e shqyrtimit të hetimit organizativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga Hakmarrja, në zbatim të ligjit nr.60/2016 "Për sinjalizimin dhe

mbrojtjen e sinjalizuesve", që përcakton rastet e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari. Lidhur me marrjen e masave për zbatimin e procedurave antikorrupsion, nuk ka procedura të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla të cilat i dedikohen ankesave për korrupsion. Njohja e stafit të Bashkisë Dropull me "*Rregulloren e Brendshme*" dhe bazën ligjore në fuqi është kryer nga Drejtoria Juridike në mënyrë shkresore dhe elektronike, sipas fushës dhe strukturave përkatëse. Drejtoritë dhe sektorët sipas strukturës organizative, në përgjithësi kanë kryer vlerësimin e punës për punonjësit respektivë, ky vlerësim është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari i autorizuar sipas përcaktimeve të: Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar; VKM nr. 109, datë 26.02.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë"; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

-Nga auditimi i dokumentit të rregullores së brendshme dhe procedurave në zbatimin e saj, del se janë caktuar rregullat apo proceset kryesore të përfshira, të ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësive, por nuk përshkruajnë me detaje këto procese, rrjedhën e punës (fillimin dhe mbarimin e procesit), informimin dhe raportimin, dhe vendimmarrjen individuale, me qëllim parandalimin e risqeve dhe përgjigjen ndaj tyre.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nga Titullari i Bashkisë nuk ka një Urdhër për miratim të Planit të Veprimit për KB.

-Nuk është miratuar: "Plan i Përgjithshëm Vendor" – (PPV) me Fokus Strategjia e Zhvillimit Vendor, Analiza & Vlerësimi Territorit, Parashikimet e Planit, Vlerësimi Strategjik Mjedisor, Materiali hartografik si dhe "Rregullore e Planit Vendor", të cilët hartohen si bashkëpunim i Bashkisë me KKT në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 10296 "Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli", Kreu II, neni 8, pika 8 *"Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit"*; ku titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit dhe miratohen me VKB.

Nga auditimi rezultoi se: Bashkia Dropull me shkresën nr.453 Prot., datë 27.02.2026 është dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit Pyetësorin, Deklaratën dhe raportin vjetor 2025 mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm Bashkinë Dropull, si edhe Planin e Veprimit për zhvillimin e MFK -së për vitin 2025.

Nga auditimi, është konstatuar si më poshtë:

-Titullari, në rolin e NA së Bashkisë mbështet kontrollin e brendshëm, duke mbajtur takime me menaxherët dhe me drejtuesit e njësive të vartësisë, por pavarësisht nga kjo nuk provohet se ka vendosur rregulla dhe procedura lidhur me proceset kryesore me qëllim për të monitoruar zbatimin e tyre, p.sh si identifikohen dhe reagohet ndaj risqeve në nivelet e caktuara të strukturës së drejtimit, etj. Kryetari i bashkisë merr informacione mbi performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga; Njësia e Harmonizimit në MFE, Auditimi i brendshëm ose Auditimi i jashtëm (KLSH) nëpërmjet veprimtarisë audituese, etj.

Struktura organizative e bashkisë.

Për vitin 2025 Struktura organizative" e institucionit është miratuar me Vendimin e KB nr.48, datë 21.11.2024, "*Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelin e pagave të punonjësve të bashkisë Dropull për vitin 2025*" konfirmuar nga Prefektura Gjirokastër me shkresën nr.953/1Prot., datë 04/12/2024, kurse struktura është miratuar me Urdhrin nr.1 datë 06/01/2025 të Kryetarit të Bashkisë "*Për miratimin e strukturës organizative të punonjësve të Bashkisë Dropull*

dhe të Njësive Administrative Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm, Pogon dhe Sektorit të MSZH-së."
-Deklarata e Misionit për vitin 2025, është hartuar në dokumentin e PBA 2025-2027, sipas standardeve të përcaktuara në Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm".*
Nga auditimi konstatohet se: në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Dropull proceset kryesore të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësive, mirëpo nuk përcaktohen objektivat dhe nuk përshkruhen me detaje këto procese, rrjedha e punës, fillimi dhe mbarimi i proceseve, informimi, komunikimi dhe raportimi, si dhe vendimmarrjet individuale me qëllim parandalimin e risqeve dhe përgjigjen ndaj tyre.
-Në rregullore nuk është përcaktuar mënyra apo kriteret e rekrutimit/largimit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me "Kodin e Punës".
- Mënyra e delegimit të detyrave është e përcaktuar në "Rregulloren e brendshme" të institucionit në nenin 39 "Detyrat dhe përgjegjësitë e n/kryetarit ekonomik, pika 2 " ku citohet se "Ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë Dropull dhe përfaqëson këtë institucion në të gjitha rastet kur me autorizim të kryetarit të bashkisë kjo e drejtë i delegohet...".
Nga auditimi konstatohet se: Nga ana e Bashkisë Dropull ekzistojnë rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, por nuk konstatohen raste të delegimit të detyrave dhe funksioneve për vitin 2025.siç janë të parashikuara nga përcaktimet e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, si dhe paragrafi "Delegimi i detyrave", të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.4, datë 26.01.2024, Kapitulli II.

Marrëdhëniet e punës për nëpunësit e Bashkisë Dropull në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist rregullohen sipas përcaktimeve në Ligjin nr.152/2013, datë 17.10.2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të tij, punonjësit administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Për çdo pozicion pune, në përgjithësi, janë hartuar dhe kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë sipas nëndarjeve dhe fushave përkatëse.
Nga auditimi rezultoi se:
-Nuk ka një praktike apo sistem për vlerësimin e performancës për punonjësit, që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt.
-Bashkia Dropull nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës të unifikuar. Veprime ne kundërshtim të Ligjit nr. 10296 /2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe "Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit" miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 dhe Manualin e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 4 datë 26.01.2024 Kapitulli III pika 3.3.2 dhe sipas Aneksit 2, Aneksit 3.
-Për vitin 2025 në total struktura është me 183 vende ndërsa në fakt 164. Realizimi i strukturës për vitin 2025 paraqitet në nivelin 89.6 %, nga të cilët 148 janë punonjës të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me "Kod Pune" dhe 35 janë punonjës me status për nëpunësin civil.

Drejtori i Buxhetit dhe Financës është caktuar Nëpunës zbatues, përgjegjës mbi zbatimin e programit buxhetor. Ky pozicion është plotësuar bazuar në procedura rekrutimi në përputhje me

përcaktimet në kuadrin rregullator për këtë pozicion duke marrë në konsideratë plotësimin e kritereve si arsimimi dhe eksperienca në këtë profil

Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura nga ky institucion për rekrutimin dhe largimin e punonjësve për vitin 2025 u konstatua:
-Procedura e rekrutimit për vendet e lira të punës për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me "Kodin e Punës" është kryer bazuar në: Ligjin Nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen vendore",* neni 64, germa (g), Ligji Nr.7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë",* i ndryshuar.
-Bashkia ka një program vjetor për trajnimin e punonjësve të saj, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë me nr.742 Prot., datë 09.06.2025, dhe se këto trajnime janë mbështetur nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike(ASPA), por ka edhe programe për trajnimin e punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikes. Nga Drejtoria Juridike është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve dhe kjo tabelë i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike
Nga auditimi rezultoi se:
-Nuk ka përshkrime detyrash individuale e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë si dhe kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës, formularët e përshkrimit të pozicioneve të punës nuk ishin pjesë e dosjes së personelit, apo shtojcë e Kontratës së punës për ata punonjës që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Në disa drejtori ka mangësi në vlerësimet periodike 6 mujore dhe vjetore të punonjësve në kundërshtim kjo me VKM nr. 142 datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar.si dhe VKM nr. 503 datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në VKM nr. 328 datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave, funksionarëve të zgjedhur, të emëruar të nëpunësve civil e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore".
Nga verifikimi i dosjeve të personelit u konstatua se:
Për largimet nga puna, në disa raste, nuk është zbatuar kriteri i përcaktuar ne VKM 124, datë 17.02.2016, Kreu III, pika 29, ku të dokumentohet dorëzimi; i inventarit në ngarkim, i pajisjeve dhe mjeteve të punës në njësinë përgjegjëse si dhe dokumentacioni qe disponon punonjësi për shkak të detyrës. Gjithashtu rezulton qe nuk ka një sistem për vlerësimin e performancës për punonjësit, që të inkurajojë zhvillimin profesional të tyre dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe ti te marre masa administrative në rast te mos përmbushjes se detyrës funksionale.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*", Kreu II. "Dosja e Personelit";

Me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Nr.1, date 19.01.2025. është ngritur Grupi I Menaxhimit Strategjik në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA)2026-2028, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, neni 8, pika 8, germa b.
-Nëpunësi autorizues është Kryetari në detyrë i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si

përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.
-Nga ana e GMS janë realizuar takime ne lidhje me planifikimin dhe monitorimin e PBA për të cilat janë mbajtur proces verbalet përkatëse.
Nga auditimi rezultoi se, GMS-ja nuk ka takime të tjera të dokumentuara të aktivitetit të tij, nuk ka plan vjetor pune dhe grafik takimesh rrjedhimisht as raporte vjetore, apo vendime të aktivitetit të tij, të përcaktuara në Ligjin nr. 10296/2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar, dhe Manualin e MFK Kap. II/2.2.6 ku citohet:...GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.
Nga auditimi rezultoi se: Grupi i Menaxhimit Strategjik është ngritur me Vendimin nr.1 datë 19.01.2025 e Kryetarit të Bashkisë, por nuk është hartuar rregullorja për funksionimin e tij.

II. Komponenti : Menaxhimi i Riskut

Në Bashkinë Dropull detyra e koordinatorit të riskut i është caktuar n/kryetari i Bashkisë, por nuk ka akt të delegimit të këtij funksioni. Nga auditimi, është konstatuar se punën e koordinatorit të riskut e kryen drejtori për financën, pa ndonjë akt delegimi të këtij funksioni.
Me shkresën Nr.1957/1Prot., datë 31/12/2025 është miratuar Regjistri i Riskut. Ky regjistër është bazuar në analizën e riskut të çdo drejtorie dhe ka si pikësynim "*Planifikimin dhe Përdorimin me efiçencë, efikasitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në përputhje me misionin e Bashkisë, për arritjen e objektivave*", por nuk janë hartuar plane veprimi për menaxhimin e tij. Për vitin 2025 nuk është përditësuar Regjistri riskut, duke rezultuar për mungesë analize të risqeve dhe raportin mbi masat e marra nga strukturat përkatëse për menaxhimin e tij,
Nuk ka një strategji te riskut apo identifikim te tij sipas nenit 21 te Ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike".*

-Nuk janë identifikuar dhe vlerësuar risqet përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik që përfshin vlerësimin e rëndësisë potenciale dhe priotizimin e risqeve të përputhshmërisë.
Identifikimi, analiza dhe aktivitetet për menaxhimin e riskut, duhet të dokumentohen në regjistrat e riskut dhe planet e veprimit. Nga ana e Bashkisë nuk janë përcaktuar kontrollet specifike për çdo risk dhe niveli i risqeve pas implementimit të këtyre masave korrigjuese.
-Në Bashkinë Dropull, për vitin 2025, nuk ka Urdhër për përcaktimin e grupit koordinues teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimit mbi risqet ku të përfshihen të gjitha strukturat e bashkisë Dropull.

Nga auditimi i kryer konstatohet se: bashkia vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime ., por nuk ka evidenca që të tregojnë aftësinë e njësisë publike për të kryer një hetim të brendshëm të drejtë dhe të plotë për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi.

Efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm është në nivel mesatar. Bashkia Dropull ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni por këto ndryshime strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

Nga auditimi në Bashkinë Dropull, konstatohet mungesa e hartave apo manualeve të proceseve të punës. Vlen të theksojmë se përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.
Aktivitetet e kontrollit nuk kuptohen mjaftueshëm dhe për pasojë një pjesë e mirë e tyre mungojnë, si p.sh. mungon një rregullore risku, apo rregullore për aksesin në aplikacione të ndryshme si p.sh. GIS etj.
Për sa më sipër, këto veprime janë në kundërshtim të Ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 11 pika 2 germa c, neni 20, neni 21, neni 24 pika 1, si dhe me neni 27.

-Rregullorja e Brendshme e Bashkisë nuk përcakton objektivat dhe detyrat specifike sipas "Strukturës Organizative" të miratuar. "Në rregulloren e brendshme të Bashkisë Dropull nuk janë të pasqyruara detyrat funksionale të specialistit të IT, çka krijon boshllëk në përcaktimin e përgjegjësive dhe në vlerësimin e performancës." Bashkia Dropull nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar infrastrukturë IT në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Nga auditimi, bazuar në dokumentet e vëna në dispozicion, rezulton se ndryshimet e bëra në strukturën organizative nuk janë shoqëruar me përditësimin e rregullores së brendshme dhe miratimin e saj në KB.
Programi i përdorur nga sektori i financës për përpunimin e raporteve është program në Excel, ndërsa mbi sistemet e zbatimit të buxhetit sektori i financës përdor sistemin AFMIS, nga qeverisja qendrore.
-Në Bashkinë Dropull nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

-Bashkia nuk ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësive për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.
Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se: Bashkia nuk ka hartuar, miratuar, gjurmën **e** unifikuar të auditimit duke cënuar ndjekjen e ecurisë së një procesi apo procedure që lidhet me veprimtarinë kryesore të njësisë dhe duke bërë të paqartë dhe jo të plotë për të tretët, mjedisin e kontrollit dhe vendimmarrjen lidhur me to.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar Kreu II, neni 8, pika 8a, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhrin Nr.4, datë 26.01.2024 të Ministrit të Financave.

Në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 23 "Informimi dhe komunikimi" përfshin: *Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.*
-Nga auditimi rezulton që nuk ka një komunikim efektiv, si horizontalisht, ashtu dhe vertikalisht,

në të gjitha nivelet e hierarkisë të njësisë.
-Nuk shpërndahen udhëzime dhe urdhra të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
-Nuk ka një sistem deklarimi efikas dhe të përpiktë, që të përfshijë nivelet dhe afatet për deklarimin, llojet e deklaratave që i dorëzohen menaxhimit, format e deklaratave për rastet e zbulimit të gabimeve, të parregullsive, të abuzimit, të mashtrimit ose të përvetësimit.
Sa më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin". i ndryshuar.

Nga auditimi konstatohet se drejtuesit në Bashkinë Dropull kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur. Sistemi i raportimit ofron pjesërisht informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. - Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë Këshillit Bashkiak si dhe në Degën e Thesarit.
-Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit. por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.
Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.
- Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se bashkia nuk përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike. Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë

Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore dhe evidentohet që punonjësit në përgjithësi përdorin adresat zyrtare të e- mailit https://Dropull.gov.al/organizimi-dhe-funksionimi-i-bashkise
Nga Bashkia kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të dokumentuara ne proces-verbale si dhe te ngarkuara në faqen zyrtare të Bashkisë Dropull.
-Në faqen zyrtare të saj nuk është i publikuar çdo vendim i Këshillit Bashkiak. Vendimet janë të publikuara të gjitha në platformën online ku publikohen vendimet e këshillave bashkiakë "Vendime.al"
Nuk janë të pasqyruar në faqen web të Bashkisë Dropull Kalendari vjetor i dëgjesave publike; Regjistri i projekt-akteve për konsultim publik
Nga auditimi u konstatua se:
-Bashkia nuk përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e njësisë në lidhje me shërbimet publike.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",i ndryshuar, Kreu III, neni 23, "Informacioni dhe Komunikimi" pika 2;.,
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.4 datë 26.01.2024. Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.4.

Mungesa e gjurmëve të auditimit, sipas strukturës së miratuar, ka sjellë një proces monitorimi jo efektiv reflektuar kjo edhe në aktivitetin e kufizuar të GMS-së dhe rrjedhimisht në hartimin e raporteve vjetore vetëm për përgatitjen e PBA.

-Në Bashkinë Dropull nuk ka rregulla të brendshme të plota e të miratuara për monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
-Nuk ka një udhëzim të brendshëm për monitorimin e KB si dhe një plan veprimi të MFK-së të miratuar për ecurinë e sistemit të MFK-së
-Nuk ka një raport mbi zbatimin e planit të veprimit të miratuar për ecurinë e kontrollit të brendshëm
-Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH;
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Kreu II, neni 8, pika8 a, Kreu III, neni 24, "Monitorimi" pika 1; si dhe ne kundërshtim me "Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.4 datë 20.01.2024, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.5.Anekset.
Në bazë të auditimit të kryer në Bashkinë Dropull, rezulton se titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet analizimit dhe hartimit të plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH. Nuk kanë gjetur zbatim të gjithë rekomandimet e dërguara zyrtarisht nga ana e KLSH në këtë Bashki.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 4, pikat 19-20, neni 8, pika 8 germa "a", neni 16, pika 2, nenet 20-22, Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.1, germat "a-d", pika 2.3.1, pika 3.2.1, pika 3.2.4, pika 5.2.3, pika 5.2.7, dhe "Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4 datë 26.01.2024, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.5.Anekset.

Mbi auditimin e aktivitetit të Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Dropull).
Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Dropull, për vitin 2025 funksionon ne nivel drejtorie (*sipas vendimit te Këshillit te Bashkisë nr. 48, datë 21.11.2024, vendim i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.953/1 prot, date 04.12.2024).*
Kjo strukture auditimi, krahas vlerësimit te veprimtarisë qe kryen ne Bashkinë Dropull, kryen dhe *shërbim auditimi* ne Bashkinë Libohove me akt marrëveshjen te lidhur midis titullarëve te njësisë Bashkia Dropull dhe Libohove, me nr. 328/1 prot, dhe nr. 319 prot, të përfituesit, datë 15.03.2016, miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr. 4152/1 prot, datë 01.04.2016, ri konfirmuar me shkresën e Ministrit te Financave dhe Ekonomisë nr. 8447 prot, datë 12.05.2021, si dhe ne Bashkinë Finiq me akt marrëveshjen te lidhur midis titullarëve te njësisë Bashkia Dropull dhe Finiq, me nr. 1333 prot, të ofertuesit dhe nr. 2465 prot, të përfituesit, datë 04.10.2016, miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr. 13475/1 prot, datë 31.10.2016, ri konfirmuar me shkresën e Ministrit te Financave dhe Ekonomisë nr.17390/1 prot, datë 05.11.2021, kjo në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, neni 10, shkronja "c", si dhe nenit 64, shkronja "a" të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", pikat 3 dhe 6, te VKM nr. 83, datë 3.2.2016, pika 6 shkronja "a", "*Për miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*".
Njësia e auditimit të brendshëm (NJAB) ne Bashkinë Dropull për vitin 2025, është organizuar me 5 punonjës, ne nivel drejtorie me strukture 1 drejtues njësie, 1përgjegjës sektori dhe 3 specialist auditimi.

Kuadri rregullator mbi të cilën mbështetet aktiviteti i NJAB Bashkia Dropull, në zbatim të akteve ligjore/nënligjore në fuqi është si mëposhtë:

1.Karta e Auditimit te Brendshëm e NJAB Bashkia Dropull, miratuar me Vendimin nr. 4, datë 18.10.2017, dërguar Drejtorisë se Harmonizimit te Auditimit te Brendshëm/MF, me shkresën nr. 1367 prot, datë 20.10.2017, është *përmirësuar* me Vendimin nr.1 date 13.10.2020, dërguar Drejtorisë se Harmonizimit te Auditimit te Brendshëm, me shkresën nr. 1916/1 prot datë 13.10.2020.

2. Kodi Etik i Auditimit të Brendshëm të NJAB Bashkia Dropull, miratuar me Vendimin nr. 2 datë 13.10.2020, protokolluar me nr. 1915/1 prot, datë 13.10.2020, është dërguar Drejtorisë se Harmonizimit te Auditimit te Brendshëm, me shkresën nr.1915/2 prot, datë 13.10.2020.

3. Rregjistri i riskut, është hartuar sipas kërkesave te kreu III të Manualit te Auditimit te Brendshëm pika 3.1.2 "*Identifikimi dhe vlerësimi i riskut*", miratuar me shkresën nr.281 prot, date 25.02.2025.

4. Nga Njësia e Auditimit te Brendshëm, referuar kërkesave te nenit 14, pika 'ç" te ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm ne Sektorin Publik", është hartuar *Raporti Vjetor i veprimtarisë, se bashku me pasqyrat përkatëse, pyetësorin e vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm, si dhe vlerësimin e kontrollit te brendshëm*, miratuar nga Titullari i njësisë dhe dërguar tek Drejtoria e Harmonizimit te Auditimit te Brendshëm ne Ministrinë e Financave, me shkresën nr.333 prot, datë 13.02.2026.

5. Plani strategjik si dhe plani vjetor, janë hartuar e miratuar rregullisht dhe sipas shkresës nr.1384 prot, date 18.10.2024, janë dërguar në strukturën përgjegjëse DHAB/MF sipas kërkesave të nenit 18/2, të ligjit organik mbi auditimin dhe të seksionit 3, kreu II të MABP, si dhe te nenit 14, te ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm ne sektorin publik*" i ndryshuar, te cilat Ne planin vjetor te auditimit për vitin 2025, janë përfshire për auditim sistemet me risk te mesëm dhe te larte, ku drejtimet kryesore te auditimit për Bashkinë Dropull, kane qene:

- *Vlerësimi mbi funksionimin e sistemit ne drejtim te hartimit të buxhetit, veprimtaria financiare e njësisë, prokurimet publike, te ardhurat, kullotat dhe tokat bujqësore, shërbimet publike, menaxhimi i burimeve njerëzore, policia bashkiake, kontrolli i brendshëm, etj.", për veprimtarinë e vitit 2024.*

-*Vlerësimi mbi funksionimin e sistemit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve që janë lënë në auditimet e mëparshme, nga audituesit e brendshëm, deri në fund të vitit 2024.*

-*Vlerësimi i situatës mbi detyrimet e prapambetura, për Bashkinë Dropull, deri në fund të vitit 2024.*

Nga vlerësimet e kryera nga grupi i auditimit, është konstatuar se gjendja e detyrimeve të prapambetura me datën 31.12.2024, është ne *vlerën "0"lekë.*

Si konkluzion, Bashkia Dropull i ka dhënë rëndësinë e duhur lauditimit të detyrimeve te prapambetura.

Tabela nr.1: Të dhëna mbi veprimtarinë e NJAB

Nr.	Periudha	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	Viti 2025	5	4		1				
Totali									

Nr.	Subjektet e Audituara	Realizimi i angazhimeve të auditimit				
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre				Statusi i Angazhimit
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:	Shër bime	Anga zhim	

			A. të përputhshmërisë	A. të performancës	A. financiare	A. tek.Informacionit	A. të kombinuara			Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces
1	Vlerësimi i funksionimit te sistemeve, mbi hartimit të buxhetit, veprimtaria financiare e njësisë, prokurimet publike, te ardhurat, kullotat dhe tokat bujqësore, shërbimet publike, menaxhimi i burimeve njerëzore, policia bashkiake, kontrolli i brendshëm, etj." Bashkia Dropull	1					1			1	
2	Vlerësimi i sistemit te detyrimeve te prapambetura.	1	1							1	
3	Zbatimi i rekomandimeve lënë ne auditimet e mëparshme.	1	1							1	
	Totali	3	2				1			3	

Burimi: Bashkia Dropull

Nga verifikimi rezulton se, për zbatimin e rekomandimeve, *është hartuar plani i veprimit* (formati standard 10) dhe është dërguar pranë DAB me shkresën nr.69/5, date 25.04.2024 ne zbatim ligjshmërisë se përcaktuar me lart, ne te cilin, janë përcaktuar personat përgjegjës për zbatimin e tyre dhe afatet kohore.

Nga NjAB të Bashkisë Dropull, janë respektuar kërkesat e manualit të AB, lidhur me procedurat e hartimit të dokumenteve të auditimit, siç përcakton manuali i auditimit, pra janë respektuar hapat e një misioni angazhimi që nga proçesi i planifikimit (përgatitja) e misionit të angazhimit, puna në terren, pasqyrimi i punës audituese (dokumentimi) i saj.

Për rastet e parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara nga Auditi gjatë ekzaminimit të praktikave dhe dokumentacionit kontabël e administrativ, janë mbajtur dokumentacioni i nevojshëm me personat përgjegjës për fiksimin e shkeljeve të ligjshmërisë dhe të disiplinës financiare.

Kjo strukturë ka plotësuar konformë kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, edhe pyetësorin mbi veprimtarinë e saj, duke dhënë opinionin mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet që ajo auditon, kjo sipas nivelit të riskut, veprim i reflektuar tek formati 7 kap. II te MAB.

Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga njësia e auditimit, veprime, të cilat përputhen me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe të kapitullit VI *"Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese"* të Manualit të Auditimit të Brendshëm , miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave me nr. 134, datë 17.10.2025.

Në njësinë e auditimit të brendshëm, Sigurimi i Cilësisë në të gjitha angazhimet e Auditimit të Brendshëm është kryer nga grupi i punës që ka realizuar angazhimin e auditimit.

Nga dosjet objekt auditimi për periudhën audituese, grupi i punës konstatoi se, procedurat e rishikimit të brendshëm të cilësisë së punës audituese janë ndjekur vazhdimisht, siç është parashikuar në kërkesat e manualit të AB (Kap. IV, Pika 4.8.3).

Nga ekzaminimi i dokumentacionit, u vu re se të gjithë dosjet e evaduar janë arkivuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat" dhe në zbatim të tij "Norma teknike-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor te Republikës së Shqipërisë". Dosjet e auditimit vlerësohen të plotësuara sipas kërkesave të manualit, dhe të gatshme për arkivim.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelat e mësipërme, rezulton se: Nga ana e Njësisë se Auditimit te Brendshëm Bashkia Dropull, planifikimi i një angazhimi është realizuar duke respektuar kërkesat e Manualit te AB kapitulli IV, pika 4.1.1 *"Planifikimi i*

një angazhimi", ku nga ana e grupit te auditimit janë zhvilluar takime për njohjen paraprake te subjektit qe do te auditohet me subjektin, veprime te cilat janë te dokumentuara me shkrim ne procesin e mbledhjes se informacionit dhe përgatitjes se programit te angazhimit.
Gjate kryerjes se angazhimit nga NJAB janë respektuar fazat e planifikimit, si Autorizimin për fillimin e auditimit, Njoftimin paraprak për fillimin e angazhimit, takimin fillestar, deklaratën e pavarësisë, vlerësimin e riskut, përcaktimin e drejtimeve te auditimit, duke e shoqëruar me testet përkatëse, përcaktimi i kostos se veprimit, masat për sigurimin e cilësisë, etj.
Janë respektuar kërkesat e Manualit te Auditimit te Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.6 *"Përgatitja e programit te angazhimit..*" ku për te arritur objektivat e angazhimit, janë trajtuar si fusha prioritare duke planifikuar, vlerësimi i sistemit mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm, vlerësimi i sistemit mbi prokurimin të fondeve publike, vlerësimi i sistemit mbi planifikimin dhe realizimin e te ardhurave, administrimi i buxhetit, deklaratave financiare, etj., pra rezulton se janë zbatuar drejt kriteret, lidhur me fushat prioritare për auditimin e subjekteve, pasi ato kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimtarisë në përputhje me risqet e subjekteve.

Konkluzion: Grupi i auditimit bazuar në informacionin e grumbulluar nga pyetësorët mbi vetëvlerësimin dhe rezultatet e testimeve të kryera nga auditimi në terren, konstaton se komponentët e MFK-së nuk kanë funksionuar plotësisht, nisur nga mënyra e zbatimit të dispozitave ligjore, është konstatuar se në përgjithësi elementët e sistemeve të MFK nuk kuptohen nga njësia dhe janë të implementuara në një shkallë jo të mjaftueshme, më konkretisht:
-Në "*Rregulloren e Brendshme"* është konstatuar se rregullat apo proceset kryesore të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësive, por nuk përshkruajnë me detaje këto procese, rrjedhën e punës (fillimin dhe mbarimin e procesit), informimin dhe raportimin, dhe vendimmarrjen individuale, me qëllim parandalimin e risqeve dhe përgjigjen ndaj tyre..
-Për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës bazuar në "*Kodin punës*" nuk janë të përcaktuara: Detyrat dhe përgjegjësitë, mënyra apo kriteret e rekrutimit/largimit për çdo pozicion.
-Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me Vendimin nr.1 datë 19.01.2025 e Kryetarit të Bashkisë por nuk është hartuar një rregullore për funksionimin e tij.
-Nuk ka një udhëzim të brendshëm për monitorimin e KB si dhe një plan veprimi të MFK-së të miratuar për ecurinë e sistemit të MFK-së
-Nuk ka një strategji te riskut apo identifikim te tij sipas nenit 21 te Ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike".
-Mjedisi i kontrollit nuk ka përfshirë rregulla dhe procedura të qarta, dhe si pasojë aktivitetet e kontrollit rezultojnë të pamjaftueshme për të siguruar funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
-Mungojnë politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, të cilat përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA, stafit menaxherial dhe punonjësve të këtij institucioni
-Për largimet nga puna, nuk është zbatuar kriteri i përcaktuar ne VKM 124, datë 17.02.2016, Kreu III, pika 29, ku të dokumentohet dorëzimi; i inventarit në ngarkim, i pajisjeve dhe mjeteve të punës në njësinë përgjegjëse si dhe dokumentacioni qe disponon punonjësi për shkak të detyrës.
-Nga ky institucion, nuk është hartuar, miratuar, gjurma e unifikuara e auditimit;
-Programi i përdorur nga sektori i financës për përpunimin e raporteve është program në Excel, ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.
-Nuk ka përgatitur rregullore për shërbimin IT, dhe nuk ka sistem rezervë për ruajtjen e të dhënave

të menaxhimit financiar IT *(back-up*) për njësinë.
Sa më sipër shkaku kryesor për gjendjen e krijuar është mungesa e krijimit të një sistemi të plotë të MFK, mungesa e funksionimit të sistemeve të MFK-së, të cilat sjellin për pasojë që këto sisteme të mos kuptohen nga njësia publike dhe mungesën e reagimit ndaj risqeve të mundëshme.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar, -"*Manuali i MFK"* i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.4 datë 26.01.2024, ligjin nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, gërma "b"; VKM nr. 117/2014, i ndryshuar me VKM nr. 833, datë 28.10.2020, Kreu nr. 1, pika nr. 1; VKM nr. 142, datë 12.03.2014, *"Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura"*; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, "*Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike*", pika 2.3.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z. Dh.T *me detyrë Kryetar i Bashkisë Dropull, zj.* S.R, *me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.*

2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

1.1. Programimi PBA-së 2025-2027 dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025:

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2025-2027, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipet e Menaxhimit te Programeve (EMP) për PBA 2025-2027 dhe buxhetin vjetor 2025
- Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, për vitin 2025 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve në zbatimit të kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 27, pika 2, Pikën nr. 2.4.2, "Grupi i Menaxhimit Strategjik", të Manualit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 04, datë 26.01.2024; Udhëzimi nr. 3, datë 28.02.2024, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027", pika 13, si dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 04, datë 26.01.2024 dhe Udhëzimi nr. 3, datë 28.02.2024, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027",
Konstatim: Nga analiza e informacionit dhe auditimi i programeve buxhetore rezultoi se nga 20 programe buxhetore të miratuara nga MF për përgatitjen e PBA 2025-2027 nga ana e Bashkisë Dropull janë planifikuar për buxhetim programet kryesore buxhetore; por ka 6 (gjashtë) funksione/nënfunksione të cilat Bashkia Dropull ende nuk i ka programuar në Buxhet për vitin 2025 dhe *nuk kanë program buxhetimi*, si: Nr. 23/1; 23/2; 23/3; 27/3; 27/4 dhe 28/6.

- "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike" ***(neni 23)***: nënfunksioni **1**.Prodhimin, trajtimin, transm etimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm. **2**.Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura. **3**.Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.
- "Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit" ***(neni 27);*** **3**. Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi. **4**.Krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor

- "Funksionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor" *(neni 28);:* nënfunksioni: **6**.Dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor **.**

Çdo funksion i përcaktuar në Ligjin 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* përfshihet në një program të caktuar buxhetor të përcaktuar në Udhëzimin nr.7, datë 25.05.2022 *"Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"* shtojca 1. Pra vihet re se nuk ka një harmonizim të planifikimit buxhetor të atyre nënfunksioneve që edhe pse u përkasin funksioneve të ndryshme, me një studim dhe analizë profesionale do të mbështesnin apo plotësonin njëra tjetrën, me qëllim realizimin në tërësi të shërbimeve ndaj komunitetit në territorin që mbulon Bashkia Dropull

Programet buxhetore të përzgjedhura nga ana e Bashkisë

▪ Ndërsa programet buxhetore e përzgjedhura në Bashkinë Dropull për buxhetin e vitit 2025 si viti i parë në PBA 2025-2027, krahasuar me programet e miratuara nga MF për tu mbajtur në konsideratë nga NJVQV gjatë përgatitjes së PBA 2025-2027, pasqyrohen si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.2, Te dhënat në mijë lekë

Udhëzimi nr. 7 datë 25.02.2022			Kodi buxhetuar	Kodi i ri	Emërtimi i Programit Buxhetor	Viti 2025		Diferenca
Funksioni	N/ Funksioni	Kodi Programit				Plan	Fakt	
1	011	01110	01110		Planifikim, Menaxhim, Administrim	102466	92713	9753
3	031	03140	03140		Shërbimet e Policisë Vendore	7088	5938	1150
	032	03280	03280		MZSH	23380	20219	3161
4	041	04130			Mbështetje për zhvillim ekonomik			
	042	04220			Shërbimet bujqësore/inspektimi /siguria ushqimore/mbrojtja konsumatorë			
		04240	04240		Menaxhim infrastrukture Kullim-Ujitja	35716	9940	25776
		04260	04260		Administrim Pyje-Kullota	15578	11494	4084
	045	04520	04520		Mirëmbajtje Rruge e trotuare	66433	37804	28629
		04570			Transporti Publik			
	049	04940/04910	04940/04910		Fond kontingjente, Fond rezervë	1403	0	1403
5	051	05100	05100		Menaxhim Mbetje Urbane	45416	24828	20588
6	061	06140	06140		Planifikimi urban vendor			
	062	06260	06260		Shërbime Publike	14121	13925	196
	063	06370			Furnizim me ujë dhe kanalizime			
7	072	07220			Shërbimet e kujdesit parësor	8132	0	8132
8	081	08130	08130		Sport dhe argëtim, turizëm;	13925	11385	2540
	082	08220	08220		Shërbime kulturore			
9	091	09120	09120		Arsimi bazë/parashkollor	6895	6727	168
	092	09230	09230		Arsimi i Mesëm	14516	9620	4896
10	104	10430	10430		Paaftësi/ Kujdesi Social/ndihma ekonomike	15530	13225	2305
	106	10661			Strehimi Social/ Qendra ditore për fëmijët me aftësi ndryshe	1045	956	89
	109	10910			Mbrojtje Civile e Emergjenca	1084	1077	7
22 Programe			**15**	**7**		**372,729**	**259,852**	**112,877**

Burimi: Bashkia Dropull /Punoi: Grupi i auditimit

Programet afatmesme janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/*2015 "Për Vetëqeverisjen vendore"*, Ligjin nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me Ligjin nr. 57 datë 02.06.2016 "Për disa ndryshime

dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008", Ligjin nr. 9652/2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Udhëzimin e MF nr. 7 datë 28.02.2018 "Për proçedurat standarde të përgatitjes së buxhetit", Udhëzimin e MF nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimi plotësues i MF nr. 2 datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018", Udhëzimin plotësues nr.6/1 datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" shtojca 1, etj.

Konstatim: auditimi i programeve buxhetore, nga 20 programe buxhetore të caktuara në udhëzimet e MF për PBA 2025-2027, rezultoi se disa programet buxhetore të lidhura me funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike si dhe në fushën e zhvillimit ekonomik vendor, etj. nuk janë marrë në konsideratë nga Bashkia Dropull për të parashikuar fonde në buxhet, në moszbatim të Udhëzimit nr. 7 datë 25.05.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*" shtojca 1 dhe Udhëzimit të MF nr.3, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", (shtojca 4).

Takimet konsultative me grupet e interesit në komunitet:
Nga auditimi rezultoi se Bashkia Dropull për PBA 2025-2027 dhe Projekt buxhetin e vitit 2025, ka zhvilluar takime konsultative me grupet e interesit në komunitet, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Kreu I, neni 5 pika ç; ndërsa prezantimi i PBA 2024-2026 dhe Projekt buxheti vjetor 2024 nga ana e Bashkisë Dropull është publikuar në faqen Zyrtare të Bashkisë në formatin e përshtatur për publikun.
Dëgjesat publike

Datat e mbajtjes së tyre	14.11.2024 14.11.2024 20.11.2024
Numri i takimeve	**3**

Burimi: DFB/Bashkia Dropull

Procesi konsultativ me komunitetin është realizuar nëpërmjet njoftimit zyrtar në stenda, web-in e Bashkisë, rrjetet sociale etj., me anë të të cilave njoftohet komuniteti mbi takimin, objektin, platformën dhe adresën/linkun etj., vërtetuar kjo nga proces verbalet e mbajtura në secilin takim, konform kuadrit ligjor në fuqi: Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Kreu I neni 5 pika ç; Ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" Kreu IV, neni 11-20; dhe pika 16 e Udhëzimit të MF nr.3, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", (shtojca 4).
Kalendari i Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit Vjetor.
Bashkia Dropull ka hartuar "Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit vjetor" për Bashkinë dhe njësitë administrative për vitin 2025 me shkresën nr. 87 datë 22.01.2024 dhe miratuar me VKB, në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 33.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Programet afatmesme 2025-2027 dhe 2026-2028 janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore*", Ligjin nr. 9936/2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Ligjin nr. 9652/2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Udhëzimin e MF nr. 7 datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së buxhetit",* Udhëzimin e MF nr. 9 datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",* Udhëzimin plotësues nr.6/1 datë 28.02.2018 "*Për përgatitjen e buxhetit vendor*", Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"* shtojca 1, Udhëzimi MF nr. 6, datë 28.02.2023 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026*" dhe VKB për miratimin e taksave vendore për Bashkinë Dropull për vitin 2025. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion *(kontratat në vazhdim),* angazhimet *(detyrimet e prapambetura sipas llojit),* tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme *(kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme).*

PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet si më poshtë:

- a-PBA 2025-2027 miratuar respektivisht me VKB nr.29 , datë 27.06.2024, është miratuar Projekt-dokumenti i parë i PBA 2025-2027, me VKB nr.41, datë 30.09.2024, Projekt-dokumenti i rishikuar i PBA 2025-2027 dhe me
- b. VKB nr.**55, date 19.12.2024**, është miratuar PBA përfundimtare 2025-2027 dhe buxheti vjetor 2025, 1026/1, datë 31.12.2024.

Vendimmarrje të lidhura me procesin e buxhetimit vjetor dhe afatmesëm:

- Me vendimin nr. 02, datë 19.01.2024 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik.
- "Raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave" është miratuar me VKB nr. 07, datë 29.02.2024. Miratimi i tavaneve përgatitore të shpenzimeve është bërë me VKB nr. 12, datë 29.03.2024.
- Me vendimin e këshillit bashkiak (VKB) nr.48, datë 21.11.2024, është miratuar numri i punonjësve të Bashkisë Dropull, institucioneve në varësi, njësive administrative dhe funksionet e deleguara për vitin 2025.
- Me vendimin nr.48, datë 21.11.2024, është miratuar niveli i pagave të Bashkisë Dropull.
- Me VKB nr. 27, datë 29.05.2025, është miratuar numri i punonjësve me kontratë të përkohshme.

Për vitin 2025, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB **nr. 55, date 19.12.2024**, konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër. Në këtë VKB, të ardhurat nga *burimet e veta të planifikuara* për vitin 2025 kanë vlerën 71.513.000 lekë, *transferta e pakushtëzuar* ka vlerën 168.764.318 (18,820,000 lekë fonde të trashëguara); *transferta specifike* ka vlerën 60.369.114 lekë

Referuar përcaktimeve në këtë Vendim të KB, në total të ardhurat kanë vlerën 300.646.432 lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën. 300.646.432 lekë

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2025

Të dhënat në mijë lekë

Emërtimi	Viti 2024	Viti 2025
Të ardhurat faktike	298.580	368.458

Shpenzimet faktike	249.339	259.852

Burimi: Bashkia Dropull, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës

Gjatë vitit 2025, janë marrë gjithashtu disa vendime të Këshillit Bashkiak Dropull të cilat kanë miratuar ndryshimin e vlerave të buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten si vijon:
Për vitin 2025, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. **55,** datë 19.12.2024, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.1026/1, datë 31.12.2024.
Gjatë vitit 2025, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (referuar në aktin e akonstatimit).
Sa më sipër në zbatim të në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit Plotësues të MF nr. 2, datë 24.01.2025 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025*", pika 114:

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.
Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.
Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.
Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit të institucionit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me vendim të KB.
-Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.
-Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.
-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.
Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Gjirokastër.si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.
Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2025, referuar situacionit të shpenzimeve dhe akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin (të ardhurat e veta vendore + transferta e pakushtëzuar + transfertë sektoriale) paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3. Të dhëna në formë tabelare për planifikimin e buxhetit bazë dhe ndryshimet jepen në tabelën në vijim: *Në mijë lekë*

Njësia	Bashkia + Ndërmarrjet/institucionet e vartësisë Viti 2022							
Art.	Emërtimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	6/5*100
		Fakti vitit paraardhës Viti 2024	PBA Plan Viti 2025	**Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2025**	**Buxheti Vjetor Plan Rishikuar Viti 2025**	**Fakti i 12-mujorit 2025**	Diferenca F-P	% e realizimit
600	Paga	112,590	157,172	157,172	160,679.54	147,871	-12,808,54	92%
601	Sigurime Shoqërore	19,063	26,237	26,237	27,114.44	24,575	-2,569,44	90,6%
600+60	Paga +Sigurime	131,653	183,409	183,409	187,793.98	172,446	-15,347.98	91,8%
602	Mallra dhe Shërbime Tjera	48,437	67,867	67,867	70,076.52	48,658	-21,418.52	69,4%
603	Subvencione	0	0	0		0	0	
604	Transferta Korente Brendshm	1,845	5,900	5,900	5,184.34	3,327	-1,857.34	64,1%
605	Transferta Korente Huaja	0	0	0		0	0	
606	Transf. për Buxh. Fam. Individ	4,478	3,800	3,800	8,942.58	7,612	-1,330.58	85,1%
609	Rezervat	0	6,070	6,070	1,402.99	0	-1,402.99	0%
602-609	Shpenzime operative	54,760	83,637	83,637	85,606.43	59,597	-26,,006.43	69,6%
Shpenzime Korrente		**186,413**	**267,046**	**267,046**	**273,400.41**	**232,043**	**-41,357.41**	**84,8%**
230	Kapitale të Patrupëzuara	3,950	0	0	485	0	-485	0%
231	Kapitale të Trupëzuara	58,976	33,600	33,600	98,843.88	27,.808	-71,035.88	28,1%
Totali	**Shpenzime Kapitale**	**62,926**	**33,600**	**33,600**	**99,328.88**	**27,808**	**-71,520.88**	**27,9%**
Totali (korrente + kapitale)		249,339	300,646	**300,646**	**372,729.29**	**259,851**	**-112,878.29**	**69,7%**

Burimi: Bashkia Dropull

Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore <u>me të ardhurat e veta të Bashkisë Dropull së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike</u>, për vitin 2025 kanë diferenca me vlerën e planifikuar. Për vitin 2025 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën **300,646 mijë** lekë buxheti i rishikuar ka vlerën **372,729 mijë** lekë, ndërsa realizimi është në vlerën **259,851 mijë** lekë ose në masën **69,7%**

- Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 187,793.98 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 172,446 mijë lekë ose në masën 91,8%
- Zëri shpenzime operative (602) dhe Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën 70,076. mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 48,658 mijë lekë ose në masën 69,4%
- Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 (artikulli 230-231) është planifikuar në vlerën **99,328.88** mijë lekë dhe është realizuar në vlerën **27,808** mijë lekë me një mosrealizim të këtyre fondeve prej **- 112,878** mijë lekë, ose realizimi në nivelin **69,7%**

<u>Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Dropull në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime real të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk</u>

korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur ***shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.***

Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9, pika 1.3, gërma "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe VKB përkatëse.

Niveli i mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta:

Planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2025 ka vlerën 71.513 mijë lekë ndërsa realizimi ka vlerën 68.364 mijë lekë ose në masën 95.6%. Bashkia Dropull ka pasur të ardhura të trashëguara nga viti 2024 shumën 13.509.066.6 lekë.

Gjatë viti 2025 shuma e përdorur e të ardhurave për të mbuluar shpenzimet operative dhe kapitale të Bashkisë Dropull është në vlerën 60.981.351 lekë.

Kjo vlerë ka mbuluar zërat e shpenzimeve si më poshtë:

- Llogaria 600 (Paga) në shumën 29.901.368 lekë;
- Llogaria 601 (Sigurime shoqërore dhe shëndetësore) në shumën 4.962.762 lekë;
- Llogaria 602 (Blerje mallra, shërbime) në shumën 22.459.842 lekë;
- Llogaria 606 (Transferta buxhete familjarë, individ) në shumën 0 lekë;
- Llogaria 604; 609 (transferta te brendshme, fond rez.;fond kontigjence) në shumën 2.147.422 lekë
- Llogaria 230-231 (Investime kapitale) në shumën 1.510.137 lekë.

Buxheti faktik i vitit 2025 është në vlerën 345.932.700 lekë, duke përfshirë transfertat e kushtëzuara për investime për ndihmën ekonomike dhe PAK.

Sipas realizimit të buxhetit Bashkia Dropull me të ardhurat e veta mbulon 23.5 % të buxhetit vjetor 2025.

Sipas realizimit të buxhetit Bashkia Dropull me të ardhurat e veta mbulon **23.5%** të buxhetit vjetor 2025. Të dhënat e mësipërme për vitin 2025, tregojnë për nivele të ulëta të mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta, të cilat kanë si shkak nivelin e ulët të mbledhjes së të ardhurave.

Tabela nr. 4. Në mënyrë të hollësishme mbi realizimin e buxhetit sipas zërave dhe burimeve të financimit

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia për vitin 2025				**Në lekë**					
Përshkrimi Shpenzimeve	**Plani**	**Fakti**	**Realizimi ne %**	**Burimi i financimit të shpenzimit**					
				Nga të ardhurat e veta	**% e realizimit nga të ardhurat**	**Nga Granti Qeveritar**			
						Nga transferta e pakushtëzuar	Nga transferta kushtëzuar specifike	Nga transferta kushtëzuar për funksionet deleguara	Nga transferta kushtëzuar për investimet
Paga 600	160,679,540	147,871,280	92%	29,901,368	20,2%	76,478,348	41,491,564		
Sigurime shoqërore 601	27,114,440	24,574,740	90.6%	4,962,762	20,1%	12,672,616	6,939,362		
ShP. Operat 602+ F. Rezervë 609	71,479,510	48,658,080	68%	22,459,842	46,1%	24,992,328	1,205,910		
Subvencion Ujësjellësi, etj. 603									

K. Q Emergj Civile 604	5,184,340	3,327,190	64%	2,147,422	64,5%	1,179,768			
Nd/Ekonom invalid 606	8,942,580	7,612,490	85%	0		6,031,490	1,581,000		
Mjete ne ruajtje 466				0					
Investime 230-231	99,328,880	27,808,460	28%	1,510,137	0,54%	26,298,323			
Totali 1. Buxheti i Bashkise	**372,729,290**	**259,852,240**	**69.7%**	**60,981,531**		**147,652,873**	**51,217,836**		
NGA PUSHTETI QENDROR							**0**		
Paga 600	3,585,340	3,536,310		0		0	0	3,536,310	
Sigurime shoqërore 601	653,820	590,810		0		0	0	590,810	
ShP. Operat 602+ F. Rezervë 609	1,784,850	1,488,210		0		0	0	1,488,210	
Nd/Ekonom invalid 606	33,931,320	33,630,010		0		0	0	33,630,010	
K. Q Emergj Civile 604	9,923,560	9,923,560		0		0	0		9,923,560
Investime 230-231	50,345,780	36,911,560		0		0	0		36,911,560
Totali 2	**100,224,670**	**86,080,460**		**0**		**0**	**0**		
GJITHSEJ 1+2	**472,953,960**	**345,932,700**		**60,981,531**		**147,652,873**	**51,217,836**	**39,245,340**	**46,835,120**

Burimi: Bashkia Dropull

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë:

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" dhe nenit 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26. 06. 2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, krijohet Fondi Rezervë.

Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontigjencës.

Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3% të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë:

Parashikimi i fondeve të emergjencave civile dhe fondit rezervë është mbështetur në përvojën e viteve të mëparshme. Fondi i emergjencave civile planifikohet në shume totale minimalisht 4% të totalit të buxhetit të Bashkisë, ka filluar nga viti 2020. Nga Bashkia Dropull buxhetin e vitit 2025 është parashikuar fondi i rezervë në vlerën 4,070 mijë lekë.

Struktura e fondeve me destinacion:

Në lekë

Emërtimi	Plan 2025	Fakt 2025
Fondi rezervë,	4.070.000	4,070,000
Fondi i kontigjencës,	2.000.000	597,010
	6,070,000	**4,667,010**

Burimi: Bashkia Dropull

Vlerat e llogaritura për këtë qëllim: Fondi rezervë dhe i kontigjencës paraqitet në shumën 6,070 mijë lekë miratuar me VKB nr.55 datë 19.12.2024, konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër "Për miratimin e Buxhetit për vitin 2025 të Bashkisë Dropull".

Nga auditimi rezulton se për vitin 2025:

- ✓ vlerat e llogaritura nga fondet rezervë dhe kontigjencës janë 6.070.000 lekë.
- ✓ mënyra e llogaritjes të kësaj vlere, është deri ne 3% te buxhetit vjetor te Bashkisë.
- ✓ vlera e përdorur në fakt është 4.667.010 lek dhe janë përdorur:

-679,765 lek, rindërtim banese e djegur e z. J. G., në fshatin Pepel.
-3,987,245 lekë për pjesëmarrjen ne projektin nga fondi i digave, për rehabilitimin e Digës Pepel 1.
- ✓ vlera e pa përdorur është 1,402,990 lekë.

Fondet e shpenzuara
Në VKB nr. 55, datë 19.12.2024, është miratuar për vitin 2025, fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total 6,070,000 lekë, *si vijon:*

- ✓ fondi rezervë nga granti në vlerën 4,070,000 lekë;
- ✓ fondi rezervë nga të ardhurat në vlerën 0 lekë;
- ✓ fondi kontigjencës nga granti në vlerën 2,000,000 lekë;
- ✓ fondi kontigjencës nga të ardhurat në vlerën 0 lekë;
- ✓ fondi i emergjencës civile në vlerën 0 lekë.

A. Fondi Rezervë**:** Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" dhe nenit 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, është krijuar Fondi rezervë. Në buxhetin e Bashkisë Dropull për vitin 2025, është planifikuar fond rezervë në vlerën 4,070 mijë lekë. Nga Fondi Rezervë për periudhën nga data 01.01.2025, deri 31.12.2025, është shpenzuar 597.1 mijë lekë.

B. Fondi i Kontingjencës: Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontingjencës. Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3 (tre) % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Në buxhetin e Bashkisë Dropull janë parashikuar fondet e kontigjencës në vlerën 2,000 mijë lekë. Përdorimi i fondit të kontigjencës për vitin 2025 në vlerë totale **597 mijë lekë**:

Subvencione: Bashkia Dropull për vitin nuk ka pasur subvencione për vitin 2025.
Kredi të marra**:** Bashkia Dropull nuk ka marrë kredi për vitin 2025.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministritë e linjës etj.,).
Në Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore", përcaktohet që:

Pika 19. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgjigjet dhe raporton në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për përgatitjen, kontrollin e brendshëm financiar publik, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit, për të gjitha funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore.
Pika 20. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore i paraqet këshillit, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit.
Pika 22. Nëpunësi autorizues publikon raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit në faqen zyrtare të njësisë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit dhe një kopje e tyre i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Pika 23. Nëpunësi autorizues, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit duhet të dërgojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, raportet katër mujore dhe vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare.

Bashkia Dropull më datë 01.01.2025, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor lekë. Më datë 31.12.2025, vlera totale e detyrimeve të prapambetura me burim financimi nga të ardhurat e veta është në vlerën zero lekë.

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga granti (Ministritë e linjës etj.) për vitin 2025, cilat janë objektet e këtyre investimeve, vlera e kontratës, data e kontratës, vlera e financuar, vlera e pa financuar, operatori fitues (kontraktori), arsyet e mos likuidimit të të gjithë vlerës.

Tabela nr.5: Të dhëna mbi detyrimeve të prapambetura Nga granti

Nr.	Objekti i prokurimit	Kontrata nr..datë	Vlera e plotë e kontratës me TVSH	Vlera e likuiduar	Vlera e pa likuiduar	Arsyet e mos likuidimit
1	Përmirësimi i banesave egzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara(2024)	Nr. 1291 , dt.30.09.2024	3.712.848 2.598.000 nga Ministria 1.113.848 nga Bashkia	3.712.842. 2.598.994 nga Ministria 1.113.848 nga Bashkia	0	
	2025					
1	Rikonstruksion i shkollës së bashkuar Dervician dhe ndërtimi i palestrës shkolla e Bashkuar Dervicin Dropull	Nr. 1242 , dt.12.09.2025	139.226.819 118.342.796, nga Ministria 20.884.023, nga Bashkia.	34.478.214 likujduar nga fondi i ministrise dhe 3.308.136 nga Buxheti i Bashkise	105.920.305	Jane kontrata 3-vjecare
2	Rehabilitimi i Digës Pepel 1,Bashkia Dropull	Nr. 1725 , dt.21.11.2025	65.760.960 52.608.770 nga Ministria 13.152.190 nga Bashkia	2.400.000 (fondi i Ministr.)	63.360.960	Jane kontrata 3-vjecare

Burimi: Bashkia Dropull

<u>Monitorimi i buxhetit dhe raportimi periodik në Këshillin Bashkiak:</u>

A. ***Hartimi i raporteve katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit:*** Në zbatim të nenit 48 "Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor" të ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 22 dt.30.07.2018 "Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore", si dhe nenin 44, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore",

a. ***Raportimi i zbatimit të buxhetit:*** Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Dropull administron raportet 4, 8 dhe 12 mujore të monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit për vitin 2025 si vijon:

1. Vetëvlerësimi financiar dhe detyrimet e prapambetura i 4-mujorit të parë 2025 dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën Nr.633 prot, datë 20.05.2025
2. Vetëvlerësimi financiar dhe detyrimet e prapambetura i 4-mujorit të dytë 2025 dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën Nr1364 prot, datë 30.09.2025

3. Vetëvlerësimi financiar dhe detyrimet e prapambetura i 4-mujorit të tretë 2025 dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën Nr. 421 prot, datë 25.02.2026.
Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion Raportet e Monitorimit të buxhetit të vitit 2025 janë miratuar në Këshillin Bashkiak dhe janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.
B. ***Raportimi i stokut të detyrimeve të prapambetura.*** Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë edhe në rrugë elektronike. Raportimi në degën e thesarit është bërë sipas udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 "*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të* ***detyrimeve të prapambetura*** *të qeverisjes së përgjithshme*".
Raportimi i stokut të detyrimeve të prapambetura:
1. Shkresa nr. 633, dt. 20.05.2025
2. Shkresa nr. 1364, dt. 30.09.2025
3. Shkresa nr.421, datë 25.02.2026

C. ***Raportimi në ministri mbi programi "Emergjencat Civile"*** është bërë sipas Udhëzimit Plotësues të MF nr. 2, datë 24.01.2025 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025*", pika 118, ku citohet

118. Të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat përfitojnë fonde nga programi "Emergjencat Civile" sipas pikave 18,19, 20 dhe 21 të këtij udhëzimi duhet të raportojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit/Drejtorinë e Financave Vendore në fund të çdo tremujori mbi ecurinë e realizimit të shpenzimeve faktike nëpërmjet këtyre fondeve

Raportimi në ministri mbi programi "Emergjencat Civile": e-mail datë 19.05.2026

Tabela nr.6. *Performanca e treguesve financiarë të Bashkisë. Struktura dhe efikasiteti i shpenzimeve publike të bashkisë për të përmbushur funksionet e veta ligjore.*

Emërtimi	2022	2023	2024	2025	Mesatarja 2022-2025
Nr. frymësh	22586	22395	22178	21942	22275
Buxheti total	260,252	270,381	298,580	368,473	299,422
Buxheti për frymë (në 000/lekë)	11.5	12.1	13.5	16.8	13.5
Te ardhurat e veta 000/leke	59,698	57,137	59,983	66,969	60947
Te ardhura për fryme 000/lek	2.65	2.56	2.71	3.06	2.78

Burimi: Bashkia Dropull

Konklu<u>zion</u>**:** Nga auditimi i procesit të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit të Bashkisë Dropull për vitin 2025 rezultoi se sistemi buxhetor është funksional, por paraqet disa mangësi në planifikimin realist të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe në përfshirjen e plotë të funksioneve në programimin buxhetor.Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore <u>me të ardhurat e veta të Bashkisë Dropull së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike</u>, për vitin 2025 kanë diferenca me vlerën e planifikuar. Për vitin 2025 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën **300,646 mijë** lekë buxheti i rishikuar ka vlerën **372,729 mijë** lekë, ndërsa realizimi është në vlerën **259,851 mijë** lekë ose në masën **69,7%**

- Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 187,793.98 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 172,446 mijë lekë ose në masën **91,8**%
- Zëri shpenzime operative (602) dhe Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën 70,076. mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 48,658 mijë lekë ose në masën 69,4%
- Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 (artikulli

230-231) është planifikuar në vlerën **99,328.88** mijë lekë dhe është realizuar në vlerën **27,808** mijë lekë me një mosrealizim të këtyre fondeve prej - **112,878** mijë lekë, ose realizimi në nivelin **69,7%**

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Dropull në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime real të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z. Dh.T*, me detyrë Kryetar i Bashkisë Dropull, zj.* S.R*, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.*

2.2- Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni dhe ka rezultuar si më poshtë vijon:

1.Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Struktura organizative e Bashkisë Dropull, e zbatuar për vitin 2025 është miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 01, datë 06.01.2025 "*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Dropull dhe NJA-ve Dropulli Poshtëm, Dropull i Sipërm, Pogon dhe Sektorit MZSH".* në të cilën përfshihet edhe Drejtoria e të Ardhurave (shkurt në vijim DTA), e përbërë nga 7 pozicione pune në strukturë, më konkretisht: 1 Drejtor, 1 Përgjegjës Sektori, 4 specialistë të tatime taksave dhe2 punonjës mbështetëse në NJA Dropull i Sipërm dhe Pogon.

Për periudhën nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar ***Paketa Fiskale,*** e propozuar sipas Projekt Vendimit me shkresën Nr.1531 Prot, datë 15.11.2024 "*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të bashkisë Dropull për vitin 2025"* dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.47, datë 21.11.2024 "*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Dropull për vitin 2025*", konfirmuar nga Prefektura e Gjirokastrës me nr.953/1 prot., datë 04.12.2024.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së paketës fiskale për vitin 2025, rezulton se ajo ka përcaktuar rregullat mbi mënyrën e ushtrimit tët ë drejtave dhe detyrave nga organet e kësaj NJVQV, për vendosjen e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre, duke strukturuar gjithë kategoritë e taksave që administrohen nga ky organ vendor, kategoritë dhe grupimet përgjegjëse të pagimit të taksave dhe strukturat përgjegjëse për mbledhjen e këtyre të ardhurave.

- Në Bashkinë Dropull bëhet publikimi i VKB-ve në platformën online "Vendime.al". (Në kuadër të Reformës Territoriale dhe Administrative është miratuar platforma online Vendime.al, e cila shërben për publikim të VKB-ve).
- Procesi për planifikimin, përllogaritjen e detyrimeve tatimore, ndjekjen e subjekteve debitore për taksa tarifa vendore është bazuar në rakordimin e të dhënave vjetore midis DTA, Drejtorisë Rajonale të Tatime Taksave Gjirokastër por jo me Qendrës Kombëtare të Biznesit, lidhur me numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin që administron Bashkia Dropull analizën e rezultatit historik, pritshmërinë e vitit korrent dhe koordinimit midis drejtorive/ sektorëve që mbulojnë realizimin e tyre.
- DTA përllogaritjen e njoftim detyrimeve e bën brenda afateve të përcaktuara në paketë fiskale, dhe bën njoftimin e të gjitha subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore pasi mungon një adresar

i plotë dhe i qartë për kategoritë Familjarë dhe *Biznes (nuk përdoren metoda alternative "e-mail" për njoftimin e tatimpaguesve).*

A.Auditimi i "Regjistrit Elektronik" të Tatimeve dhe Taksave Vendore ndaj subjekteve tatim paguese, që ngarkohen dhe shlyhen nga subjektet

- Burimi i të dhënave sa i përket kategorisë biznes për llojin e aktivitetit, sipërfaqes së ambienteve ku biznesi ushtron aktivitet, xhiros vjetore etj. është regjistri elektronik i DTA-së .
- DTA çdo fillim viti krijon një regjistër të ri elektronik ***në format Microsoft Excel*** për administrimin e të dhënave për çdo njësi administrative. Bazuar në regjistrin elektronik që Bashkia Dropull ka përgatitur, kryhet menaxhimi i informacionit mbi të dhënat sa i përket regjistrimit /ç'regjistrimit, planifikimit, njoftim detyrimit dhe regjistrimit të arkëtimeve për abonentët familjarë dhe personat fizikë e juridikë të cilët t kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish.

-Për periudhën në auditim është hartuar Regjistri për Taksat dhe Tarifat për çdo NJA dhe fshat, duke përfshirë listat e tatimpaguesve dhe detyrimet sipas kategorive të tatimeve e taksave apo detyrimeve për pagesë. Në këtë regjistër është shënuar muaji i kryerjes së pagesave por pa referuar dokumentin financiar dhe vlerën e likuiduar. Regjistrat janë nënshkruar rregullisht nga Drejtori i Të Ardhurave dhe Kryetari i Bashkisë.

Konstatim: Regjistrat për Taksat dhe Tarifat për çdo NJA dhe fshat, ku janë përfshirë listat e tatimpaguesve dhe detyrimet sipas kategorive të tatimeve nuk janë protokolluar dhe arkivuar në momentin e mbylljes së regjistrit elektronik vjetor. Dorëzimi me procesverbal dhe arkivimi i kopjes së printuar dhe elektronike (CD), përpara krijimit të regjistrit elektronik të vitit pasardhës siguron gjurmën e auditimit për proceset vijuese dhe garanton saktësinë e të dhënave. Të dhënat që administrohen nga regjistrin elektronik (informacioni mbi subjektet tatimpagues që popullohen në regjistrin elektronik), shërbejnë për përgatitjen e evidencave të cilat përdoren për raportim (evidenca mbi planifikimin e pritshëm dhe realizimin faktik mbi të ardhurat për taksa/tarifa vendore, evidenca mbi ndjekjen e subjekteve debitore, listat për njoftim bllokimi për subjektet debitore në bankat e nivelit të dytë apo QKB), përgatitjen e pasqyrave financiare apo gjenerimin e raporteve për Kryetarin e Bashkisë dhe Këshillin e Bashkisë Dropull.

Konstatim:- Nga ana e Bashkisë Dropull është miratuar "Rregullorja e brendshme për krijimin, mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit elektronik të tatimpaguesve vendorë të Bashkisë Dropull", (paraqitur sipas relacionit me nr. 1627 datë 06.11.2025 të Drejtorisë së të Ardhurave dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë z.Dh.T.

Rregullorja është miratuar në fund të vitit 2025, bazuar në UMF nr. 13, datë 25.06.2025 "Për përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së regjistrit të personave fizik dhe juridik që kanë detyrimi për të paguar taksat dhe tarifat vendore ..." , mirëpo nuk ka parashikuar aspektet e gjenerimit/printimit dhe arkivimit të të dhënave periodike e vjetore mbi tatimpaguesit e Bashkisë. Për periudhën në auditim nuk ka një dokumentim, protokollim të momentit mbylljes së regjistrit vjetor ekzistues e depozitim të tij në Zyrën e Protokoll- Arkivës (version hard copy dhe CD) dhe krijimit të regjistrit të ri vjetor.

-Procesi i popullimit të Regjistri Elektronik në DTA dhe procesi i përpunimit dhe përgatitjes së evidencave kryhet nga të njëjtit përdorues, por nuk ka një dokumentim të veçantë (procesverbal) për kryerjen e këtij procesi për ndarjen e aktiviteteve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar dhe Manualit të MFK.

- Nuk ka përcaktime në rregullore të brendshme apo në rregulloren specifike mbi krijimin,

përditësimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit elektronik mbi afatet dhe mënyrën e rakordimit të të dhënave të këtij regjistri me strukturat e brendshme dhe të jashtme dhe si dokumentohet çdo përditësim i tij, në funksion të saktësisë dhe ruajtjes së gjurmës së auditimit të këtij procesi.
Sa më sipër, në mospërputhje me përcaktimet e nenin 5/: iv) të Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar përcaktohet se "Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak përcakton: iv) rregullat e raportimit, të dokumentimit e kontrollit të taksave vendore
- Nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e saktësisë së procesit të popullimit të regjistrit elektronik, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga ky regjistër në evidencat format Microsoft excel dhe më pas shkresore për njoftim detyrime drejt tatimpaguesve, raportime midis drejtorive apo drejt titullarit.

B. Rakordimi midis DTA dhe DBF të Bashkisë Dropull. Rakordimi analitik periodike e vjetor, i dokumentuar i të ardhurave është bërë duke nënshkruar NZ për vitin 2025 znj.J.V Përfaqësuesja e Sektorit të të Ardhurave L.Xh dhe Kryetari i Bashkisë Dropull. Treguesit periodikë dhe vjetorë të të ardhurave janë konfirmuar nga përfaqësuesi i Degës së thesarit Gjirokastër zj.E.G.
Drejtoria e Financës dhe Buxhetit përdor për veprimtarinë e saj evidencën e vënë në dispozicion nga DTA, e cila krijohet nga procesi i përpunimit në formatin Excel i informacionit të grumbulluar në regjistrin elektronik vjetor (në të cilin nuk ka të dhëna mbi informacionin historik mbi subjektin) si dhe nga informacioni që paraqesin drejt saj drejtoritë/sektorët të cilat administrojnë taksa dhe tarifa vendore bazuar në paketën fiskale. Procesi i përpunimit bëhet manualisht.
Këto veprime janë në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi: Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 4 pika 26, neni 5, neni 11; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendor*e" i ndryshuar, neni 5, pika "ç"; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar etj.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:
Paketa fiskale e aplikuar nga Bashkia Dropull për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr**. 47, date 21.11.2024** *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore te bashkisë Dropull për vitin 2025*", konfirmuar nga Prefektura Gjirokastër me nr.953/1 prot, datë 04.12.2024.
Në këtë dokument janë përcaktuar afatet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit privat dhe familjar. Afati i pagesës është pjesë integrale e paketës fiskale, si një element i rëndësishëm i taksave dhe tarifave vendore dhe si i tillë duhet t'i nënshtrohet gjykimit të Këshillit Bashkiak. Në dokumentin e Paketës Fiskale, në pikën nr. 4 të saj ku trajtohet niveli i taksave dhe tarifave vendore janë përcaktuar afatet e pagesës së tyre, ku thuhet se:

"Pagesa e kësteve të tatimit kryhet në banka e nivelit të dytë dhe në Posta Shqiptare sha për llogari të administratës tatimore, brenda datës 20 Prill,20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor të çdo viti".

Përcaktimi i afatit të pagesës duhet të jetë i tillë që të garantojë mbledhjen e të ardhurave brenda një kohe të caktuar (kryesisht brenda 6-mujorit të parë të vitit) me qëllim që me këto të ardhura të sigurohet financimi i shpenzimet të miratuara në planin vjetor të buxhetit. Sa më sipër, në pajtueshmëri me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, germa "c", ku përcaktohet që: "Përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet

e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".

Kapacitetet fiskale të taksapaguesve

Paguesit e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Dropull janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjithë njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat e regjistrave të taksapaguesve, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën objekt auditimi, 184 subjekte biznesi kanë ushtruar aktivitet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, siç paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr.7: Evidenca e *subjekteve që kanë ushtruar aktivitet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore* *Në numër*

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit	Pezull	Aktiv
1	Biznesi Vogël							
		2024	112	3	2	113	1	112
		2025	112	6	3	**115**	6	109
2	Biznesi Madh							
		2024	70	1	-	71	2	69
		2025	69	3	**3**	**69**	-	69
(1+2)	Gjithsej							
		2024	182	4	2	184	3	181
		2025	181	9	6	**184**	6	178

Burimi: Bashkia Dropull

Për vitin 2025, kanë ushtruar aktivitet 184 subjekte *(115 subjekte të biznesit të vogël, 69 subjekte Sipas të dhënave të DTA, me dt 01.01.2025 numri i subjekteve që ngarkohen me taksa dhe tatime përfshin këto kategori abonentësh:*

- *Abonentë familjarë : 4,767,*
- *Biznesi juridik 185,*
- *Institucione 5,*
- *Fermerë, blegtorë dhe aktivitet fond kullosor 75*

Gjithsej 5,042 subjekte tatimpaguese.

Sipas Vendimit KB Dropull nr.67, datë 17/12/2024 "*Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 dhe buxhetit të Bashkisë Dropull për vitin 2025",* plani i të ardhurave totale nga burimet e veta vendore për vitin 2025 ishte 71.513 mijë lekë dhe u realizua 66.969 mijë lekë ose 94%,

Në të ardhurat nga burimet e veta vendor**e** përfshihen 1.të *ardhurat nga taksat vendore, 2.nga taksat e ndara, 3.të ardhurat nga tarifat vendore dhe 4.të ardhurat nga burime të tjera.*

Në strukturë, të ardhurat e veta të realizuara gjatë vitit 2025, pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga tarifat vendore me 45%; të ardhurat nga taksat vendore me 32%; të ardhurat nga taksat e ndara me 17% dhe të ardhurat e tjera me 6% të totalit

Analiza e realizimin e të ardhurave (taksa e tarifa vendore), Plan-Fakt për periudhën objekt auditimi, 01.01.2025 deri më 31.12.2025 konfirmuar nga Dega e Thesarit, sipas pasqyrës:

Tabela nr.8: Realizimi dhe planifikimi i të ardhurave vjetore 2025 *Në 000/lekë*

Nr.	Lloji i taksës, tarifës	Plani	Fakti	Realizimi në %
		Viti 2025	Viti 2025	2025
I	**TE ARDHURAT NGA TATIMET**			
1	Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin			
II	**TE ARDHURA TAKSA VENDORE**	**33,200**	**32,850**	**99%**
2	Taksë e Pasurise, Ndërtesa	9,600	9,503	99%
3	Taksë mbi tokën bujqësore	7,800	7,523	96%
4	Takse mbi truallin	2,600	2,479	95%
5	Taksë Regjistrim Automjeti	4,200	4,631	110%
6	Të ardhura nga të ardhurat personale	3,000	6,517	217%
7	Taksa e Rentës minerare		1	
8	Taksë mbi Kalimin e Pronësisë	100	214	214%
9	Taksë Ndikimit në Infrastrukturë	5,000	1,349	27%
10	Taksë Tabele	500	394	79%
11	Taksë fjetje në hotel	200	96	48%
12	Takse Parkimi	100	143	0%
13	Taksë për hapësira Publike	100		
III	**TE ARDHURA NGA TARIFAT**	**26,164**	**24,652**	**94%**
14	Tarifë Pastrimi	15,082	14,342	95%
15	Tarife Leje Transporti	350	448	128%
16	Tarife vendore për urbanistiken	1,350	333	25%
17	Tarifë Regjistrimi Subjekt i Ri	50	41	82%
18	Tarifë Ndriçimi Publik	4,200	3,792	90%
19	Tarifa administrative dhe rregullatorë	2,632	3,016	115%
20	Tarife vendore për varreza	1,300	1,170	90%
21	Tarife vendore për leje shfrytëzimi karburantesh	1,000	1,443	144%
22	Te ardhura nga shërbimi MNZH	200	67	34%
IV	**TE ARDHURA TE TJERA**	**12,149**	**9,467**	**78%**
23	Qera Toke Bujqësore	105	105	100%
24	Qira Kullote	4,606	4,318	94%
25	Shitje e produkteve pyjore	3,640		0%
26	Gjoba	500	1,059	212%
27	Te ardhura nga shitja e mallrave	1,500	860	57%
28	Te ardhura nga shitje trualli	1,500	2,376	158%
29	Qira ndërtese	126	93	74%
30	Dhurata ,Sponsorime,& garanci			
31	Te tjera te ardhura (pronat fond pyjor-kullosor)	122	122	100%
32	Të ardhura të tjera	50	534	1068%
	T O T A L I	**71,513**	**66,969**	**94%**

Burimi: DTA Bashkia Dropull

Për vitin 2025, planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 71,513 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 66,969 mijë lekë, ose 94 %, me një diferencë mosrealizim të treguesit kundrejt planifikimit të të ardhurave buxhetore vendore në vlerën - **4,544 mijë lekë.** Kjo situatë paraqet një ecuri pozitive të financave vendore dhe një rritje të kapaciteteve fiskale të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
Në formë të përmbledhur, të ardhurat gjithsej janë realizuar 94%, nga këto: të ardhurat nga taksat realizuar 99 %, të ardhurat nga tarifat janë realizuar 94% dhe të ardhurat e tjera 78 %:

I. Të ardhurat nga taksat vendore janë realizuar në masën 83% kundrejt planit *(realizuar 25,700 mijë lekë nga 21,334 mijë lekë të planifikuar);* dhe 93%, në krahasim me vitin e mëparshëm. Mosrealizimi në krahasim me planin arsyetohet kryesisht, nga taksa e ndikimit ne infrastrukturë dhe taksa e tabelës. Mosrealizimi vjen nga taksa e ndikimit ne infrastrukture, e cila është realizuar në masën 27%. Krahasuar me vitin 2024 ku realizimi nga të ardhurat nga taksat lokale ishte 22.960, rezultojnë 1.616 mijë lekë më pak të realizuara

LLOJET E TE ARDHURAVE	Realizimi 2024	Realizimi 2025	PLANI 2025
TE ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE	**22,960**	**21,344**	**25,700**
TATIM I THJESHTUAR MBI FITIMIN E BIZNESIT TE VOGEL	25		
TAKSA MBI PASURINE E PALUAJSHME			
TAKSA MBI NDERTESEN	9,348	9,503	9,600
TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE	7,455	7,523	7,800
TAKSA MBI TRUALLIN	2,562	2,479	2,600
TAKSA VENDORE NE SHERBIMIN HOTELIER	96	96	200
TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE NGA NDERTIMET E REJA	3,091	1,349	5,000
TAKSA E TABELES	383	394	500

Burimi: DTA Bashkia Dropull

II. Të ardhurat nga taksat e ndara, realizimi i këtij indikatori në krahasim me planin është 155 % *(realizuar 11,163 mijë lekë nga 7,300 mijë lekë të planifikuar);* dhe krahasuar me vitin e mëparshëm 138%. Tejkalimet paraqiten në të dyja zërat, që janë nga taksa vjetore e *mjeteve të përdorura dhe të tatim mbi të ardhurat personale* (që dërgohet nga DPT-ja), e argumentuar si rezultat i rritjes së pagave gjatë vitit 2025 si dhe tek zëri taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura nga regjistrimi i makinave nëpër rrethe që i përkasin firmave nën juridiksionin e bashkisë Dropull.

LLOJET E TE ARDHURAVE	Realizimi 2024	Realizimi 2025	PLANI 2025
TE ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA (GRANTE)	**8,210**	**11,363**	**7,300**
TAKSA MBI KALIMIN E TE DREJTES SE PRONESISE/PASURITE E PALUAJTSHME			100
TAKSA VJETORE PER QARKULLIMIN E MJETEVE TE PERDORURA	4,597	4,631	4,200
TAKSA E RENTES MINERARE		1	
TAKSA MBI TE ARDHURAT PERSONALE	3,536	6,517	3,000
TAKSA MBI KALIMIN E PRONESISE	77	214	

Burimi: DTA Bashkia Dropull

III. Të ardhurat nga tarifat vendore, rezulton një mosrealizim në krahasim me planin vjetor të miratuar, realizuar 92 % e planit vjetor *(realizuar 30,095 mijë lekë nga 32,592 mijë lekë të planifikuar)*. Me konkretisht, evidentohet se është plani është realizuar në masën 91% të tij. Mosrealizimi vjen nga mos vjelja e tarifave për urbanistiken (25%) për shkak të mos pajisjes me leje ndërtimi. Gjithashtu mosrealizim ka në lidhje me tarifën e shërbimit te vaditjes (realizuar 57%); Gjithashtu, mosrealizim ka edhe tek tarifat e pastrimit dhe ndriçimit te familjareve të cilat janë realizuar 90%.Në krahasim me vitin 2024 realizimi i kësaj kategorie të të ardhurave nga tarifat vendore është +3,789 mijë lekë më tepër.

LLOJET E TE ARDHURAVE	Realizimi 2024	Realizimi 2025	PLANI 2025
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	**26,306**	**30,095**	**32,592**
TARIFA ME MENAXHIMIN E MBETJEVE			
TARIFA E PASTRIMIT PER FAMILJET	4,743	5,246	5,870
TARIFA E PASTRIMIT PER INSTITUCIONET	260	312	312
TARIFA E PASTRIMIT PER BIZNESIN	7,707	8,784	8,900
TARIFA PER NDRICIM PUBLIK	2,522	3,792	4,200
TARIFA PER SHERBIMET ADMINISTRATIVE TE BASHKISE			
TARIFA PER SHERBIMET ADMINISTRATIVE TE BASHKISE	2,212	3,016	2,682
TARIFA TE KONTROLLIT TE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT			
TARIFE PER RREGJISTRIM BIZNESI	36	41	50
TARIFA VENDORE PER URBANISTIKEN	588	333	1,300
TARIFA E LICENSIMIT TE VEPRIMTARIVE TE TRANSPORTIT	382	448	350
TARIFA E PARKIMIT PER MJETET E LICENSUARA DHE VENDPARKIME PUBLIKE	152	143	100
TARIFA PER DHENIE LICENSE PER TREGETIMIN E NAFTES BRUTO DHE NENPRODUKTEVE TE SAJ	1,571	1,443	1,000
TARIFA PER PYJET DHE KULLOTAT	3,747	4,440	4,728
TARIFA PER SHERBIMET SHTESE NGA ZJARREFIKESJA	149	67	200
TARIFE PER ZENIEN E HAPESIRES PUBLIKE			100
TARIFA PER SHERBIMIN E UJITJES DHE KULLIMIT	1,102	860	1,500
TARIFA TE TJERA(sh/v)	1,135	1,170	1,300

Burimi: DTA Bashkia Dropull

IV. Të ardhurat e tjera në viti 2025 kanë mosrealizim për rreth 30 %, *(realizuar 4,167 mijë lekë nga 5,921 mijë lekë të planifikuar).*Në krahasim me vitin 2024 ku realizimi ishte 1.601 mije leke, evidentohet të jenë arkëtuar + 2.566 mijë lekë më tepër për këtë grup të të ardhurave.

LLOJET E TE ARDHURAVE	Realizimi 2024	Realizimi 2025	PLANI 2025
TE ARDHURA TE TJERA	**1,601**	**4,167**	**5,921**
QERAJA NGA ASETET NE PRONESI TE BASHKISE	276	198	231
SHITJA E MALLARAVE DHE SHERBIMEVE			3,640
KUDRAVJATJET ADMINISTARTIVE(GJOBAT)	1,087	1,059	500
GRANTE DHE NDIHMA NDERKOMBETARE			0
SHITJA E ASETEVE FINANCIARE			
SHITJA E ASETEVE FIKSE TE PREKSHME/ PAPAREKSHME		2,376	1,500
TE TJERA	238	534	50

Burimi: DTA Bashkia Dropull

B.Analiza krahasuese e realizimin e të ardhurave (taksa e tarifa vendore) për realizimin faktik te v.2025 krahasuar me realizimin faktik të vitit 2024, sipas pasqyrës së mëposhtme:

krahasuar me vitin 2024 ku realizim ishte 59.077 d.m.th 7.892 mijë lekë më teper,në fakt ky realizim tepër ka ardhur nga të ardhura nga taksa te ndara (grante) dhe nga tarifat.

në 000/lekë

Grupimi	Realizim Viti 2024	Realizmi Viti 2025	Diferenca
Te ardhura nga taksat vendore	22.960	21.344	-1.616
Te ardhurat nga taksat e ndara	8,210	11,363	3,153
Te ardhura nga tarifat vendore	26,306	30,095	3,789
Te ardhura te tjera	1,601	4,167	2,566
Të ardhurat e veta vendore (gjithsej)	**59.077**	**66.969**	**7.892**

Burimi: Bashkia Dropullit, përpunoi grupi i auditimit

Tabela nr..9. Realizimi dhe planifikimi i të ardhurave vjetore 2024 dhe 2025 në mije leke

Nr.	Lloji i taksës, tarifës	Plani Viti 2024	Fakti Viti 2024	Realizimi në % 2024	Plani Viti 2025	Fakti Viti 2025	Realizimi në % 2025
I	**TE ARDHURAT NGA TATIMET**		**25**				
1	Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin	0	25				
II	**TE ARDHURA TAKSA VENDORE**	**32,823**	**31,297**	**95%**	**33,200**	**32,850**	**99%**
2	Taksë e Pasurise, Ndërtesa	9,500	9,348	98%	9,600	9,503	99%
3	Taksë mbi tokën bujqësore	7,800	7,455	96%	7,800	7,523	96%
4	Takse mbi truallin	2,600	2,562	99%	2,600	2,479	95%
5	Taksë Regjistrim Automjeti	4,200	4,597	109%	4,200	4,631	110%
6	Të ardhura nga të ardhurat personale	2,500	3,536	141%	3,000	6,517	217%
7	Taksa e Rentes minerare					1	
8	Taksë mbi Kalimin e Pronësisë	0	77		100	214	214%
9	Taksë Ndikimit në Infrastrukturë	5,000	3,091	62%	5,000	1,349	27%
10	Taksë Tabele	1,000	383	38%	500	394	79%
11	Taksë fjetje në hotel	123	96	78%	200	96	48%
12	Takse Parkimi	100	152	152%	100	143	0%
13	Taksë për hapersira Publike				100		
III	**TE ARDHURA NGA TARIFAT**	**22,652**	**21,305**	**94**	**26,164**	**24,652**	**94%**
14	Tarifë Pastrimi	13,360	**12,710**	95%	15,082	14,342	95%
15	Tarife Leje Transporti	250	382	153%	350	448	128%
16	Tarife vendore për urbanistiken	1,300	588	45%	1,350	333	25%
17	Tarifë Regjistrimi Subjekt i Ri	50	36	72%	50	41	82%
18	Tarifë Ndriçimi Publik	3,000	2,522	84%	4,200	3,792	90%
19	Tarifa administrative dhe rregullatore	2,212	2,212	100%	2,632	3,016	115%
20	Tarife vendore për varreza	1,280	1,135	89%	1,300	1,170	90%

21	Tarife vendore për leje shfrytëzimi karburantesh	1,000	1,571	157%	1,000	1,443	144%
22	Te ardhura nga shërbimi MNZH	200	149	75%	200	67	34%
IV	**TE ARDHURA TE TJERA**	**25,328**	**25,097**	**99%**	**12,149**	**9,467**	**78%**
23	Qera Toke Bujqësore	105	105	100%	**105**	**105**	100%
24	Qera Kullote	4,525	3,625	80%	4,606	4,318	94%
25	Shitje e produkteve pyjore	200		0%	3,640		0%
26	Gjoba	500	1,087	217%	500	1,059	212%
27	Te ardhura nga shitja e mallrave	1,200	1,102	92%	1,500	860	57%
28	Te ardhura nga shitje trualli	1,500	906	60%	1,500	2,376	158%
29	Qera ndërtesë	126	171	136%	126	93	74%
31	Dhurata ,Sponsorime,& garanci	17,000	17,741	104%			
31	Te tjera te ardhura (pronet fond pyjor-kullusor)	122	122	100%	122	122	100%
32	Të ardhura të tjera	50	238	476%	50	534	1068%
- *Libra kontabiliteti, ditarë kontabiliteti, si dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet.*
- *Dokumente të tjera kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme.*

dhe të Kreut III, paragrafi 54, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar:

54. Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si procesverbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.

Ditarët e mbajtur për regjistrimin e veprimeve kontabile: Nga verifikimi i pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore rezulton se, janë mbajtur ditarët për regjistrimin e veprimeve kontabile të thesarit, ditari i magazinës, ditari i arkës dhe centralizatori për veprimet përmbledhëse. Llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, kuadrojnë si shumë totale (Aktivet gjithsej = Pasivet + Fondet neto); llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike, *trajtuar më hollësisht në vijim*. Veprimet kontabile janë azhurnuar periodikisht nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, janë pasqyruar veprimet në ditarë, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi.

Sa më sipër, kanë gjetur zbatim përcaktimet e Kreut I, paragrafi 2.2.6, të UMF nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar:

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues, të cilët dallohen në:

- *Dokumente bazë justifikuese (faturë blerje/ shitjeje, fletëhyrje/dalje, mandatarkëtim/pagesë), të prodhuara manualisht ose nëpërmjet programeve informatike dhe shërbejnë për kryerjen e regjistrimeve fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik në librat e kontabilitetit.*
- *Urdhër shpenzimi/urdhërpagesa që përdoren në marrëdhëniet e njësive të qeverisjes së përgjithshme me degën përkatëse të thesarit, për paraqitjen e kërkesave për kryerjen e një shpenzimi apo ekzekutimin e një pagese, nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).*
- *Libra kontabiliteti, ditarë kontabiliteti, si dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet.*
- *Dokumente të tjera kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme.*

Gjatë auditimit të kryer për periudhën objekt shqyrtimi, konstatohet se mbajtja e llogarive kontabël dhe nxjerrja e bilancit për vitin 2025, është realizuar në mënyrë manuale, duke përdorur programin *"Microsoft Excel".* Ky program i pa certifikuar për mbajtjen e regjistrave financiare, nuk mund të konsiderohet si *"bartës informatik*", sipas përkufizimit të dhënë nga dispozitat e akteve ligjore e nënligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
"Bartës informatik" është çdo dokument kontabël i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.
Sipas Kreut 2.2 "Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik", pika nr. 6 të Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 dhe UMF nr. 30, dt. 27.12.2011, "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", njësitë e qeverisjes vendore kanë për detyrë të evidentojnë në mënyrë kronologjike dhe të dokumentuar çdo transaksion ekonomik. *Çdo transaksion duhet të mbështetet në bartësit e informacionit kontabël përkatës* (mandate, fletë-hyrje/dalje, ditarë, libra kontabël etj.), në përputhje me sistemin e llogarive buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave.
Në këtë kuadër, Bashkia Dropull duhet të ndërmarrë masa për përmirësimin e sistemit të kontabilitetit dhe implementimit të programeve financiare, *që garantojnë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.*

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:
Për vitin 2025, nga verifikimi dhe testimi i transaksioneve për çdo muaj, të ditarit kontabël të bankës për shpenzimet sipas natyrës (Klasa 6 dhe Klasa 2) me akt-rakordimin e thesarit mbi bazën e dokumentit të nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj, për shumat në çdo llogari dhe në totalin mujor e vjetor, nuk konstatohen diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës së shpenzimeve, ku janë hedhur autorizimet buxhetore (çeljet) dhe destinacionet e përdorimit të fondeve sipas llojit të shpenzimeve dhe klasave të llogarive.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit është raportuar Degës së Thesarit, si vijon:

- Situacioni i Shpenzimeve Vjetore (me burim nga granti i pakushtëzuar dhe specifik, nga të ardhurat dhe nga granti i kushtëzuar) për vitin 2025, është hartuar dhe ngarkuar në sistem nga ana e Bashkisë Dropull. Ky situacion është nënshkruar rregullisht nga NA z. Dh.T - Kryetar i Bashkisë dhe NZ i njësisë shpenzuese znj.S.R me datë 30.01.2026 dhe nga nëpunësi i Degës së Thesarit.
- Me datën 19.02.2026 është mbajtur akti i rakordimit midis përfaqësuesve të Bashkisë Dropull dhe Degës së Thesarit Gjirokastër, mbi rakordimin e nivelit të realizimit të ardhurave sipas kategorive dhe të shpenzimeve vjetore 2025.
- Sipas shkresës me nr. 360, datë 18.02.2026 është mbajtur akt rakordimi i periudhës Janar-Dhjetor 2025, ku janë evidentuar dhe shumat e të ardhurave që trashëgohen nga viti 2025 në vitin 2026 në PLTH. Sa më sipër, nga ana e Bashkisë Dropull ka nënshkruar Nënkryetari z.P.Dh. dhe znj.S.R, NZ kurse për DTH nga specialisti i thesarit z.A.K.
- Me datën 24.02.2026 është mbajtur akti i rakordimit midis përfaqësuesve të Bashkisë Dropull dhe Degës së Thesarit Gjirokastër, mbi rakordimin e mjeteve në ruajtje (llogaria 4662104 dhe llog.4660000, në trajtë progresive për periudhën Janar-Dhjetor 2025.

Pra, rezulton se, për periudhën e audituar, në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat e kësaj Bashkie janë mbajtur akt rakordimet periodike e vjetore, që janë kundër-firmuar rregullisht për të dhënat nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. *Për sa sipër,* është vepruar në përputhje me përcaktimet e: Ligjit nr.9936, date 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" i ndryshuar, neni 3, pika 4 dhe 6, Paragrafit nr.88 dhe 221, të Kreut IV, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar; Paragrafit nr.12, UMFE nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në UMFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme".

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Dropull për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2025, deri më datën 31.12.2025.** Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve të transaksioneve, proceduara anlitike dhe teste thelbësore, ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2025 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2024.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike, trajtuar hollësisht në vijim.

Tabela nr. 17, *Llogaritja e nivelit të materialitetit për vitin 2025: Treguesi i precizionit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet vjetore për bashkinë është* **5,654,394 lekë.**

Nga procesi i auditimit dhe verifikimi i vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2025, mbi saktësinë dhe besueshmërinë e tyre, treguesit e aktiveve dhe aktiveve neto paraqiten si më poshtë:

Tabela nr 18, të dhënat në Lekë

	31.12.2025	31.12.2024
Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto	**1,983,732,908**	**1,809,695,277**
Aktivet	2,021,758,611	1,876,484,865
Pasivet	38,025,703	66,789,588

Lekë

	31.12.2025	31.12.2024
Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.	**168,870,173**	**134,425,934**
Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues"	22,238,194	18,394,892
Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra"	29,134,491	29,541,214
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre"	117,497,488	86,489,828

Burimi: Bashkia Dropull, PFV 2025.

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhen nga:

Tabela nr 19, Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	117,497,488	86,489,828	31,007,660
50	Letra me vlerë			
532	Vlera të tjera			
54	Akreditiva dhe paradhënie			
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)			
Totali		117,497,488	86,489,828	31,007,660

- **Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar"** paraqitet më datë 01.01.2025, në vlerën 86,489,828 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 117,497,488 lekë.

Nga të dhënat analitike sipas pasqyrave të pozicionit financiare të njësisë shpenzuese Bashkia Dropull rezulton se llogaria 520 "Disponibilitete në Thesar" në fund të vitit 2025 është pasqyruar në vlerën vlerën 117,497,488 lekë që është shuma e gjendjeve analitike të kësaj llogarie. Nga auditimi i të dhënave sipas akt rakordimeve shkresore me thesarin për të ardhurat e trashëguara u konstatua se nuk ka mospërputhje midis të dhënave për të ardhurat e trashëguara nga viti 2025 me llogarinë 520 "Disponibilitete në Thesar", me vlerën e tyre të regjistruar në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore për vitin 2025.

Akt rakordimi i nënshkruar nga NA dhe ZN dhe Përgj. Degës së Thesarit për të ardhurat e vitit 2025 të disponueshme në SIFQ dhe që trashëgohen në vitin 2026 është 108,606,276 lekë, e barabartë me TD të llog.520 në bilanc minus (-) vlera e llog. 466.

Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" (TK) në vlerën 108,606,276 lekë dhe llogarisë 466

"Kreditorë për mjete në ruajtje" (TK) në vlerën 8,891,212 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" është në vlerën 117,497,488 lekë (TD).
Më hollësisht,

- ✓ ***Llogaria 85, "Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur",*** është paraqitur në rubrikën C të Pasqyrës së Performancës Financiare 2025 (F2) që në fund të vitit 2025 është në shumën 108,606,276 lekë, e barabartë me zërin "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85)", që evidentohet në rubrikën C, të Aktiveve neto/ Fondeve neto në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1).

85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	108,606,276	49,241,454

- ✓ ***Totali i mjeteve në ruajtje***, sipas akt rakordimit nr. ska, datë 24.02.2026 të mbajtur me Degën e Thesarit, është 8,891,212 lekë dhe përputhet me shumat e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në pasqyrën F1 të Bilancit Kontabël, që është për të njëjtën vlerë.

		Viti 2025	Viti 2024
520	Disponibilitete në Thesar	117,497,488	86,489,828

466	Kreditore për mjete ne ruajtje	8,891,212	37,248,374
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	108,606,276	49,241,454
	Shuma (llog. 466 + 85):	117497488	

Burimi: Bashkia Dropull, DBF.

Këto veprime janë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa "dh", si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, paragrafët 49-50, ku përcaktohet që:

Paragrafi 49. Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.
Paragrafi 50. Tepricat e ***llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin****, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).*

2. Llogaritë e klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhen nga:
Tabela nr. 20, Lekë

	Emërtimi i llogarive	**31.12.2025**	**31.12.2024**	**Diferenca/Ndryshimi 2025-2024**

Llogaritë kontabël				
31	Materiale			
32	Inventar i imët	22,238,194	18,331,892	3,906,302
33	Prodhime, punime e shërbime në proces			
34	Produkte			
35	Mallra	0	63,000	-63,000
36	Kafshë në rritje e majmëri			
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarit (-)			
Totali		**22,238,194**	**18,394,892**	**3,843,302**

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull

- Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2025, paraqitet në vlerën 22,238,194 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 0 lekë dhe llogaria 32 "Inventar i imët" 22,238,194 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën +3,843,302 lekë, e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit", e paraqitur në të njëjtën vlerë në Formatin F2 *"Pasqyra e Performancës Financiare",* (Grupi VIII, rreshti 120). Sa me sipër, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 4.1:

Llogaria 63, "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Kjo kategori ka veçori për sektorin publik, se nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Funksionimi kontabël është si më poshtë: a) Kur blihen, bëhen hyrje materialet: - Debitohet klasa 3, "Gjendje inventari qarkullues"; - Kreditohet 63, "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". b) Kur bëhen dalje materialet: - Debitohet 63, "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"; - Kreditohet klasa 3, "Gjendje inventari qarkullues"

- **Llogaria 31 "Materiale"**, ka vlerën 0 lekë me datën 01.01.2025 dhe nuk ka asnjë lëvizje të kësaj llogarie për vitin 2025.

- **Llogaria 32 "Inventarë i imët"**, ka vlerën 22,238,194 lekë në fund të vitit ushtrimor 2025 dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2025	18.394.492
Shtesa (D)	3.906.302
Pakësime (K)	63.000
Gjendja në 31.12.2025	**22,238.194**

Gjendja e llogarive të mësipërme materiale është e kuadruar me tepricën e tabelave të inventarizimit fizik të pasurisë. Për kryerjen procedurave të inventarizimit të pasurisë është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrat e inventarizimit ku është përcaktuar grupi për inventarizimin e aktiveve. *Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*".

3. Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhen nga:

Tabela nr.21 Të dhënat në lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba			
431	Tatime e taksa			
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal			
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti			
435	Sigurime Shoqërore			
436	Sigurime Shëndetësore			
437,438	Organizma të tjerë shoqërore			
44	Institucione të tjera publike			
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes			
468	Debitorë te ndryshëm			
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	12,469,452	12,926,685	-457,233
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	16,665,039	16,614,529	50,510
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)			
Totali				
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Parapagime		0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin		0	
477	Diferenca konvertimi aktive		0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime		0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	4,480,060	4,480,060
Totali		**29,134,491**	**34,021,274**	**-4,886,783**

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull

Konstatim: Në bilancin e vitit të mëparshëm (ushtrimi paraardhës 2024), shuma e komponentëve/ grupit të llogarive "*Të tjera aktive afatshkurtra"* në rreshtin 41 të Formatit 1 "Pasqyra e Pozicionit Financiar" që përbëjnë llogaritë e arkëtueshme (llog. 468, llog. 4842 dhe llog. 486) është 34,021,174 lekë, ndërsa në bilanc është paraqitur gabim për 29,541,214 lekë, duke mos përfshirë shumën 4,800,060 lekë, që përfaqëson vlerat e regjistruara në llogarinë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme". Kjo pasaktësi ndikon në kuadrimin e bilancit të vitit paraardhës dhe në saktësinë e mbartjes së të dhënave në ushtrimin e vitit 2025:

	4.Te tjera aktive afatshkurtra	**0**	
409	Parapagime		
473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		
481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	0	4,480,060

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull, fragment nga Pasqyra F1 e Llogaridhënies Vjetore 2025

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 12.469.452 lekë. Analiza e detajuar e lëvizjeve të llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr.22 Të dhënat në lekë

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"

Çelje e vitit 2025	12.926.685
Shtesa (D)	3.064.255
Pakësime (K)	3.521.488
Gjendja në 31.12.2025	**12.469.452**

- Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2025, më datën 01.01.2025 paraqitet në vlerën 12,926,685 lekë, është shtuar gjatë vitit në vlerën 3,064,255 lekë, pakësuar nga shlyerjet e detyrimeve për 3,521,488 lekë, ndërsa gjendja më 31.12.2025 paraqitet në vlerën 12,469,452 lekë. Në këtë llogari janë evidentuar detyrimet e personave dhe subjekteve të ndryshme ndaj Bashkisë, që kanë lindur sipas raporteve të auditimit të KLSH-së, në vitin 2019, 2023 dhe 2025 si dhe detyrimet për taksa dhe tarifa vendore të papaguara deri në 31.12.2025.

Tabela nr.23 Të dhënat në lekë

Debitorë subjekte dhe individë	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
E (P)	1.854.605			1 854 605
A.k (zyrat)	617.500			617 500
A. k. (U . M)	947.400			947 400
R. T.&Sh. Shpk	185 561		185.561	-
K.K. SH.p.k	313 500		313.500	-
OE '.P. SH.P.K		104.835	104.835	-
OE " Rr. & H " Sh.p.k		210.000		210.000
OE "I.' Sh.p.k		73.300		73.300
OE " I. Shpk		152.000		152.000
Gj Shpk		245.771	245.771	-
OE-N Sh.p.k	410 993			410 993
a/gj. j shpk	61 804			61 804
G.M	116 965			116 965
I.P	100 000			100 000
Th. Q	19 393			19 393
Th. Q	128 067			128 067
T-D	122 117			122 117
Tatimet (sipas listës) biznesi	**879.497**	**341.262**	**86.368**	**1.134.391**
I. D.	300 193			300 193
K. B.	219 020			219 020
P. Sh.	321 950			321 950
J. M.	3 555			3 555
Debitorët nga taksa e tokës bujqësore dhe familjaret	**6.324.565**	**1.937.087**	**2.585.453**	**5.676.199**
Totali	**12.926.685**			**12.469.452**

Burimi: Bashkia Dropull

Konstatim: Evidentohet një nivel i lartë detyrimeve debitore në Bashkinë Dropull në fund të vitit 2025 prej **12,469,452 lekë,** që për vitin kanë si arkëtim vetëm shumën prej 3,521 mijë lekë. Rezulton se në fund të vitit,2025, detyrimet debitorë janë pakësuar vetëm për - 457,233 lekë, ose – 3.5 % më pak se fundi i vitit të mëparshëm, ku shtesat e llogarisë së debitorëve janë 3,064,255 lekë dhe likuidimet/ shlyerjet për 3.521.488 lekë.

I. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet një nivel i lartë i detyrimeve të mbartura e të trashëguara për taksat e tokës bujqësore, të biznesit, të ndërtesave etj., nga vitet e mëparshme (**2011-2024**), në shumën 6,810,590 lekë ose 54.6 % e shumave të regjistruara në llog. 468, për të cilat nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit administrohen listat e dërguara nga Zyra e Tatim Taksave të Bashkisë dhe Njësive Administrative Dropull i Poshtëm, Pogon dhe Dropull i Sipërm

Rezulton se për Njësitë Administrative Dropull i Poshtëm, Pogon dhe Dropull i Sipërm detyrimet debitore për mos likuidimin e taksës së tokës dhe të ndërtesës i përkasin periudhës 2011-2024**.** Ky problem është trajtuar edhe në raportet e mëparshëm të auditimit të KLSH-së, ku është rekomanduar për gjetjen e origjinës nga ka lindur detyrimi, arkëtimin e këtyre vlerave, deri në ngritjen e padive gjyqësore, por mungojnë veprimet korrigjuese për sa më sipër.

Sa më sipër, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar;

g) garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mblidhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta

neni 42 pika 1-5 të ligjit nr.67/2017, datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar;

1. Të ardhurat e miratuara në vendimin e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për buxhetin vjetor përbëjnë kufirin minimal për t'u arkëtuar gjatë vitit buxhetor.
2. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.
4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vlerësime sistematike për të identifikuar risqet dhe marrin masa për të shmangur evazionin fiskal.
5. Niveli, kohëzgjatja dhe struktura e detyrimeve tatimore të evidentuara e të paarkëtuara në kohë evidentohen dhe raportohen si pjesë e raporteve periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Ligjin nr.9632, datë 30,10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", Kapitulli II, pika 6: *"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues…".*

II. Nga ana e Bashkisë së Dropullit nuk janë kryer procedurat e kërkimit të detyrimeve në rrugë administrative e gjyqësore, por llogaria "Debitorët e ndryshëm" (llog. 468) në fund të vitit 2025 paraqitet në shumën prej 12,469,452 lekë. Për periudhën 1-vjeçare (1.1.2025 deri më 31.12.2025), niveli i arkëtimit të debitorëve është 3,521,488 lekë,

Detyrimet në vlera më të larta analizohen sipas rubrikave në vijim:

ED-K. (P)	1.854.605
A.K (zyrat)	617.500
A.K (M)	947.400
R.T&Sh. Shpk	185 561
K.K SH.p.k	313 500
OE-N. sh.p.k	410 993
I.D	300 193
Firma" I. "	542,000

Për debitorët e lidhur me raportet e auditimit të KLSH-së nuk është proceduar duke depozituar padi dhe kërkuar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e detyrimit, ndaj këto detyrime rezultojnë të paarkëtuara, pasi bazuar në periudhën e krijimit të detyrimeve, mos arkëtimi i tyre krijon riskun që subjekti vendor të humbasë fuqinë ligjore të kërkimit të kësaj të drejte. Kjo, bazuar në nenin 203, pika 1, të Kodit të Punës së RSH *"Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet",* si dhe neni 115 i Kodit Civil "*Parashkruhen brenda afateve prej:.... dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë"*. Në lidhje me detyrimet e debitorëve, të krijuar që nga viti 2019 dhe paraqitur në raportet e auditimit të KLSH-së), bazuar në Kodin Civil, neni 114 "Afatet e parashkrimit" ku shprehet se "*Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë"* , për këto detyrime debitore ekziston rreziku i parashkrimit të tyre.

Mosarkëtimi në afat i debitorëve sjell riskun e parashkrimit për arkëtimin e të drejtave dhe të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit dhe veprime në jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë "i*

ndryshuar; nenet 8, 9, 10, 11, 12 dhe 27 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, si dhe Manualit të Menaxhimit Financiar e Kontrollit, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 26.01.2024 të Ministrit të Financave, (Kreu II, paragrafët 2.4.4 dhe 2.4.6 dhe aneksi nr. 6); Udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "*Për nëpunësin zbatues të të gjitha niveleve",* Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 3.12.2024 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike",* neni 7, pika 1/d.

III. Nuk është pasqyruar në ditarët e kontabilitetit dhe në centralizatorin përmbledhës të llogarive, ***llogaria 470 "Llogari në pritje - të ardhura për t'u marrë"*** që shërben si kundërparti e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 7, të Udhëzimit të MF nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"", ku përcaktohet që:

Pika 7. Në rubrikën 2.3 "Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik", paragrafi 21, shtohet pika c me këtë përmbajtje:
c) Për njohjen (me konstatimin) e të drejtave për t'u arkëtuar bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:
Njësitë e qeverisjes së përgjithshme që njohin të ardhurat në kontabilitet sipas paragrafit 16 (e) administrojnë të drejtat për tu arkëtuar dhe debitorët e njësisë si më poshtë:

- ✓ *Për konstatimin paraprak të të drejtave për t'u arkëtuar* debitohen llogaritë përkatëse të klasës 4 (411/468) "Debitorë të ndryshëm" dhe Kreditohet llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë" në analiza shtatëshifrore sipas tipologjisë së të drejtave për tu arkëtuar.
- ✓ *Për arkëtimin e të drejtave,* në të njëjtën kohë me veprimet sipas pikës 16 (e) dhe 22, kryhet veprimi i kundërt: debitohet llogaria 470 dhe kreditohet llogaria përkatëse e të drejtave e debituar më parë (411/468).

Pika 16/e: Për të ardhurat e shfrytëzimit, në momentin e njohjes, bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë: Debitohet llogaria përkatëse financiare (klasa 5); dhe Kreditohet llogaria përkatëse e të ardhurave (klasa 7).
Pika 22: Llogaritë përkatëse financiare në klasën 5 funksionojnë si më poshtë vijon: Debitohet llogaria financiare përkatëse; Kreditohet llogaria përkatëse e të ardhurave (klasa 7), "Të ardhurat sipas natyrës ekonomike

Pasqyrimi i llogarive 4342 *"Operacion me shtetin (të drejta)"* dhe 4341 *"Operacione me shtetin (detyrime)"* në pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore:

- Gjendja e llogarisë ***4342 "Operacion me shtetin (të drejta)***" *(financim i pritshëm nga buxheti),* sipas PFV të depozituara në Degën e Thesarit, paraqitet në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar më datën 01.01.2025 në vlerën 16,614,529 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 16,665,039 lekë, ose me një shtim në vlerën 50,510 lekë ndaj vitit të mëparshëm.

4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	16,665,039	16,614,529

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)

Çelje e vitit 2025	**16.614.529**
Shtesa (K)	50.510
Pakësime (D)	0
Gjendja në 31.12.2025	**16.665.039**

Tabela nr.24, Të dhënat në lekë

Operacion me shtetin (të drejta)	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Energji Elektrike	712.676	28.692		741.368
Ujë	16.000		22.457	38.457
Këshilltaret Kryetaret e fshatrave	935.000		29.367	905.633
% e Postes Shqiptare	97.743	977		98.720
Ndihma ekonomike	246.949	6.430		253.379
Celular	13.000		13.000	0
Pagat	11.546.342	168.048		11.714.390
Tatimet	995.095		164.691	830.404
Sigurimet Shoqërore	2.051.732	30.956		2.082.688
Totali	**16.614.529**	**235.103**	**229.515**	**16.665.039**

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull

Referuar Planit Kontabël dhe udhëzimeve të MF, kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 401, 421, 431, 435, 436, 437 dhe 467 dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit të bashkisë për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara *(grantet korrente a kapitale që merren nga buxheti i shtetit).*

Sipas UMF nr. 8, datë 09.03.2018, llogaria 4342, *"Operacione me shtetin (të drejta)"* është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për *shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara* (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla janë zëra si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo detyrimet për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm, etj.

- Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:

Debitohen llogaritë respektive të klasës 6, "Shpenzime sipas natyrës" dhe Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40 e të tjera).

- Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:

Debitohet llogaria 4342, "Operacione me shtetin (të drejta)", Kreditohet llogaria 7206, "Financim i pritshëm nga buxheti".

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, përmbledhësja e llogarive 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" dhe llog e klasës 4-rt, janë në vlerën 16,665,039 lekë:

- Llog 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në vlerën 2,037,557 lekë
- Llog 42 "Detyrime nd. aj personelit" në vlerën 11,714,390 lekë;
- Llog 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" në vlerën 830,404 lekë;
- Llog 435 "Sigurime shoqërore" në vlerën 2,082,688 lekë;
- Llog.436 "Sigurime shëndetësore" në vlerën 0 lekë;
- Llog.437,438 "Organizma të tjerë shtetërore" në vlerë 0 lekë dhe
- Llog.467 "Kreditorë të ndryshëm" në vlerën 0 lekë

Shuma **16,665,039** lekë

Konstatim:

Nga auditimi i pasqyrave financiare në lidhje me saktësinë e tepricës së llogarisë 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" në mbyllje të vitit 2024 dhe 2025 rezultoi se:

- **a.** Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" në vlerën 16,665,039 lekë, kuadron me shumën e vlerës së llogarive të detyrimeve për detyrimet e konstatuara dhe të rezultuara më dt 31.12.2025.
  Rezulton se dhe për vitin e mëparshëm 2024, shuma e llogarive të detyrimeve është 16,614,529 =(53,862,903-37,248,374 që është TK e llog 466) lekë, si dhe teprica e llogarisë 4342 është për të njëjtën vlerë për atë vit buxhetor prej 16,614,529 lekë.
- **b**. Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" në vlerën 16,665,039 lekë, kuadron me llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit", në Pasqyrën F2 të Pozicionit Financiar të kësaj Bashkie më dt 31.12.2.2025 prej 16,665,039 lekë, mirëpo **nuk kuadron** me llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit", për tepricën e kësaj llogarie më dt 31.12.2.2024 për një **diferencë prej -3,687,844 lekë** (16,614,529 - 12,926,685) lekë, duke krijuar problematika në bilancin e çeljes së vitit 2025.

Pasqyra F1 e Pozicionit Financiar

llog	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	16,665,039	**16,614,529**

Pasqyra F2 e Performancës Financiare të Bashkisë

7206	Financim i pritshëm nga buxheti	16,665,039	**12,926,685**

Sa më sipër, nuk ka një pozicionim të drejtë të llogarisë sipas udhëzimeve të miratuara mbi kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në fund të vitit 2024 të kësaj llogarie, në përputhje me trajtimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu III, paragrafi 3.3 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)" si dhe paragrafi "Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin", si dhe Aneksi 1 dhe me pikën 8, paragrafi 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i Llogarive të të tretëve (klasa 4)" (Aneksi 1), të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", dhe pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"; nënpika 28, 29 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar:

"Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet me vete), para evidentimit të dhënave ne pasqyrat financiare, duhet që të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore".

***

Referuar përcaktimeve të Kreut III, nënkreu 3.3 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)", pika 8/l, të UMF nr.8, datë 09.03.2018, Llogaria ***4341,*** *"Operacione me shtetin (detyrime)"* është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit

Financiar, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit *për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme*.
Konkretisht, trajtimi kontabël është si më poshtë: Debitohet llogaria 411/468, klientë apo debitorë të ndryshëm për konstatimin e një të ardhure (pavarësisht raportit të pjesëmarrjes buxhet apo institucion) dhe Kreditohen llogaritë respektive të klasës 7 për të ardhurën e konstatuar.
E ardhura që në fund të periudhës ushtrimore nuk është arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të konstatohet detyrimi: Debitohet llogaria 8424, "Transferime buxheti për debitorë e të ngjashëm", Kreditohet llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)".
Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:
Lekë

Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)	
Çelje e vitit 2025	12,926,685
Shtesa (K)	
Pakësime (D)	
Gjendja në 31.12.2025	12,469,452

- **Llogaria 4341 "Operacion me shtetin (detyrime)",** më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 12,469,452 lekë. Teprica e llogarisë 4341 "Operacion me shtetin (detyrime)" sipas PFV të depozituara në Degën e Thesarit për vitin 2025, paraqitet në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar në fund të v.2025 në shumën 12,469,452 lekë (rreshti 83 në pasiv të bilancit, grupi i Pasiveve Afatshkurtra). Më datën 01.01.2025 në vlerën 12,926,685 lekë, ose me një pakësim në vlerën 457,233 lekë ndaj vitit të mëparshëm.

4341	Operacione me shtetin (detyrime)	12,469,452	12,926,685

Nga ana tjetër, shuma e llogarive 411,423-429,468 janë po në të njëjtën shumë, prej 12,469,452 lekë, ku përfshihet vetëm vlerat e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm".

Tabela nr.25 Të dhënat në lekë

468	Debitorë të ndryshëm	12,469,452	12,926,685

Më hollësisht,

llog	Emërtesa	31.12.2025
411	Klientë e llogari te ngjashme	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	0
468	Debitorë të ndryshëm	12,469,452
	Shuma	12,469,452

Sa më sipër, nuk rezultojnë mospërputhje dhe ka një pozicionim të drejtë të llogarisë 4341, në përputhje me trajtimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu I, paragrafi 48 dhe Kreu III, paragrafi 32.

- **Llog.486 "Shpenzimet e periudhave te ardhshme"**, sipas PFV të Bashkisë Dropull për vitin 2025 është evidentuar në vlerën zero lekë, kurse për vitin 2024 është pasqyruar në aktiv (zëri të tjera aktive afatshkurtra (rreshti 4) për tepricën debitore 4,480,060 lekë . Llogaria 486 përfshihet në grupin e llogarive rregulluese dhe përfaqëson shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm *(shpenzime të parapaguara).*

486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	0	4,480,060

Sa më sipër, për vitin 2025 janë zbatuar përcaktimet e paragrafit 15, pika 3.1, Kreu III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të Udhëzimit Nr.5, datë 21.2.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për kryerjen e veprimeve kontabile në lidhje me *llogarinë nr. 4864, "Shpenzime të periudhave të ardhshme", (mbi ndryshimin e paragrafit 42, pika 3.1, Kreu III" Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"),* ku përcaktohet shprehimisht se:

Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qevensjes së përgjithshme", Paragrafi 42 ndryshon si vijon:
…..
Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së Llogarisë 4864 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura" në debi të Llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto llogari në datën 31 Dhjetor 2021.
Të gjitha detyrimet e prapambetura të regjistruara në Llogarinë 4864 deri në fund të periudhës ushtrimore 2021 konsiderohen detyrime të prapambetura të trashëguara nga vitet e kaluara. *-Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" për vitin 2020* paraqitet në vlerën kontabël 0 lekë. pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar pasi llog.486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme*" përfaqëson vlerën kundër parti të disa llogarive të detyrimeve kreditore të pasivit të bilancit.*

Mbi rakordimin e PFV të Bashkisë me Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë SIFQ;

I. U auditua përputhja e të dhënave mbi totalin e aktiveve, pasiveve dhe aktiveve neto sipas **PFV** të hartuara nga ana e njësisë raportuese Bashkia Dropull dhe të dorëzuara zyrtarisht në DTH dhe PF të gjeneruara nga Ministria e Financave në **SIFQ**.

Tabela nr.25 Të dhënat në lekë

Viti 2024

Grupi	Emërtimi	Pasqyrat Financiare 2024	SIFQ 2024
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,809,695,277	1,733,257,367
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,809,695,277	1,733,257,367

Viti 2025

Grupi	Emërtimi	Pasqyrat Financiare 2025	SIFQ 2025
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,983,732,908	1,843,225,491
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,983,732,908	1,843,225,491

-Shuma e aktiveve neto sipas PFV për vitin 2024 nga Bashkia Dropull është 1,809,695,277 lekë, kurse sipas SIFQ vlera e aktiveve neto/fondeve neto rezulton 1,733,257,367 lekë. Diferenca prej -76,437,910 lekë nuk është e barabartë me tepricën debitore te llog.520 "Disponibilitete në thesar" për v.2024, që në PF është 86,489,828 lekë.
Diferenca e pa kuadruar, pasi hiqet vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" është 10,051,918 lekë *(*86,489,828 - 76,437,910).
-Shuma e aktiveve neto sipas PFV për vitin 2025 nga Bashkia Dropull është 1,983,732,908 lekë, kurse sipas SIFQ vlera e aktiveve neto/fondeve neto rezulton 1,843,225,491 lekë. Diferenca prej

-140,507,417 lekë nuk është e barabartë me tepricën debitore te llog.520 "Disponibilitete në thesar" për v.2025 që në PF të dorëzuara nga Bashkia është 117,497,488 lekë.
Diferenca e pa kuadruar, pasi hiqet vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" është 23,009,929 lekë (140,507,417 - 117,497,488).

II. Nga krahasimi i të dhënave të pasqyrave financiare të ngarkuara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) rezultoi se, të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara me nr. 744 prot, datë 22.04.2026 në një numër të këtyre llogarive të dhënat **rakordojnë**, sa rezultuar nga testimet e kryera për: Tepricën e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" për 12,469,452 lekë; llog. 231 "Investime në AAGJM" për 56,825,312 lekë; llog. 24 "AAGJ të dëmtuara" është 0 lekë; llog .32 "Inventar i imët", me vlerë 22,238,194 lekë; llog.210 "Toka, troje e terrene", për shumën 198,582 lekë etj.
-*Nga ana tjetër,* nga auditimi rezultoi se 7 (shtatë) *zëra ose llogari kontabile, ka mospërputhje të tepricës së llogarive pjesë e PFV të dorëzuara zyrtarisht nga ana e Bashkisë Dropull në Degën e Thesarit Gjirokastër* sipas shkresës nr. 744, datë 22.04.2026, krahasuar me të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), *(në këto të fundit nuk përfshihet TD e llog. 520 "Disponibilitete në Thesar"),* për një diferencë prej **43,081,918 lekë** *në* sa vijon:

Tabela nr 26, *Analiza krahasuese e të dhënave të PF me SIFQ 2025 Bashkia Dropull*

Nr.	Llogaria	Emërtimi i llogarisë	PFV sipas shkresës nr. 744, datë 22.04.2026	PFV sipas SIFQ	Diferenca
1.	**26**	Aktive financiare	1,776,500	0	1,776,500
2.	**401-408**	Furnitorë dhe llogari të lidhura	2,037,703	21,712,866	- 19,675,163
3.	**42**	Personeli	11,714,390	11,990,014	-275,624
4.	**431**	Shteti tatime taksa	830,404	0	830,404
5.	**435**	Sigurime shoqërore	2,082,688	0	2,082,688
6.	**4342**	Të tjera operacione me shtetin (debitor)	16,665,039	0	16,665,039
7.	**26**	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet	1,776,500	0	1,776,500
		Shuma			**43,081,918**

Burimi: Bashkia Dropull (PFV 2025), Dega e Thesarit Gjirokastër (PFV Bashkia Dropull nga SIFQ), përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Pasqyrat Financiare të llogaridhënies Vjetore për vitin 2025 të gjeneruara nga Dega e Thesarit Gjirokastër me datën 24 prill 2026 janë nënshkruar nga Nënkryetari i Bashkisë Dropull z.P.Dh, nga Drejtori i Buxhetit dhe Financës znj.S.R dhe përfaqësuesi i Degës së Thesarit Gjirokastër.
Sa më sipër, në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V "Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera vjetore të qeverisjes së përgjithshme", pika 10 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.127, datë 19.12.2025 "Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025":

*Të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara të jenë **të njëjta** me të dhënat e gjeneruara nga SIFQ.*

III. Nga auditimi mbi informacionin shpjegues pasqyruar ë Formatin nr. 5 të PF, "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, viti 2025", në rubrikën "*Diferenca midis pasqyrave financiare të njësisë raportuese dhe PF të gjeneruara nga Ministria e Financave në SIFQ",* nuk ka asnjë shënim mbi këto diferenca. Sa më sipër, nuk ka

gjetur zbatim Pika 14, Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 39 ndryshon përmbajtjen, si më poshtë:

Këto pasqyra iu dërgohen njësive të qeverisjes së përgjithshme të juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e bilancit vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qëllimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, *ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njësive dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme.*

Konstatim**:** Nga auditimi i mbajtjes së kontabilitetit dhe funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, nga shqyrtimi i ditarëve të bankës/thesarit për ana e Bashkisë ***Dropull, bazuar në vlerësimin e indikatorëve të aplikuar nga ana e MF,*** konstatohet se performanca vjetore e këtij institucioni në raportin e fundit të publikuar, ka rënë me (- 3) pikë, ndryshimi në rankim krahasuar me vitin e mëparshëm, si në tabelë;

Rankimi për vitin 2024	*Ndryshimi në rankim krahasuar me vitin 2023 (+/-)*	*Institucioni*	*Vlerësimi në pikë për vitin 2024 (68 nga 72 pikë gjithsej)*
1	(+2)	Bashkia Devoll	51
2	(+3)	Bashkia Mirditë	50
3	(-2)	Bashkia Kamëz	48,5
Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
B	SHPENZIMET	277,319,368	225,000,499
600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	151,407,586	115,717,215
6001	Paga, personel I përhershëm	151,407,586	115,717,215
6002	Paga personel I Përkohshëm	0	
6003	Shpërblime	0	
6009	Shpenzime te tjera per personelin	0	
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	25,165,539	19,585,066
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	25,165,539	17,591,377
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore		1,993,689

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

- *Llogaria 602 "Blerje mallra dhe shërbime",* në vitin ushtrimor 2025 është realizuar në vlerën 50,146,299 lekë, kundrejt vlerës 48,436,697 lekë në vitin 2024, me një rritje prej 1,709,602 lekë ose 3.5%. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Gjirokastër me të njëjtën vlerë.

Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	50,146,299	48,436,697
602	Mallra dhe shërbime te tjera		
6020	Materiale zyre e te përgjithshme	5,178,783	4,068,937
6021	Materiale dhe shërbime speciale	249,114	1,794,228
6022	Shërbime nga te trete	13,566,183	14,792,114
6023	Shpenzime transporti	8,899,387	9,613,080
6024	Shpenzime udhëtimi	433,030	731,670
6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	4,268,096	3,689,506
6026	Shpenzime për qiramarrje	720,000	720,000
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	0	
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen për hua		
6029	Shpenzime te tjera operative	16,831,706	13,027,162

*3. Subvencionet:*Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Dropull nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025.

4. Transferime korente: Gjendja e llogarisë së fondeve 604 "Transferime korente të brendshme" në vitin ushtrimor 2025 është realizuar në vlerën 2,250,000 lekë, kundrejt vlerës 4,075,151 lekë në vitin 2024, me një pakësim prej 1,825,151 lekë ose 44.8%.

-*Artikulli 605 "Transferime korente me jashtë*" nuk paraqet realizim për të dy vitet ushtrimore.

-Gjendja e llogarisë së fondeve *606 "Transferime për buxhetet familjare dhe individë"* në vitin ushtrimor 2025 është realizuar në vlerën 52,193,246 lekë, kundrejt vlerës 43,004,539 lekë në vitin 2024, me një rritje prej 9,188,707 lekë ose 21.4%.

Lekë

	V.TRANSFERIME KORENTE	**54,443,246**	**47,079,690**
604	**1.Transferime korente te brendshme**	**2,250,000**	**4,075,151**
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise		

6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore		
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurëse	2,250,000	4,075,151
605	**2.Transferime korente me jashtë**	**0**	**0**
6051	Transferime Per Organizatat Ndërkombëtare		
6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurese te huaja		
6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
606	**3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe**	**52,193,246**	**43,004,539**
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	52,193,246	43,004,539

Totali i shpenzimeve në vitin ushtrimor 2025 është realizuar në vlerën 277,319,368 lekë, kundrejt vlerës 225,000,499 lekë në vitin 2024, me një rritje prej 52,318,869 lekë ose 23.3% krahasuar me vitin e mëparshëm.

- **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.
Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listëpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- **Veprimet nëpërmjet magazinës:**

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje konstatohet se veprimet ishin kontabilizuar saktë.
- *Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër si pjesë e dokumentacionit kontabël të mirëfilltë me të gjitha të dhënat historike të aktiveve afatgjata materiale, sipas modelit klasik të trajtuar më lart,* domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 30.- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik/ DBF të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

<u>Mbajtja e regjistrit të aktiveve.</u>

U auditua evidenca kontabël dhe mbajtja e të dhënave lidhur me aktivet afatgjata materiale e jomateriale, si dhe ato afatshkurtra rezultoi se, nga ana e Drejtoria e Buxhetit dhe Financës ishte hartuar dhe depozituar në dosjen e PFV të v.2025. Në këtë dokument janë regjistruar të dhënat mbi emërtimin e aktivit, vitin e hyrjes së aktivit (në shumicën e rasteve është vendosur shënimi para vitit 2015, pa saktësuar vitin e hyrjes së aktivit) , koston fillestare dhe amortizimin vjetor e progresiv, vlerën e mbetur të aktivit me dt. 31.12.2025, normën dhe masën e amortizimit vjetor si dhe vlerën e mbetur të aktivit.

*Konstatim***:** Regjistri i aktiveve nuk ka përfshirë të gjithë zërat e aktiveve afatgjata materiale e jomateriale dhe afatshkurtra (vlerën e plotë të tokës, mungon inventari i llogarisë 211 "Pyje, kullota dhe plantacione", apo llogaritë e pjesëmarrjes në kapital) dhe nuk është i plotësuar me sipas kërkesave të Paragrafit nr.30, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Paragrafi 30

"Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Paragrafi 109

Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/ mbeturina/ materiale të ricikluesshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur.

Në regjistrin e aktiveve mungojnë të dhënat mbi vlerën e aktivit dhe data e hyrjes në përdorim,(në shumë raste mungojnë të dhënat për datën e hyrjes së aktivit vendor), vlera e shpenzimeve kapitale që i shtojnë vlerën aktivit dhe koha e kryerjes së këtij shpenzimi, datën e skadencës, vendndodhjen, personin përgjegjës etj.

Inventarizimi i pronës shtetërore

Procesi i inventarizimit:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, neni 74, parashikojnë se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)", Pasqyrën nr. 7/b, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)", kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjesimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj.,

Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë z. Dropull me nr. 266, datë 29.12.2025, të është ngritur komisioni i inventarizimit të aktiveve materiale për vitin 2025, me këtë përbërje: znj.K.B kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. J.Ndhe z. P.F.

Konstatim:

1.Nuk është kryer vlerësimi i aktiveve dhe nxjerrja nga përdorimi i aktiveve të dëmtuara.

2.Procesi inventarizimit fizik të aktiveve, ka evidentuar disa mangësi të evidentuara në zbatimin e proceseve dhe procedurave të inventarizimit të pasurisë, lidhur me saktësinë dhe rregullshmërinë e dokumentacionit dhe rakordimin e brendshëm.

- Si reference ligjore në urdhër është vendosur ligji për administrimin dhe qarkullimin e vlerave monetare e materiale, dispiziite e shfuqizuar nga ligji 10296/1010 i ndryshar dhe aktet e dala në zbatim të tij
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk disponon të dhëna mbi kryerjen e inventarizimit fizik për Aktivet Afatgjata Materiale të llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214 përkatësisht për: Toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ndërtesa e konstruksione, rrugë, rrjete e vepra ujore, në kundërshtim me kërkesat e pikave 74 e 96 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar. Nuk i janë nënshtruar inventarizimit zërat *Ndërtesa dhe Rrugë, rrjete e ujësjellësa*, por vetëm janë përfshirë si një zë i vetëm në përmbledhësen e inventarëve të vitit 2025, pa u zbërthyer analitikisht në zëra të veçantë.
- Nuk është kryer inventarizimi i Aktiveve Afatgjata Jomateriale, *(llogaria 202 "studime e projektime")*, që paraqitet në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare me vlerën 14,220,605 lekë në fillim të vitit 2025 dhe vlere neto 11,113,821 në fund të kësaj periudhe. Nuk është hartuar dhe miratuar urdhri i titullarit të Bashkisë për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Jomateriale.

Nga DFB, është hartuar vetëm regjistri elektronik i cili nuk përfshin informacionin e plotë sipas kërkesave ligjore, mosveprime këto në kundërshtim me kreun II, Paragrafi III, pika 26, 27, 28 dhe Paragrafi IV pika 81, të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*" i ndryshuar;

*Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël t**ë të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim,** përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. **Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.***

-Është hartuar relacioni mbi kryerjen e inventarizimit, por nuk ka miratim nga titullari i bashkisë (dt 27.2.2026). Për llog. 215 nga 23 mjete ne pronësi, janë marre nënshkrimet vetëm per 19 prej tyre

-Nuk janë përfshirë në regjistrin e aktiveve, aktivet të cilat gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "Për *menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar dhe Manualit MFK*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6 *"Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike",* Kreu III, paragrafi 28;

28. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital.

dhe Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, paragrafi 4/c:

. Të gjitha aktivet e dhëna me qera, enfiteozë, koncesion, nga pjesëmarrja në kapitalin e shoqërive tregetare, apo forma të tjera të përcaktuara me ligj të përdorimit të pronës publike e të cilat krijojnë të ardhura.

b.- Nuk është miratuar "Rregullore për menaxhimin e aktiveve" dhe Strategjia për mbrojtjen dhe menaxhimin e aktiveve, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar

c) miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit; ç) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave neni 8, "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", pika 8/ç:

ç*) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave;*

Manualit të MFK-së*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6 *"Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike",* Kreu II, pika 17-25;

5.Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

6.Mbi bazën e rregullave dhe procedurave të miratuara nga Titullari i njësisë publike, përgjegjësitë për menaxhimin e aktiveve duhet të shpërndahen nga Nëpunësi Autorizues në njësinë publike nëpërmjet një sistemi delegimesh dhe ndarje funksionesh *me rregulla të qarta dhe të dokumentuara.* Çdo individ duhet të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij mbi aktivet e njësisë.

dhe pika 119:

119. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në bazë të kritereve të mësipërme, caktojnë rregulla të hollësishme për nxjerrjen nga përdorimi të llojeve të ndryshme të aktiveve...

Kreu I, Pika 16 "Përgjegjësite e Grupit të Menaxhimit Strategjik":

16. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në lidhje me menaxhimin e aktiveve të njësisë dhe riskut të lidhur me to, të evidentuara gjatë takimeve periodike midis manaxherëve, i parashtrohen Grupit për Menaxhimin Strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe *miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre*.

c. Komisioni i inventarizimit fizik dhe i vlerësimit paraprak të aktiveve *nuk ka përpiluar proces verbalet për çdo njësi të strukturës e përfshirë në procesin e inventarizimit*, në kundërshtim me pikën 85/a të Udhëzimit nr. 30/2011, por ka hartuar vetëm Relacionin përmbledhës mbështetur mbi shënimet tek kartela kontabël e vënë në dispozicion nga zyra e financës.

Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për : a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjëndjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në proçesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit..

D. Nuk janë kërkuar deh administruar të dhënat brenda muajit Qershor të vitit 2025, nga shoqëritë tregtare në të cilat Bashkia zotëron kuota apo të drejta (SHRUK Gjirokastër), si kopje të pasqyrave financiare vjetore të vitit paraardhës si dhe të vendimit të asamblesë se përgjithshme për miratimin e pasqyrave financiare, rezultatit vjetor dhe destinacionin e fitimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar dhe Manualit MFK*;*

Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu III, pika 32 dhe 33:

32. Për nevoja të plotësimit të të dhënave në regjistër, njësia publike, brenda muajit Qershor të çdo viti, i kërkon shoqërive tregtare në të cilat shteti zotëron kuota apo të drejta të tjera e që janë në administrim të njësisë publike, kopje të pasqyrave financiare vjetore të vitit paraardhës si dhe të vendimit të asamblesë se përgjithshme për miratimin e pasqyrave financiare, rezultatit vjetor dhe destinacionin e fitimit.
33. Për nevoja të plotësimit të të dhënave në rregjistër, dhe analizës njesia publike, brenda muajit Qershor të çdo viti, i kerkon shoqërive koncesionare me të cilat ka kontrata koncesioni, të depozitojnë në autoritetin kontraktor një kopje të pasqyrave financiare vjetore, pasqyrën e llogaritjes dhe shlyerjes së detyrimeve ndaj shtetit, të shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pagesën si dhe llogaritjen e parashikimit të detyrimeve për vitin ushtrimor në vazhdim.

Konkluzion:
Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin e përgjithshëm të sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në Bashkinë Dropull sipas kërkesave të legjislacionit mbi menaxhimin e sistemit buxhetor dhe atij financiar e të kontrollit dhe kontabilitetit, etj. ka rezultuar se përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në këtë njësi shpenzuese buxhetore, është realizuar përtej afateve ligjore dhe jo në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara edhe shoqërohen me relacion shpjegues. (*pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare*).
Nga ana tjetër, krahas punës së bërë kanë rezultuar disa devijime, mangësi dhe parregullsi, të identifikuara në aktin e konstatimit, në lidhje me mos kontabilizimin e vlerës së truallit, risku i parashkrimit të të drejtave për arkëtim nga debitorët; mangësi në hartimin e regjistrit të aktiveve apo procedurave të inventarizimit të pasurisë, etj., që duhet të jenë në vëmendjen e strukturave menaxheriale të institucionit për përmirësimet e nevojshme në të ardhmen.
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Dh.T, Kryetar i Bashkisë Dropull, në cilësinë e Titullarit/ Nëpunësit Autorizues dhe znj.S.R me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare.

4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 320/1 prot., datë 10.03.2025, me objekt *"Auditim financiar dhe përputhshmërie"* është zhvilluar auditimi:

- për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024, deri me datën 31.12.2024 për auditimin financiar dhe
- nga data 01.01.2023, deri me datën 31.12.2024 për auditimin e përputhshmërisë.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij auditimi janë miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Vendim nr. 138, datë 18.09.2025 dhe Raporti Përfundimtar janë dërguar në këtë subjekt me shkresën nr. 320/10, datë 22.09.2025, (protokolluar në këtë institucion me nr. 753/25, datë 25.09.2025).
Nga verifikimi rezultoi si më poshtë:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:
Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Dropull ka kthyer përgjigje mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimit ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse si dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 573/26 prot., datë 07.10.2025, regjistruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr. nr. 320/11 prot., datë 14.10.2025.
II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30 pika 2 e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"
Bashkia Dropull nuk është dërguar informacion në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, referuar pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014.

III. Rekomandimet e KLSH
Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:
Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit janë rekomanduar gjithsej:
a. Janë rekomanduar 15 masa organizative; (6 prej tyre te lidhura me AF)
b. Janë rekomanduar 5 masa shpërblim dëmi (0 prej tyre te lidhura me AF)
c. Janë 2 dy rekomandime per Kryetarin e Bashkisë Dropull që të shqyrtojë raportin përfundimtar të auditimit dhe ti kërkojë komisionit vendosjen e masave disiplinore për pesronat të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar.
IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH është1 100 %. (Tabela nr ...)

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (Bashkia Dropull)	Pa pranuar	A eshte objekt i auditimit financiar?
1	Organizative	15	15	-	
	Nga këto financiare	*7*	*7*		po
	Nga këto perputhshmeri	*8*	*8*	-	jo
2	Shperblim dëmi	5	5	-	
	Nga këto perputhshmeri	*5*	*5*	-	jo
3	Masa Disiplinore (21 persona)	2 rek	2	-	po

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e subjektit
Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara, që i përkasin auditimit financiar paraqitet si më poshtë: nga 7 masa organizative janë zbatuar pjesërisht 6 dhe 1 masë e pa zbatuar; Për masat disiplinore nga 2 masa të rekomanduara rezultojnë masa të pa zbatuara.
Tabela nr...

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	7		6		1
3	Masa Disiplinore	2		-	-	2

B. MASA ORGANIZATIVE
1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të tij, si më poshtë vijon:
Komponentët e MFK nuk kuptohen sa duhet nga njësia dhe sistemet e MFK janë të implementuara në shkallë të pa mjaftueshme.

Në rregulloren e brendshme të Bashkisë Dropull, rregullat dhe proceset kryesore të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësive, por nuk përshkruajnë me detaje proceset, rrjedhën e punës dhe procedurat.
Mjedisi i kontrollit nuk është implementuar i plotë dhe funksionon në një shkallë të pa mjaftueshme.
Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk ka një plan vjetor pune, gjithashtu nuk ka nxjerrë vendime, raporte për rishikimin e procesit të menaxhimit të riskut, për garantimin se drejtuesit dhe punonjësit e njësisë janë të pajisur me aftësitë dhe udhëzimet e nevojshme për të vënë në zbatim kontrolle të brendshme efektive, për shqyrtimin nëse mjedisi i kontrollit dhe procedurat mund t'i përmbushin objektivat e tyre etj.
Risqet e brendshme nuk lidhen shumë me planifikimin, proceset operacionale, burimet njerëzore, anën ligjore të mbikëqyrjes (ndarjen e detyrave, caktimin e përgjegjësive për punën e secilit punonjës etj.
Aktivitetet e kontrollit nuk kuptohen mjaftueshëm dhe për pasojë një pjesë e mirë e tyre mungojnë, si p.sh. mungon një rregullore risku, apo rregullore për aksesin në aplikacione të ndryshme si p.sh. GIS etj.
Mungojnë gjurmët e auditimit për aktivitetet apo operacionet kryesore, të cilat duhet të jenë të protokolluara.
Implementimi jo i plotë i sistemeve të MFK nuk krijojnë mundësitë e funksionimit të sistemeve të MFK, të cilat sjellin për pasojë që këto sisteme të mos kuptohen nga njësia publike, mungesën e funksionimit të sistemeve ku ato krijohen, si dhe mungesën e reagimit ndaj risqeve të mundshme për arritjen e objektivave.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 6, pika 1, gërma a, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar; neni 4, e VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*"; Kreu II, të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*"; Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, aneksi, 6, 8 i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 13-20, të Raport Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dropull, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me qëllim funksionimin e tyre dhe plotësimin me aktet e nevojshme, si dhe të merren masa për:
-Hartimin e planeve operacionale të konsoliduar të punës, me tregues performancë, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
-Përditësimin e regjistrit të konsoliduar të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.
-Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike.
-Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

Në vijimësi

<u>Shpjegimet e subjektit</u>

Menjëherë nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit u caktua një punonjës që do të merret me hartimin e rregullave të shkruara sipas komponentëve të MFK-së për zbatimin efektiv të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, po këtij punonjësi iu ngarkua puna për përditësimin e regjistrit të riskut. Në mbledhjen e fundit të GMS-së iu caktuan detyra të gjithë drejtorëve të drejtorive për hartimin e manualeve të proceseve të punës dhe të gjurmës së auditit në secilin pozicion pune në drejtoritë që mbulojnë.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Në lidhje me zbatimin e këtij rekomandimi, subjekti nuk i ka vendosur në dispozicion grupit të auditimit dokumentacion provues. Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** dhe **i pazbatuar**.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të buxhetit për vitin 2024, rezulton se janë planifikuar gjithsej 301,659 mijë lekë (të ardhurat e veta të vitit në vlerën 80,803 mijë lekë dhe të trashëguara në vlerën 8,038 mijë lekë dhe grand në fillim të vitit në vlerën 181,818 mijë lekë dhe shtesa gjatë vitit në vlerën 31,000 mijë lekë). Në vijim të auditimit, u konstatuan këto problematika:

-Nuk është treguar vëmendje e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh duke mos i kushtuar rëndësi programeve 052 "Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve", 056-"Ndërgjegjësimi mjedisor" 072/2- "Shërbimi shëndetësor", 036-"Marrëdhëniet në komunitet", 041- "Mbështetje për zhvillim ekonomik-Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi" etj, të cilat nuk janë vlerësuar si programe prioritare nga bashkia Dropull. Kështu mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim në rënie i fondeve nga ana e bashkisë, tregon për një shërbim ku është cënuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj që i ofron komunitetit, të përcaktuara në nenet 23-30, të Ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 20-29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***.**

2.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që me hartimin e PBA-së dhe Planit vjetor të buxhetit, të sigurojë planifikimin dhe ndarjen e fondeve në përputhje me funksionet e vetëqeverisjes vendore.

- Në ketë kuadër, të sigurohet vlerësimi dhe financimi i programeve që aktualisht janë neglizhuar ose me planifikim të ulet, si: menaxhimi i ujerave të zeza dhe kanalizimeve, ndërgjegjësimi mjedisor, shërbimi mjedisor, marrëdhëniet në komunitet dhe mbështetja për zhvillimin ekonomik dhe inspektimi i tregjeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Në kuadër të hartimit të PBA 2026–2028 dhe buxhetit të vitit 2026 si viti i parë i tij, GMS në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit i ka kushtuar vëmendjen e duhur planifikimit të fondeve për ruajtjen e mjedisit, duke e përfshirë këtë në programin 05100 (menaxhimi i mbetjeve urbane), rritjen e sipërfaqeve të pyllëzuara dhe shërbimit urban. Po kështu, për vitin në vazhdim 2025 dhe në PBA-në 2026–2028 kemi hapur programin e kujdesit parësor shëndetësor (07220), për të realizuar funksionin e mbrojtjes së shëndetit të komunitetit.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **pjesërisht i zbatuar**.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave Taksat e Tarifave Vendore, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 9 subjekte në vlerën **879,496** lekë dhe 659 familje për taksë toke, 513 familje taksë ndërtese 476 familje për tarifa vendore pastrimi dhe 490 familje për tarifa vendore ndriçim dhe shërbim varrezash. Ne total rezultojnë **774 familje debitorë**, me një detyrim total në vlerën **6,324,565 lekë.** Kjo situatë reflekton mungesën e një sistemi efektiv për ndjekjen , njoftimin dhe arkëtimin e debitorëve, çka ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave dhe për rrjedhojë ,në ofrimin e shërbimeve publike. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 2, 5 dhe 10 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave Vendore*", i ndryshuar, me nenin 19, pika 2 dhe neni 27, pika 9 të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "*Për Procedurat Tatimore*", i ndryshuar dhe VKB nr. 55 datë 21.11.2023 "*Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Dropull për vitin 2024*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 29-33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Bashkia Dropull dhe Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifave Vendore, të ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e arkëtimit të detyrimeve të prapambetura duke përfshirë hartimin e një plani veprimi për arkëtimin e borxheve, dërgimin e njoftimeve formale për detyrimet e prapambetura si edhe vendosjen e afateve për pagesë vullnetare dhe ndjekjen me masa ligjore në rast mospagimi. Gjithashtu, të merren masa për krijim e një sistemi të përditësuar elektronik për monitorimin e raportimit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Drejtoria e të Ardhurave bëri analizën e taksave dhe tarifave 6-mujore, duke analizuar për çdo lloj takse/tarife më vete, Shkresa nr. 1025 Prot., datë 30.07.2025.
Drejtoria e të Ardhurave ka kërkuar mbështetje nga Policia Bashkiake për subjektet debitore me shkresë nr. 1045 Prot., datë 04.08.2025.
Drejtoria e të Ardhurave përditëson listat e debitorëve çdo muaj dhe u ridërgon njoftime sipas shkresave:
Shkresa nr. 723 Prot., datë 04.06.2025, drejtuar subjekteve fizik/juridik/familjarë debitorë.
Shkresa nr. 948 Prot., datë 16.07.2025, drejtuar Agjentit Tatimor për debitorët familjarë.
Shkresa nr. 990 Prot., datë 24.07.2025, bashkëpunim me kryepleqtë e fshatit për vjeljen e familjarëve debitorë.
Shkresa nr. 1037 Prot., datë 01.08.2025, ridërgim njoftimi familjarëve debitorë sipas listave të dala nga specialisti i borxhit.
Shkresa nr. 1225 Prot., datë 09.09.2025, ridërgim njoftimi familjarëve debitorë sipas listave të dala nga specialisti i borxhit.
Titullari i Bashkisë dhe DA/Bashkia Dropull do programojnë sa më shpejt implementimin e programeve kompjuterike me qëllim krijimin e një regjistri elektronik sa më të saktë dhe dhënie informacioni në kohë shumë të shkurtër në lidhje me taksat dhe tarifat që i takojnë Bashkisë Dropull.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Bashkia Dropull ka ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e arkëtimit të detyrimeve të prapambetura, por nuk ka marr ende masa për krijimin e një sistemi të përditësuar elektronik për monitorimin e raportimit të brendshëm.
Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **pjesërisht i zbatuar**.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nga 198 objekte, inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llog. 210 *"Toka troje terrene",* llog. 211 *"Pyje plantacione",* 212 *"Ndërtesa e konstruksione"* dhe llog. 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*, në vlerën 2,080,745,825 lekë, Bashkia Dropull nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 "*Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme"*, Kreu VI ", pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35, sipas të dhënat në pasqyrën Aneks nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 33-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dropull, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masat e duhura për regjistrimin e **198** objekteve të pasurive të paluajtshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim dokumentimin me akte pronësie të aktiveve kapitale në pasqyrat financiare të Njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Menjëherë Kryetari i Bashkisë nxori urdhër me personat përgjegjës, nën drejtimin e nënkryetarit, për plotësimin e dokumentacionit përkatës dhe aplikimin për regjistrim të objekteve pranë ASHK, urdhër nr. 215, datë 07.10.2025, nr. 1422 prot.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi**.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik me objekt: "*Rikonstruksioni i rrjetit* rrugor Poliçan, Drimadhes, Pogon", "Rikonstruksion i rrugës Terihat Sofratikë","Mbrojtje nga përroi i Selosë Dropull, Faza I", "Rikonstruksioni i rrugës "Thoma Jovani", fshati Terihat, njësia administrative Dropull i poshtëm, Bashkia Dropull", "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara", "Blerje makinë teknologjike dhe kontejner për mbledhjen e mbetjeve urbane në Bashkinë Dropull" të zhvilluara gjatë vitit 2023 - 2024, u konstatua se janë vendosur kritere që nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Konkretisht:

- Në **tre raste**, NJP ka kërkuar një numër të lartë punonjësish, të pa-argumentuar teknikisht, duke mos u bazuar në asnjë analizë konkrete, në raport me punimet që do të kryhen, volumet e tyre apo grafikun e punimeve.
- Në **tre raste**, NJP ka kërkuar një numër të lartë **punonjësish mesatar**, të përfshirë në stafin e kompanisë, numër i pa-argumentuar teknikisht duke mos u bazuar në asnjë analizë konkrete, në raport me punimet konkrete që do të kryhen, volumet e tyre apo grafikun e punimeve.
- Në **dy raste**, NJP nuk ka kërkuar kriterin e certifikatës për cilësinë e punimeve që OE duhet të paraqesin, konkretisht **certifikata ISO**, për të garantuar cilësinë e produkteve dhe punimeve, objekt prokurimi.
- Në **një rast**, NJP ka kërkuar kriterin e certifikatës për cilësinë e punimeve që OE duhet të paraqesin, konkretisht **certifikata ISO**, kërkesë e cila nuk është e argumentuar teknikisht dhe ligjërisht pasi, objekt prokurimi është "Blerje malli" dhe jo "Punë publike".
- Në **një rast**, NJP ka kërkuar dëshmi për mjetet, numër i pa-argumentuar teknikisht duke mos u bazuar në asnjë analizë konkrete, në raport me punimet që do të kryhen.

- Në **një rast**, NJP nuk ka argumentuar specifikimet teknike të vendosura për "Kamionçina dopio kabin me karroceri" dhe "Automjet SUV 4x4".
Këto veprime dhe mosveprime nuk janë në përputhje me pikat 1 dhe 4, të nenit 77 dhe 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", i ndryshuar. Gjithashtu, konstatohet mospërputhje me kërkesat e nenit 77, 78 dhe 79 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.4, faqe 44-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Dropull, nëpërmjet Njësisë së Prokurimit, në procedurat e prokurimit publik në vijim, duhet të ketë në konsideratë që kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit të jenë të qarta, të argumentuara dhe në përputhje të plotë me objektin e prokurimit, vlerën dhe natyrën e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, u konstatua se në 2 procedura, nga 9 procedura të audituara, janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, konkretisht si vijon:
- Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i rrugës në lagjen e sipërme Llongo dhe Hllomo-Çatistë" me vlerë të fondit limit 5,724,167 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2024.
- Në procedurën e prokurimit me objekt "Mbrojtje nga përroi i Selosë Dropull, Faza I" me vlerë të fondit limit 31,971,107 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2023. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 92, pika 3, nenit 99 pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" si dhe nenin 5, gërma a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.4, faqe 44-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandim: Titullari i AK Bashkia Dropull, të analizojë arsyet e parregullsive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë dhe do jetë objekt i një auditimi të veçantë.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik dhe zbatimit të kontratave për punë publike, u konstatua se në 1 (një) rast, nga 9 raste të audituara, nga AK Bashkia Dropull, nuk është kryer oponenca teknike, respektivisht për objektin:
-"Rikonstruksioni i rrugës në lagjen e sipërme Llongo dhe Hllomo-Çatistë";
Moskryerja e oponencës teknike nga AK Bashkia Dropull, bie në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit nr. 3/2020 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.4, faqe 84-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandim: Bashkia Dropull të marrë masa të menjëhershme për të pajisur çdo projekt zbatimi me Oponencë Teknike të rregullt dhe të dokumentuar, me qëllim garantimin e cilësisë së

hartimit të projekteve në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, si dhe me funksionin dhe destinacionin përkatës të investimit. Kjo masë synon të parandalojë mangësitë teknike, të rrisë transparencën dhe të sigurojë që projektet të jenë të zbatueshme, të qëndrueshme dhe në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në vijimësi

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë dhe do jetë objekt i një auditimi të veçantë.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i prokurimeve me vlerë të vogël u konstatuan:

- Në 3 raste, nga komisioni i marrjes së mallrave/shërbimeve në dorëzim, nuk janë verifikuar specifikimet teknike të kërkuara në Ftesën për Ofertë apo mallrat/shërbimet nuk janë shoqëruar me dokumentacion justifikues për të argumentuar plotësimin e punimeve/dorëzimin e mallrave apo shërbimeve sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë.
- Nga verifikimi në sistemin elektronik APP rezulton se në Bashkinë Dropull në 18 raste nuk janë respektuar afatet nga shpallja e operatorit ekonomik fitues deri në konfirmimin e operatori ekonomik fitues pas ankimimit.
- Nga verifikimi në sistemin elektronik APP rezulton se në Bashkinë Dropull në 3 rast nuk janë respektuar afatet kohore në kalimin e operatorit ekonomik të radhës pas tërheqjes së operatorit ekonomik të klasifikuar më lartë".
- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua, se në dy rast, marrja në dorëzim e mallrave të prokuruar nuk është shoqëruar me një procesverbal mbi plotësimin e specifikimeve.
- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në dy raste, dorëzimi i mallrave/shërbimeve nga operatori fitues është bërë jashtë afateve të përcaktuara në kontratat e lidhura mes palëve.
- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në katër raste levrimi mallit/Shërbimit është kryer përpara konfirmimit të operatorit ekonomik fitues pas ankimimit, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet në Ftesën për ofertë. Sa më sipër, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për rregullat e Prokurimit Publik*" i ndryshuar, neni 107, Udhëzimin nr. 5, datë 26.06.2021, "*Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël*" pika 16, 19 dhe udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 2.4, faqe 66-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandim: Bashkia Dropull, nëpërmjet **komisionit të marrjes në dorëzim**, të marrë masat që për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël që zhvillon, të argumentojë dhe të administrojë procesverbalin për marrjen në dorëzim të mallit, të punëve apo shërbimeve, procesverbali konstatues paraprak për ato rastet kur nevojitet, ngritja e grupeve për marrjen në dorëzim të punëve, mallrave apo shërbimeve.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë dhe do jetë objekt i një auditimi të veçantë.

8.2 Rekomandim: Bashkia Dropull, nëpërmjet komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave, të marrë masa të qarta për sigurimin e lëvrimit të mallrave, punimeve apo shërbimeve brenda afateve të përcaktuara në kontratë dhe/ose në ftesën për ofertë, zbatimin e penaliteteve të parashikuara në kuadrin kontraktual dhe ligjor, në çdo rast kur operatorët ekonomikë nuk respektojnë afatet e dorëzimit.

<u>Qëndrimi i audituesve të KLSH-së</u>

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë dhe do jetë objekt i një auditimi të veçantë.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të lidhura për periudhat verore dhe dimërore, u konstatua se procedurat e ndjekura kanë qenë në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 4, datë 10.04.2008, "Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqitet për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

Megjithëse procedurat e lidhjes së kontratave janë respektuar, auditimi i kontratave për dhënien me qira të kullotave pranverore dhe verore ka nxjerrë në pah disa mangësi të rëndësishme në zbatimin dhe administrimin e tyre:

-Mungesë verifikimi në terren: Drejtoria përgjegjëse për administrimin e ujërave, pyjeve, livadheve dhe kullotave nuk ka kryer kontrolle për të verifikuar zbatimin e kontratave dhe numrin real të krerëve të futur në parcelë.

-Mungesë bashkëpunimi institucional: Nuk është realizuar koordinim me AZHBR Qarku Gjirokastër për verifikimin e bagëtive të regjistruara për Bashkinë Dropull.

-Mospërcaktim i aktit referues në kontrata: Në asnjë rast kontratat nuk specifikojnë se mbi cilin akt është bazuar ndarja e kullotave — qoftë vendimi i Komisionit të Ndarjes së Kullotave apo ai i këshillit të komunës.

-Mosreflektim në kontabilitet i pronës publike. Me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, janë transferuar në pronësi të Bashkisë Dropull sipërfaqe pyjore dhe kullosore me një total prej 25,611.13 ha, sipas listës së inventarit bashkëlidhur (shtojca nr. 32).

Këto sipërfaqe nuk janë pasqyruar në llogarinë kontabël nr. 211 "Pyjet, kullotat dhe plantacione", duke bërë që aktivi i bilancit të mos reflektojë gjendjen reale të pronës publike.

Gjithashtu, nuk është vijuar me regjistrimin e pronave të paregjistruara, çka ka sjellë kufizime në të drejtat pronësore të NJQV.

-Mungesë planifikimi dhe dokumentimi teknik:

-Nuk janë hartuar plane mbarështimi për secilën ngastër.

-Nuk janë parashikuar shërbime mbarështuese apo vjelja e produkteve dytësore.

-Nuk janë mbajtur akte kontrolli për përdorimin e sipërfaqeve.

-Nuk janë hartuar planet e mbarështimit të kullotave. Mangësitë e mësipërme vijnë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore, sipas Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, "*Për Fondin Kullosor*", i ndryshuar me Ligjin nr. 49/2016, neni 26, Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në NJQV*"; Udhëzimi nr. 4, datë 10.04.2008, *"Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave, të livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari";* VKM nr. 632, datë 11.6.2009 *"Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje";* neni 26, pika 1, të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005*"Për pyjet dhe shërbimin pyjor"* dhe VKM nr.22, datë 09.01.2008 *"Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të administrimit të pyllit komunal"*, pika 3 e vijim; pika 3/3, 5/e, dhe 6 e VKM nr. 396, datë 21.06.2006; me nenet 11 dhe 11/1 të Ligjit nr. 8752, datë 28.3.2001 *"Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës"*, ndryshuar me Ligjin nr. 10210, datë 25.3.2010. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.5.1, faqe 99-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dropull të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës, si dhe të marrin të gjitha masa për inventarizimin kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore,

fuqisë kullosore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (*për pyjet mbrojtës*); mbajtjen e bilancit të fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall; mbajtjen, evidentimin, administrimin e balancimit të fondit kullosor; pasqyrimin në kontabilitet, në llogaria nr. 211 "*pyjet, kullotat dhe plantacione*", aplikimit për hartimin e plan mbarështimit për secilën ekonomi kullosorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë dhe do jetë objekt i një auditimi të veçantë.

10. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se Bashkia Dropull nuk disponon një regjistër të konsoliduar të aseteve për pronat publike, përfshirë kullotat, pyjet dhe sipërfaqet e tjera, si dhe nuk ka kryer vlerësimin dhe inventarizimin e tyre. Mungesa e certifikatave të pronësisë ka penguar pasqyrimin kontabël të aktiveve, duke ndikuar në saktësinë e bilancit dhe në aftësinë e njësisë për të menaxhuar pasurinë publike në mënyrë të plotë. Pavarësisht aplikimeve të kryera nga ish-komunat dhe njësitë administrative për pajisjen me certifikatë pronësie, përfshirë 46 prona me vlerë 332,000 lekë dhe 91 prona me vlerë 502,600 lekë, procesi nuk është finalizuar. Kërkesat zyrtare janë dokumentuar me shkresën nr. 180 prot., datë 25.05.2015 dhe nr. 1815 prot., datë 16.10.2019, por nuk rezulton të jetë marrë përgjigje nga ASHK. Si pasojë, nga 193 prona të pasqyruara në inventar me kosto historike, Bashkia Dropull nuk posedon tituj pronësie.

Këto veprime bien në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, me pikën 1 dhe 2, kreu VI të VKM nr. 510, datë 14.08.2001, *"Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme"* dhe Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, *"Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore"*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. nr.5.1, faqe 99-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dropull nëpërmjet Sektorit të Buxhetit dhe Menaxhimit të Asteve të ndërmarrë veprime për pajisjen me certifikata pronësie për asetet publike në përdorim dhe pronësi, duke ndjekur procedurat dhe duke koordinuar punën në mënyrë të vazhdueshme me DVASHK Gjirokastër për sigurimin e dokumentacionit vërtetues me titull pronësie për pronat; *"toka, troje, terrene, pyje, plantacione, ndërtesa dhe konstruksione"*, për garantimin e sigurisë juridike mbi pronat, pasqyrimin e saktë kontabël dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore për menaxhimin e pasurisë publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Ky rekomandim do kohë për të gjetur zbatim të menjëhershëm, se është një procedurë e gjatë e cila do shpenzime të mëdha hipotekore, me qëllim që të fillojë më vonë vlerësimi, me qëllim që të paraqitet vlera e tyre në aktivet e pasqyrave financiare të njësisë publike vendore.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i** vijon të jetë në **proces zbatimi**

11. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se në strukturën organizative të Bashkisë Dropull mungon një sektor i dedikuar për administrimin e aseteve në pronësi apo përdorim të njësisë. Kjo mungesë ka ndikuar në

mosrealizimin e veprimeve të nevojshme për përditësimin, regjistrimin, vlerësimin dhe pasqyrimin financiar të pronave publike, si dhe në mungesën e koordinimit me DVASHK për pajisjen me tituj pronësie. Si rezultat, pasqyrat financiare nuk reflektojnë vlerat reale të aseteve, duke cenuar transparencën dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore për menaxhimin e pasurisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 10, pika 1, gërma ç) të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". (Më hollësisht trajtuar në pikën nr. nr.5.1, faqe 99-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dropull në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të kryejë ristrukturimin e strukturës organizative me qëllim krijimin e një sektori të posaçëm për administrimin e aseteve publike. Ky sektor duhet të ngarkohet me përditësimin e regjistrit të aseteve, ndjekjen e procedurave për regjistrim dhe pajisje me tituj pronësie, vlerësimin financiar të pronave dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Kryetari i Bashkisë Dropull, me organikën e re të vitit 2026, do synojë në krijimin e një strukture ose një personi që t'i ngarkohet kjo detyrë.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, është ngritur grupi i punës për administrimin e aseteve publike me Urdhrin nr. 37, datë 11.02.2026. Megjithatë, Bashkia Dropull nuk ka kryer ristrukturimin e strukturës organizative me qëllim krijimin e një sektori të posaçëm për administrimin e aseteve publike.

Sa më sipër, duke marrë parasysh dhe afatin "në vijimësi" për zbatimin e rekomandimit, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatuar.**

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, u konstatua se në të gjitha rastet e audituara, pra në 4 (katër) raste, dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Gjithashtu, janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për objektin "Shtesë objekti, fabrikë përpunimi kartoni me adresë në Dropull me zhvillues X-P, miratuar me Vendim nr. 1464, datë 13/10/2023 të Kryetarit të Bashkisë Dropull, u konstatua se: Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tej zgjatura prej 153 ditësh pune; DSHU nuk ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit; Kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të azhurnuara gjatë 3 muajve të fundit; Mungon certifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (këtu e në vazhdim QKB) për hartuesin e projektit arkitektonik, konstruktiv, elektrik, hidraulik, ngrohje-ftohje dhe mbrojtje ndaj zjarrit; Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungon relacioni, plani i piketimit të strukturës, plani i mbulimit me kuotat përkatëse në plan, kuotat në parapete, mbi elementet teknike, si dhe kullime; Mungon licenca individuale e hartuesit të projektit mbrojtje ndaj zjarrit; Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale e arkitektit që ka hartuar projektin arkitektotnik dhe e hartusit të Vlersimit të Ndikimit në Mjedis.

2. Leje ndërtimi për objekt 2 kate me 1 kat nëntoke me funksion Agroturizëm", me zhvillues znj. M.N, miratuar me Vendim nr. 575, datë 31/03/2023 të Kryetarit të Bashkisë Dropull, u konstatua se: Kjo leje ndërtimi është miratuar në mungesë të dokumenteve që vërtetojnë të drejtat pasurore

mbi pronën / at në zhvillim, saktësisht mungojnë certifikatat Nr.1/463; 1/464; 2/468; 2/469; ZK1476; Policat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesit e projektit elektrik është jashtë afatit të mbulimit; Mungon certifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (këtu e në vazhdim QKB) për hartuesin e projektit e eficencës energjetike; Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale e hartuesit të projektit mbrojtje ndaj zjarrit; Mungon projekti arkitektonik në formatin DËG; DSHU nuk ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

3. Certifikate përdorimi për "Shtesë objekti frigorifer, fabrikë përpunimi brumërash", me zhvillues "DH.'' Shpk, miratuar me Vendim Nr. 121, datë 22.01.2025, u konstatua se: Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tej zgjatura prej 83 ditësh pune; Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht; Mungojnë fotot ne 4 drejtime të objektit; Mungojnë kontratat me OSHEE, PMNSHZ dhe UK; Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane; Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit; Mungon deklarata e përputhshmërisë nga subjekti zhvillues.

4. Certifikate përdorimi për "Fabrikë prodhimi brumi, magazinë", me zhvillues "E." Sh.a, miratuar me Vendim Nr. 1340, datë 09.10.2024, u konstatua se: Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht; Mungojnë fotot ne 4 drejtime të objektit; Mungojnë kontratat me OSHEE, PMNSHZ dhe UK; Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane; Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit; Mungon deklarata e përputhshmërisë nga subjekti zhvillues.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika b), ë), g); pika 1/1, nënpika i), iii); neni 27/2, pika 1, nënpika g), gj); Ligjin nr. 111/2018 "*Për kadastrën*", i ndryshuar, neni 19, pika 2; Ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 "*Për noterinë*", i ndryshuar, neni 54. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 104-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Dropull, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe certifikata përdorimi, të kërkojnë plotësimin e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-lejet me: plotësinë dhe saktësinë e projekteve ndërtimore; studimet sizmologo – inxhinierik dhe studimit gjeologo-inxhinierik; vërtetimet e regjistrimit në QKB për hartuesit e projekteve ndërtimore; licencat profesionale dhe certifikatat për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore; ngarkimin e deklaratave të përgjegjësisë profesionale për hartuesit e projekteve ndërtimore, si dhe saktësinë e tyre; policat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesit e projekteve ndërtimore, si dhe të jenë brenda afateve, në raport me datën e aplikimit. Gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me certifikata përdorimi të kërkojnë plotësimin e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-lejet me projektin 'as-built' dhe projektin për mirëmbajtjen e objektit; etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur mbi veprimtarinë e Inspektorati Mbrojtjes së Territorit, rezulton se në bashkinë Dropull kjo strukturë nuk është e plotësuar pasi ka vetëm një person të punësuar në këtë inspektorat. IMT nuk posedon blloqe të procesverbaleve të kundërvajtjes si dhe blloqe për daljen e vendimeve të gjobave apo prishjes së

objekteve të cilat janë në kundërshtim me nenin 45, pika 1, germa "b" të Ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin e territorit*", si dhe Ligjin nr. 9780 "*Për inspektimin e ndërtimit*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën nr. 7, faqe 109-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dropull në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për ngritjen e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, si një strukturë e domosdoshme në funksion të zhvillimit të territorit nga ndërtimet pa leje. Në rast mungesë të specialistit të fushës sipas përcaktimeve të ligjore të bëhet marrëveshje me IKM të Qarkut Gjirokastër për kontrollin e territorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, rezultoi si më poshtë:

KLSH ka dërguar në Bashkinë Dropull rekomandimet e auditimit të fundit me shkresën nr. *431/6 prot., datë 28.06.2024.* Bashkia Dropull për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 455/12 prot., datë 19.07.2024 dhe ka hartuar planin e veprimit duke respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh.

Gjithashtu, nga Bashkia Dropull është raportuar brenda afatit të 6 muajve, me shkresën nr. 76/1 prot., datë 16.01.2025. Me urdhër nr. 124, datë 19.07.2024 të Kryetarit të Bashkisë Dropull është hartuar plani i punës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, duke ngarkuar me përgjegjësi drejtoritë përkatëse. Bashkia Dropull nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak, bazuar në përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", Neni 50-Auditimi i jashtëm.

Nga auditimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve, rezulton si më poshtë*:*

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 12 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 12 masa. Nga masat e pranuara janë zbatuar plotësisht 3 masa, zbatuar pjesërisht 7 masa dhe pa zbatuar 1 masë. Nga 9 masa të zbatuara pjesërisht ose pa zbatuar nuk ri kërkohen 7 masa (1.1, 3.1, 5.1, 5.2, 6.1 dhe 6.2), pasi statusi i tyre është i ndryshueshëm dhe është pjesë e raportit përfundimtar.

c. Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, me efekt mungesë të ardhurash. janë rekomanduar 2 masa në vlerën 7,908,626 lekë nga e cila nuk është në proces arkëtimi vlera 7,908,626 lekë. Nga verifikimi rezulton se statusi i këtij rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

d. Janë rekomanduar 4 masa disiplinore. Nga verifikimi rezulton se statusi i këtij rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Nga auditimi i mëparshëm janë ri kërkuar **2** masa në vlerën totale 499,061 lekë dhe pranuar nga subjekti e cila rezulton e zbatuar pjesërisht. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 8, faqe 110-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit*", për përmirësimin e gjendjes, Ju **ri kërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa organizative.

8.1 Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, të kryhej analizat e situatës së aktiveve të Njësisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masat e duhura për evidencimin e sipërfaqeve të pyjeve e kullotave të kaluara në administrim të Bashkisë Dropull me VKM përkatëse, edhe nëse ato janë të pa vlerësuara, të evidentohen në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

9.1 Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju **ri kërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

B. <u>Masa shpërblim demi.</u>

1.1 Rekomandim: Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **185,561** lekë pa TVSH nga JV "R.T" & "Sh." ShPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 760 prot., datë 06.05.2021, me objekt "*Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të Ujësjellësit të fshatrave Zervat, Vanister, Haskove, Dhuvjan, Gorice, Frashtan, Lugar dhe Grapsh, Bashkia Dropull*".

Menjëherë

2.1 Rekomandim: Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **313,500** lekë pa TVSH nga shoqëria "K.K" ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 793 prot., datë 11.05.2021, me objekt "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat" Bashkia Dropull.

Menjëherë

<u>Shpjegimet e subjektit</u>

A.Masa organizative.

8.1 Rekomandim: Ky rekomandim nuk mund të gjejë zbatim të menjëhershëm se është një procedurë e gjatë e cila do shpenzime të mëdha hipotekore me qëllim që të fillojë më vonë vlerësimi me qëllim që të paraqitet vlera e tyre ne aktivet e pasqyrave financiare të njësisë publike vendore.

B. <u>Masa shpërblim d</u>ëmi.

1.1 Rekomandim. është zbatuar plotësisht me arkëtimin e vlerës prej 185,561 lekë pa TVSH nga JV "R.T", më datë 24.10.2025.

2.1 Rekomandim: është zbatuar plotësisht arkëtimin e vlerës prej 313,500 lekë pa TVSH nga shoqëria "K.K" ShPK, më datë 31.10.2025.

<u>Qëndrimi i audituesve të KLSH-së</u>

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **pjesërisht i zbatuar**.

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15 shkronja "b" dhe "c" -*Të drejtat e KLSH*, dhe mbështetur në nenet 98-102, të

Ligjit nr. 44, datë 30/4/2015, "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*", nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", dhe pikën 93 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Dropull), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **785, 906 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *"Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Bularat+kopshti Bularat, Dropulli i Sipërm", Bashkia Dropull*, me vlerë të kontratës 63,535,747 lekë me TVSH, realizuar nga OE "Gj." ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **245,771 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2072 prot., datë 12.12.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull dhe OE "GJ." ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 84-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Bashkia Dropull të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **245,771 lekë pa TVSH** nga OE "Gj." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2072 prot., datë 12.12.2022, me objekt: "*Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Bularat+kopshti Bularat, Dropulli i Sipërm*", *Bashkia Dropull*.

Brenda datës 30.10.2025

<u>Qëndrimi i audituesve të KLSH-së</u>

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: "*Mbrojtje nga përroi i Selosë Dropull, Faza I***"**, *Bashkia Dropull*, me vlerë të kontratës 28,679,994 lekë me TVSH, realizuar nga OE "E.P.P" ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **104,835 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1514 prot., datë 30.10.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull dhe OE "E.P.P" ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 88-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Bashkia Dropull të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **104,835 lekë pa TVSH** nga OE "E.P.P" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1514 prot., datë 30.10.2023, me objekt: "*Mbrojtje nga përroi i Selosë Dropull, Faza I*", Bashkia Dropull, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.10.2025

<u>Qëndrimi i audituesve të KLSH-së</u>

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *"Rikonstruksion i rrjetit rrugor Poliçan – Dhrimadhes, Pogon", Bashkia Dropull*, me vlerë të kontratës 63,535,747 lekë me TVSH, realizuar nga OE "R.S.M &H.C" ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **210,000 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 652 prot., datë 19.04.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull dhe OE "R.S.M &H.C" ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 91-94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1 Rekomandim: Bashkia Dropull të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **210,000 lekë pa TVSH** nga OE "R.S.M &H.C" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 652 prot., datë 19.04.2023, me objekt: "*Rikonstruksion i rrjetit rrugor Poliçan – Dhrimadhes, Pogon*", Bashkia Dropull, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.10.2025

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së
Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *"Rikonstruksion i rrugës Sofratikë - Terihat dhe rrugëve të fshatit Terihat", Bashkia Dropull*, me vlerë të kontratës 46,127,781 lekë me TVSH, realizuar nga OE "L.T.E.C" ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **152,000 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr 667 prot., datë 20.04.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull dhe OE "L.T.E.C" ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 94-96, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1 Rekomandim: Bashkia Dropull të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **152,000 lekë pa TVSH** nga OE "L.T.E.C" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 667 prot., datë 20.04.2023, me objekt: *"Rikonstruksion i rrugës Sofratikë - Terihat dhe rrugëve të fshatit Terihat*", Bashkia Dropull, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.10.2025

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së
Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: "*Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfër dhe të pa favorizuara", Bashkia Dropull*, me vlerë të kontratës 6,213,480 lekë me TVSH, realizuar nga OE "I" ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **73,300 lekë pa TVSH**. Veprimet e

mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1473 prot., datë 09.10.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull dhe OE "I." ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", Kreu III, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 96-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1 Rekomandim: Bashkia Dropull të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **73,300 lekë pa TVSH** nga OE "I." ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1473 prot., datë 09.10.2023, me objekt: "*Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfera dhe të pa favorizuara", Bashkia Dropull*, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.10.2025

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së
Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

D. MASA DISIPLINORE
Bazuar në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 57, 58 dhe 59, të Ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar me VKM nr. 115, datë 05.03.2014, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisioni disiplinor në shërbimin civil"*, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Dropull** t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore përkatëse në proporcion me shkallën e shkeljes. Bazuar në nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996, *"Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë"* dhe kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Dropull, fillimin e dhënies së masave disiplinore për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkallën e shkeljes.

Shpjegimet e subjektit

Kryetari i Bashkisë, duke shqyrtuar çështjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkallën e shkeljes, nuk e pa të arsyeshme dhënien e masave disiplinore për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi, duke u dhënë mundësinë për përmirësimin e punës në vazhdim.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së
Referuar shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i pazbatuar**.

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL
Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, Agjencia Kombëtare e Mjedisit pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:
a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Shpjegimet e subjektit
Përderisa nuk i kërkoi Komisionit Disiplinor pranë institucionit marrjen e masave për punonjësit, nuk u njoftua as Departamenti i Administratës Publike dhe as Komisioneri.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së
Referuar shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i pazbatuar**.

****

IV. REKOMANDIME
A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programeve buxhetore rezultoi se, nga 20 programe buxhetore të miratuara nga Ministria e Financave për përgatitjen e PBA 2025-2027, ka disa programe buxhetore të lidhura me 6 (gjashtë) funksione/nënfunksione të cilat nga ana e Bashkisë Dropull nuk janë marrë në konsideratë dhe nuk janë parashikuar fonde në buxhet, si p.sh për: funksionin/nënfunksionin nr. 23/1; 23/2; 23/3; 27/3; 27/4 dhe 28/6, të lidhura me funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike si dhe në fushën e zhvillimit ekonomik vendor, etj. Sa më sipër, në moszbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 7, datë 25.05.2022 "*Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018* "*Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*" shtojca 1 dhe Udhëzimit të MF nr.3, datë 28.02.2024 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027"*, (shtojca 4).
(*Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2, faqe 26-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull të marrë masa që, në procesin e përgatitjes së PBA-së, të analizohen dhe planifikohen të gjitha programet buxhetore dhe funksionet/ nënfunksionet që lidhen me kompetencat e Bashkisë, duke siguruar parashikimin e fondeve sipas nevojave dhe prioriteteve vendore dhe në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të regjistrimit/çregjistrimit, planifikimit, njoftimit të detyrimeve dhe arkëtimeve për tatimpaguesit biznese dhe familjarë rezultoi se:
-Regjistrat për Taksat dhe Tarifat për çdo NJA dhe fshat, ku janë përfshirë listat e tatimpaguesve dhe detyrimet sipas kategorive të tatimeve nuk janë protokolluar dhe arkivuar në momentin e mbylljes së vitit ushtrimor dhe para hapjes së regjistrit të vitit pasardhës. Nuk është dokumentuar me procesverbal niveli i detyrimeve të papaguara për taksat dhe tarifat vendore sipas kategorive, në datën 31.12.2025.
-Procesi i popullimit të Regjistrit Elektronik të tatimpaguesve dhe procesi i përpunimit dhe përgatitjes së evidencave kryhet nga të njëjtët përdorues, në mungesë të ndarjes së aktiviteteve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshua**r** dhe Manualit të MFK.
- Rregullorja e brendshme për krijimin, mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit elektronik të tatimpaguesve vendorë të Bashkisë Dropull, është miratuar në fund të vitit 2025, dhe nuk ka

parashikuar kriteret dhe aspektet e gjenerimit/printimit e arkivimit të të dhënave periodike e vjetore; afatet dhe mënyrën e rakordimit të të dhënave të këtij regjistri me strukturat e brendshme e të jashtme dhe mënyrën e dokumentimit të çdo përditësimi të të dhënave, në funksion të saktësisë dhe ruajtjes së gjurmës së auditimit në këtë institucion të vetëqeverisjes vendore.
- Nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e saktësisë së procesit të popullimit të regjistrit elektronik, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga ky regjistër në evidencat format *Microsoft Excel* për njoftim detyrimi drejtuar tatimpaguesve, raportime midis drejtorive apo për titullarin e Bashkisë.
Sa më sipër, në mospërputhje me përcaktimet e nenin 5/iv të Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave të marrë masa për formalizimin e procedurave për mbylljen, dokumentimin dhe arkivimin e regjistrit vjetor të tatimpaguesve; sigurimin e ndarjes së detyrave midis personave që kryejnë popullimin e regjistrit dhe atyre që përgatisin raportet dhe njoftimet e detyrimeve; vendosjen e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të procesit të administrimit të regjistrit elektronik të tatimpaguesve.

Deri me 31.12.2026

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi nivelin e realizimit të shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta, së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike të Bashkisë Dropull për vitin 2025, kanë rezultuar diferenca me vlerën e planifikuar. Për vitin 2025 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken është 300,646 mijë lekë, buxheti i rishikuar në vlerën 372,729 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 259,851 mijë lekë, ose në masën **69,7%.** Ky tregues i mosrealizimit të shpenzimeve vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që tregon se në fillim të vitit buxhetor nga Bashkia Dropull janë planifikuar angazhime buxhetore pa u mbështetur në parashikime reale të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore, ndërkohë që gjatë vitit ky planifikim nuk është korrigjuar, pa reflektuar nivelin real të të ardhurave të realizuara në planifikimin e shpenzimeve buxhetore. Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, kanë sjellë mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve. Sipas realizimit të buxhetit, Bashkia Dropull mbulon me të ardhurat e veta **23.5%** të buxhetit vjetor 2025. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 9, pika 1.3, gërma "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i* ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore",* UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm"* dhe VKB përkatëse.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për financat dhe buxhetin, të marrë masa për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit, duke siguruar që planifikimi i të ardhurave të veta vendore të mbështetet në parashikime reale dhe në analizën e realizimit të viteve të mëparshme, ndërsa planifikimi dhe rishikimi i shpenzimeve buxhetore të jetë në përputhje me nivelin real të të ardhurave të realizuara,

me qëllim përdorimin efektiv të burimeve financiare dhe mbulimin e nevojave prioritare të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi realizimin e të ardhurave (taksa e tarifa vendore), për periudhën objekt auditimi, 01.01.2025 deri më 31.12.2025, rezultoi se për vitin 2025, planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 71,513 mijë lekë dhe niveli i realizimit është në vlerën 66,969 mijë lekë, ose 94 %, me një diferencë mosrealizim të të ardhurave gjithsej kundrejt planifikimit të tyre në buxhetin vendor në vlerën **- 4,544 mijë lekë.** Nga auditimi rezultoi se:
-Treguesi i miratuar i planit vjetor të vitit 2025 është programuar dhe miratuar më i ulët sesa plani i një viti më parë (2024), në shumën -9,290 mijë lekë, ose 11%;
-Treguesi i realizimit të planit vjetor të vitit 2025 rezultoi më i ulët sesa realizimi i të ardhurave i një viti më parë (2024) me diferencë -10,755mijë lekë, ose 14%;
-Niveli i realizimit të të ardhurave faktike ndaj planit vjetor të vitit 2025 është 94 %, nga 96 % që është niveli i realizimit të tyre për vitin paraardhës, (ose 2% më i ulët sesa raporti fakt / plani për të ardhurat e vitit 2024).
Veprimet dhe mosveprimet mbi mosarkërtimin e plotë të të ardhurave janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kreut XI-*"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara",* të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", i ndryshuar, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (Kreu VII "Kontabiliteti i sistemit buxhetor"); Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1.Rekomandimi: Bashkia Dropull, Drejtoria e të Ardhurave dhe strukturat përgjegjëse për administrimin e të ardhurave vendore, të marrin masat për analizimin e shkaqeve të mosrealizimit të të ardhurave kundrejt planifikimit, përmirësimin e metodologjisë së planifikimit dhe forcimin e monitorimit periodik të arkëtimeve, me qëllim rritjen e nivelit të realizimit të të ardhurave vendore dhe përmirësimin e treguesve të arkëtimit krahasuar me vitet paraardhëse.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, rezultoi se sistemi i kontrollit të brendshëm në Bashkinë Dropull vlerësohet ***pjesërisht efektiv***, pasi komponentët e MFK-së nuk funksionojnë plotësisht. Më konkretisht:
- Rregullorja e brendshme nuk përshkruan në mënyrë të plotë proceset kryesore të punës, rrjedhën e tyre, raportimin dhe vendimmarrjen;
-Për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës bazuar në "Kodin punës" nuk janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë, mënyra apo kriteret e rekrutimit/largimit për çdo pozicion.
-Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me Vendimin nr.1 datë 19.01.2025 e Kryetarit të Bashkisë, por nuk është hartuar një rregullore për funksionimin e tij.
-Nga ana strukturave përgjegjëse nuk është hartuar dhe miratuar një udhëzim i brendshëm për monitorimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe mungon një plan veprimi i MFK-së për të monitoruar realizimin e objektivave të institucionit.
-Nuk ka një strategji të miratuar të menaxhimit të riskut apo identifikim të tij, sipas nenit 21 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, si dhe

Udhëzimit nr. 16, dt. 31.12.2024 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e grupit të menaxhimit të risqeve në njësitë publike".
Mjedisi i kontrollit nuk ka përfshirë rregulla dhe procedura të qarta, dhe si pasojë aktivitetet e kontrollit rezultojnë të pamjaftueshme për të siguruar funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
-Mungojnë politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, të cilat përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA, stafit menaxherial dhe punonjësve të këtij institucioni
-Për largimet nga puna, nuk është zbatuar kriteri i përcaktuar ne VKM nr. 124, datë 17.02.2016, Kreu III, pika 29, ku të dokumentohet dorëzimi; i inventarit në ngarkim, i pajisjeve dhe mjeteve të punës në njësinë përgjegjëse si dhe dokumentacioni qe disponon punonjësi për shkak të detyrës.
-Nga ky institucion, nuk është hartuar, miratuar, gjurma e unifikuara e auditimit;
-Programi i përdorur nga sektori i financës për përpunimin e raporteve është *Microsoft Excel*, ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.
-Nuk ka përgatitur rregullore për shërbimin IT, dhe nuk ka sistem rezervë për ruajtjen e të dhënave të menaxhimit financiar IT (back-up) për njësinë.
Sa më sipër, shkaku kryesor për gjendjen e krijuar është mungesa e krijimit të një sistemi të plotë të MFK, mungesa e funksionimit të sistemeve të MFK-së, të cilat sjellin për pasojë që këto sisteme të mos kuptohen nga njësia publike dhe mungesën e reagimit ndaj risqeve të mundshme.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar; "Manualin e MFK", miratuar me Urdhrin nr.4 datë 26.01.2024 të Ministrit të Financave, ligjin nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore",* neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, germa "b"; Udhëzimin nr. 16, datë 13.12.2024 "Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin edhe funksionimin e grupit të menaxhimit të risqeve në njësitë publike", kreu IV, neni 9.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 1, faqe 15-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa për përmirësimi e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me qëllim funksionimin e tyre dhe plotësimin me aktet e nevojshme dhe të merren masa për;

- ✓ Hartimin e planeve operacionale të konsoliduar të punës, me tregues performancë, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
- ✓ Përditësimin e regjistrit të konsoliduar të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.
- ✓ Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike.
- ✓ Monitorimin e vazhdueshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me përgatitjen, paraqitjen dhe depozitimin të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënies Vjetore të mbyllur më 31 Dhjetor 2025, u evidentua se nga ana e Bashkisë Dropull nuk janë zbatuar afatet e detyrueshme për depozitimin e pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Pasqyrat Financiare Vjetore janë depozituar pranë Degës së Thesarit Gjirokastër me shkresën nr. 744 prot., datë 22.04.2026, dhe konfirmuar (nënshkruar e vulosur) nga kjo Degë me datën 22.04.2026. *Sa më sipër,* vepruar në kundërshtim me kërkesat e Kreut V "*Procedurat e paraqitjes dhe raportimit*

të pasqyrave financiare vjetore", paragrafi nr.118, të UMF nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar.
(*Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 57-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa që strukturat përgjegjëse financiare të planifikojnë, koordinojnë dhe ndjekin në kohë procesin e përgatitjes, miratimit dhe depozitimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, duke siguruar respektimin e afateve ligjore të përcaktuara për dorëzimin e tyre brenda muajit mars të vitit pasardhës pranë Degës së Thesarit, Këshillit të Qarkut dhe zyrës së statistikave, me qëllim garantimin e raportimit financiar në kohë, të plotë dhe në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare dhe i dokumentacionit kontabël, rezultoi se Llogaria 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"* paraqitet në Pasqyrën F2 "Pozicioni Financiar" në vlerën 16,665,039 lekë, e cila përputhet me tepricën e llogarisë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit" më datë 31.12.2025. *Megjithatë,* nga verifikimi i tepricave të çeljes së vitit 2025 rezultoi një diferencë prej 3,687,844 lekë ndërmjet tepricës së llogarisë 4342 dhe tepricës së llogarisë 7206 të mbartur nga mbyllja e vitit 2024, duke ndikuar në saktësinë e pozicionit të çeljes së llogarive për vitin 2025, duke cenuar saktësinë e pozicionit financiar në çeljen e vitit 2025. Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme",* i ndryshuar, Kreu III, paragrafi 3.3 si dhe me ndryshimet e përcaktuara në Udhëzimin e MF nr. 5, datë 21.02.2022.
(*Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 57-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që të kryejë analizimin dhe rakordimin e tepricave të llogarisë *4342 "Operacione me shtetin (të drejta)"*, me qëllim eliminimin e mospërputhjeve ndërmjet të dhënave të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare, si dhe sigurimin e klasifikimit dhe paraqitjes së tyre në përputhje me kërkesat e kuadrit normativ në fuqi.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e procesit të rakordimit dhe përputhjes së të dhënave të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënës Vjetore (PFV) të hartuara nga ana e njësisë shpenzuese Bashkia Dropull e të dorëzuara zyrtarisht në Degën e Thesarit, me të dhënat e Pasqyrave Financiare të gjeneruara nga Ministria e Financave në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë *(SIFQ),* kanë rezultuar disa mospërputhje, si vijon:

- ✓ Shuma e aktiveve neto sipas PFV për *vitin 2024* në Pasqyrat Financiare të Bashkisë Dropull është 1,809,695,277 lekë, kurse sipas SIFQ vlera e aktiveve neto/fondeve neto rezultoi 1,733,257,367 lekë. Diferenca e pa kuadruar, pasi hiqet vlera e llogarisë 520 "*Disponibilitete në thesar*" është 10,051,918 lekë.
- ✓ Shuma e aktiveve neto sipas PFV për *vitin 2025* në Pasqyrat Financiare të Bashkisë Dropull është 1,983,732,908 lekë, kurse sipas SIFQ vlera e aktiveve neto/fondeve neto rezultoi 1,843,225,491 lekë. Diferenca e pa kuadruar, pasi hiqet vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" është 23,009,929 lekë.
- ✓ Nga krahasimi i të dhënave të pasqyrave financiare të ngarkuara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) rezultoi se, në të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara me nr. 744 prot, datë 22.04.2026, ekzistojnë mospërputhje të tepricës së llogarive për 7 (shtatë) llogari kontabile, pjesë e PFV të dorëzuara zyrtarisht nga ana e Bashkisë Dropull në Degën e Thesarit Gjirokastër sipas shkresës nr. 744, datë 22.04.2026, për një diferencë prej 43,081,918 lekë, pasi hiqet teprica e llogarisë 520.
- ✓ Nga auditimi mbi informacionin shpjegues pasqyruar në Formatin nr. 5 të Pasqyrave Financiare Vjetore, "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare

vjetore, viti 2025", në rubrikën "*Diferenca midis pasqyrave financiare të njësisë raportuese dhe PF të gjeneruara nga Ministria e Financave në SIFQ",* nuk ka asnjë shënim mbi këto diferenca të rezultuara.

Sa më sipër, veprime në kundërshtim me përcaktimet e pikës 14, Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ", të Udhëzimit të MFE nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar si dhe pikën 10, të UMF nr.127, datë 19.12.2025 "Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025", që përcakton se "*Të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara duhet të jenë të njëjta me të dhënat e gjeneruara nga SIFQ".*

(*Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 57-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi: Bashkia Dropull, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa për zbatimin e një procesi të detyrueshëm rakordimi dhe verifikimi paraprak të Pasqyrave Financiare Vjetore me të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), duke siguruar që të dhënat e raportuara të jenë të njëjta, si dhe analizimin, dokumentimin dhe korrigjimin e të gjitha diferencave të konstatuara para protokollimit dhe depozitimit të tyre në Degën e Thesarit, krahas pasqyrimit të këtyre diferencave nëse ato ekzistojnë, në Formatin nr. 5 "Pyetësor dhe shënime shpjeguese", të Pasqyrave Financiare Vjetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për inventarizimin e pasurisë për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve si dhe përdorimin në mënyrën e duhur e me eficiencë të tyre, janë konstatuar disa mangësi në lidhje me rregullushmërinë e dokumentacionit dhe rakordimin e brendshëm.

-Në inventarizimin e pasurisë për vitin 2025, sipas urdhrit të Kryetarit të Bashkisë me nr. 266, datë 29.12.2025, nga ana e komisionit të inventarizimit janë nënshkruar fletët e inventarizimit për gjendjen kontabile dhe fizike të zërit *"Studime e projektime"* por, pa testuar ekzistencën e dokumentuar të këtyre studime-projektimeve, si dhe mungon nënshkrimi nga personi përgjegjës që i ka në ngarkim/ arkivuar këto aktive afatgjata jomateriale.

- Nga analiza e tepricës së llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime" në fund të vitit 2025, u konstatua se në vlerën totale të llogarisë prej 11,113,821 lekë, është përfshirë shuma prej 6,135,107 lekë që i përket vlerës së disa projekt-studime për investime, e pa shpërndarë sipas llojit të aktiveve afatgjata materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika16/b. d, Kreu III. pika 36, Aneksi 1, pika 2, Klasa 2; si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 30-35, Kreu IV pika 75,

(*Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 57-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë inventarizimin fizik të studim-projektimeve të blera, gjendje e llog. 202 *"Studime dhe Kërkime",* si dhe të bëjë shpërndarjen e vlerës së tyre sipas llojit të aktivit të kapitalizuar, të përllogarisë amortizimin për to sipas normës dhe metodës së miratuar, duke i kryer veprimet sistemuese kontabël në llogaritë përkatëse dhe efektet të reflektohen edhe në kartelën shoqëruese përkatëse.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të Klasës 21-të, "*Aktivet afatgjata materiale"* rezultoi se: Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë (210) *"Toka, troje terrene"*

dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në Pasqyrat Financiare është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të. Nuk ka informacion mbi shumën prej 198,582 lekë e trashëguar në bilancet e ish Komunave ngase përbëhet. Mungesa e informacionit kontabël për këtë llogari ndikon në informacionin që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, me efekt në procesin e inventarizimit fizik të tyre. Në llog. 210 nuk janë përfshirë vlera e truallit për 90 aktive ndërtimore /aktive afatgjata materiale (llog.212), në pronësi të Bashkisë Dropull. U konstatua se nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të trojeve nën objekt për ndërtesat e shkollave, kopshteve, qendrave shëndetësore, vatrave të kulturës, Zyrave të Bashkisë Jorgucat, si dhe të zyrave të Nj.A-ve, Qendra Kulturore, etj., të cilat Bashkia Dropull i ka në administrim sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione". Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse i trojeve të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë për 52 (pesëdhjetë e dy) zëra të tokave dhe trojeve.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar. (*Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 57-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1.Rekomandimi: Bashkia Dropull, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë veprimet e nevojshme për analizimin dhe dokumentimin e plotë të objekteve të evidentuara në llogarinë 210 "*Toka, troje terrene"*, duke saktësuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet, bazuar dhe në rezultatet e inventarizimit fizik të këtyre pasurive.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të Klasës 20-të, *"Aktivet afatgjata materiale*" rezultoi se Llogaria 211 *"Pyje, kullota, plantacione"* në datën 01.01.2025, është kontabilzuar me vlerë neto kontabël 0 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime dhe gjendja kontabël sipas kostos historike e kësaj llogarie më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën zero lekë.

Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga ana e Bashkisë Dropull, rezultoi se janë hipotekuar 11 artikuj në zërin kadastral "Kullotë", të cilat ndonëse janë pronë e kësaj Bashkie, nuk janë përfshirë në kontabilitet dhe në Pasqyrat Financiare të Llogaridhënies Vjetore,

Kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025, pasi në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të kaluara me VKM nr. 433, dt. 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive", pika 3, shtojca me nr.1, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Dropull.

Për këto prona nuk është kryer verifikim fizik në lidhje me gjendjen e tyre për vitin 2025. Veprime këto në kundërshtim me, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, pika 30. (*Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 57-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1.Rekomandimi: Bashkia Dropull, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për analizimin dhe dokumentimin e plotë të objekteve të evidentuara në llogarinë 211 *"Pyje, kullota, plantacione"*, duke saktësuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet, bazuar dhe në rezultatet e inventarizimit fizik të këtyre pasurive.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Bashkisë Dropull nuk është kryer kontabilizimi i të gjithë pronave publike në pronësi të saj dhe të regjistruara në ASHK.
Nga ana e Bashkisë nuk disponohet një regjistër i konsoliduar i aseteve për pronat publike, përfshirë kullotat, pyjet dhe sipërfaqet e tjera, si dhe nuk është kryer vlerësimi dhe inventarizimi i tyre. Mungesa e certifikatave të pronësisë ka penguar pasqyrimin kontabël të aktiveve, duke ndikuar në saktësinë e bilancit dhe në aftësinë e njësisë për të menaxhuar pasurinë publike në mënyrë të plotë.
Pavarësisht aplikimeve të kryera nga ish-komunat dhe njësitë administrative për pajisjen me certifikatë pronësie, përfshirë 46 prona me vlerë 332,000 lekë dhe 91 prona me vlerë 502,600 lekë, procesi nuk është finalizuar. Kërkesat zyrtare janë dokumentuar me shkresën nr. 180 prot., datë 25.05.2015 dhe nr. 1815 prot., datë 16.10.2019, por nuk rezultoi të jetë marrë përgjigje nga ana e ASHK-së. Si pasojë, nga 193 prona të pasqyruara në inventar me kosto historike, Bashkia Dropull nuk posedon tituj pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, me pikën 1 dhe 2, kreu VI të VKM nr. 510, datë 14.08.2001, *"Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme"* dhe Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, *"Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore"*.
(*Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 57-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
12.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dropull, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për evidentimin dhe konsolidimin e informacionit mbi pronat publike në pronësi të Bashkisë, përfshirë pyjet, kullotat dhe sipërfaqet e tjera, duke vijuar procedurat për regjistrimin dhe pajisjen me dokumentacionin e pronësisë pranë ASHK-së, si dhe për inventarizimin, vlerësimin dhe pasqyrimin e tyre në kontabilitet, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim sigurimin e administrimit të plotë dhe të saktë të pasurisë publike dhe paraqitjen e drejtë të aktiveve në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i menaxhimit të aktiveve u konstatua se Bashkia Dropull ka hartuar "Manualin e proceseve për Menaxhimin e Aktiveve", miratuar me shkresën nr. 1926/1, datë 29.12.2023, nga Kryetari i Bashkisë. Megjithatë, krahas këtij dokumenti, nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Pronave Publike Vendore dhe të Rregullores për miradministrimin e aktiveve, si dokumente që përcaktojnë kuadrin e menaxhimit dhe administrimit të aktiveve dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore për një periudhë afatmesme, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07. 2010 i ndryshuar; Udhëzimit nr. 30, datë2011, si dhe Kreut II, pika 20, të Udhëzimit të MF nr.35, datë 29.12.2023 *"Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare të NJQV-të".*
(*Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 57-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
13.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të marrë masat për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Pronave Publike Vendore dhe të Rregullores për Menaxhimin e Aktiveve, si dokumente bazë për

administrimin, mbrojtjen, inventarizimin, vlerësimin dhe përdorimin me efektivitet të aktiveve publike të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
Strategjia për Menaxhimin e Pronave Publike Vendore të miratohet nga Këshilli i Bashkisë Dropull me qëllim forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe garantimin e një menaxhimi efektiv, ekonomik dhe transparent të aktiveve vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i gjendjes së llogarisë 212 "*Ndërtesa Konstruksione*" (kosto historike) u konstatua se në këtë llogari, vlerat e rikonstruksioneve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit nuk janë shtuar vlerës së aktivit fillestar pas investimeve të kryera.
- Bashkia Dropull, nuk ka trashëguar dokumentacionin e duhur për asetet e ish-Komunave *(të tilla si, harta topografike, planimetri të objekteve, koordinata të vendndodhjes së tyre, etj.).* Kjo situatë e mungesës së dokumentacionit teknik ka krijuar probleme për administrimin e aseteve të kësaj bashkie. Bashkimi i aseteve nga ish-komunat, është realizuar nga bashkimi i vlerave te bilanceve të tyre, në të cilët vlerat e pasqyruara me postet e aktivit dhe pasivit rezultojnë pa analizë, pa mbështetje dhe rakordim me inventarë të rregullta të vlerave të Aktiveve të Afatgjata Materiale dhe Aktiveve Qarkulluese. Nga auditimi i dokumentacionit të Bashkisë Dropull rezulton se, mbi 11 (njëmbëdhjetë) aktive afatgjata/ pasuri që administrohen nga Bashkia Dropull, në fakt janë të kontabilizuara sipas të dhënave që i përkasin periudhave të ndryshme kohore dhe kjo tregon për një pasaktësi në evidentimin e gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me konfirmimin e dokumentacionit financiar dhe se ky informacion kontabël nuk pasqyron gjendjen e vërtetë vlerore të këtyre pasurive.
- Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Dropull ka në administrim 1 (një) banesë të llojit *apartament*, me numër pasurie 3/58+3-1 dhe numër hipotekimi 603069, regjistruar në ZK 3833 e përfshirë në të dhënat e pyetësorëve të plotësuar nga Bashkia Dropull, por që nuk rezultoi i kontabilizuar në llogarinë 212 "Ndërtesa" dhe e pa përfshirë në Regjistrin e Aktiveve të kësaj Bashkie. *Për sa më sipër*, Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione" nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025.
- Nga auditimi i gjendjes së llogarisë 212 "*Ndërtesa Konstruksione*" (kosto historike) u konstatua se Bashkia Dropull ka të evidentuara disa objekte të cilat janë të pa analizuara. Kështu, zëri "*Përmirësimi i banesave ekzistuese/ndërtimi i ri për komunitetet të varfra dhe të pa favorizuara"* është në vlerën prej **4,776,356 lekë** dhe i pa detajuar. Aktivet e mësipërme të kontabilizuara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione", nuk janë aktive në posedim të Bashkisë Dropull. Këto zëra shpenzimesh janë kryer për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, të cilët nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme, prandaj ato nuk mund të kapitalizohen pasi nuk lidhen me asnjë nga aktivet e kësaj Bashkie, ndaj rezulton mbivlerësim i kësaj llogarie për këtë shumë. Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me paragrafin 7, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit Nr.5 (SKK5) i përmirësuar dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar.
(*Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 57-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>14.1.Rekomandimi</u>:
Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Dropull të marrë masa për kryerjen e inventarizimit dhe rakordimit të plotë të aktiveve afatgjata materiale me regjistrat kontabël, regjistrin e aktiveve dhe dokumentacionin teknik e ligjor, me fokus të veçantë në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione", duke identifikuar dhe dokumentuar pasuritë e trashëguara, regjistruar aktivet e paevidentuara dhe kapitalizuar investimet që plotësojnë kriteret për njohje si aktive. Gjithashtu, të

verifikohet dhe kryhet sistemimi i trajtimit kontabël të aktiveve të regjistruara që nuk plotësojnë kriteret e njohjes si aktive të Bashkisë, përfshirë investimet në favor të komunitetit, si dhe të sigurohet klasifikimi i saktë i shpenzimeve/transfertave në kuadër të programeve sociale, sipas natyrës së tyre ekonomike, në koordinim me Ministrinë përgjegjëse për financat, me qëllim paraqitjen e drejtë dhe të besueshme të aktiveve dhe pasqyrave financiare.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

14.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Dropull për projektet që do të zbatohen në kuadër të programeve sociale, të sigurojë klasifikimin korrekt të shpenzimeve në përputhje me natyrën e tyre ekonomike, duke i njohur ato si shpenzime/transferta dhe jo si aktive afatgjata, kjo në koordinim me Ministrinë përgjegjëse për financat, në mënyrë që të garantohet paraqitja e drejtë dhe e besueshme e pasqyrave financiare.

Në vijimësi

15. **Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i gjendjes së llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore"* rezultojnë se për 6 (gjashtë) objekte të ujësjellësit, në vlerën **932,669,760 lekë** sipas kostos historike,të cilat janë asete të Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sha, nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat për transferimin për "Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastër Sha", në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimi e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" Kreu II, pika 14; me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, dhe VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura", Kreu II, pika 14.
(*Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 57-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
15.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Bashkinë Dropull dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa që të kryejnë procedurat ligjore për transferimin e aktiveve që i përkasin ujësjellësve të rrjetit shpërndarës, depo dhe pompa uji në "Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër" sha dhe më pas të kryhen veprimet sistemuese kontabël në llog. 213 *"Rrugë, rrjete, vepra ujore".*

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi:
Nga auditimi i dokumentacionit të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" u konstatua se, në fund të vitit 2025, në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore është pasqyruar vetëm shuma prej 1,776,500 lekë, që përfaqëson donacionin e Bashkisë Dropull, sipas Aktit të Themelimit të Fondacionit "Akademia Sportive "L.M". Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se aksionet/pjesëmarrja e Bashkisë Dropull në "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh.a.", me vlerë 705,000 lekë, nuk janë kontabilizuar, duke sjellë nënvlerësimin e llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" në të njëjtën shumë.
Mos pasqyrimi i aktiveve financiare në kontabilitet, është veprim në kundërshtim me Kreun I, pika 3.1 paragrafi nr. 31, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e

qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 57-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marre masa për kryerjen e veprimeve sistemuese kontabël për paraqitjen e drejtë të pjesës së kapitaleve të Bashkisë Dropull në "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh.a" dhe Fondacionin "Akademia Sportive "L.M", duke kryer sistemimet në llogaritë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalin e vet*" dhe në llog. 1011*"Shtesa të fondit bazë".*

Deri me datë 31.12.2026

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të llogarisë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* u konstatua se, në fund të vitit 2025, në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore është pasqyruar vetëm shuma prej 1,776,500 lekë, që përfaqëson donacionin e Bashkisë Dropull, sipas Aktit të Themelimit të Fondacionit "Akademia Sportive "L.M"". Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se aksionet/pjesëmarrja e Bashkisë Dropull në "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh.a", me vlerë 705,000 lekë, nuk janë kontabilizuar, duke sjellë nënvlerësimin e llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" në të njëjtën shumë. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 57-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në koordinim me strukturat përgjegjëse në Bashkinë Dropull, të marrin masa duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshme që për punimet e përfunduara dhe të marra në dorëzim konformë përcaktimeve në kontratës, të bëjnë njoftimet e subjekteve për tërheqjen e garancive të punimeve. Në rast mos plotësimi të kushteve ose refuzimit nga subjektet në zbatim të dispozitave ligjore të bashkëpunohet me Degën e Thesarit për kalimin e këtyre fondeve në favor të autoritetit kontraktor, si e ardhur për mospërmbushje të rregullt të kushteve të kontratës.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për inventarizimin e pasurisë për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve si dhe përdorimin në mënyrën e duhur e më eficiencë të tyre, janë konstatuar disa mangësi të evidentuara në zbatimin e proceseve dhe procedurave të inventarizimit të pasurisë, lidhur me saktësinë dhe rregullshmërinë e dokumentacionit dhe rakordimin e brendshëm.

-Si referencë ligjore në urdhrin e krijimit të komisionit të inventarizimit të pasurisë është vendosur ligji për administrimin dhe qarkullimin e vlerave monetare e materiale, dispozitë e shfuqizuar nga ligji nr.10296/2010 i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij

- Komisioni i inventarizimit fizik të aktiveve nuk ka përpiluar proces verbalet për çdo njësi të strukturës të përfshirë në procesin e inventarizimit, në kundërshtim me pikën 85/a të Udhëzimit nr. 30/2011, por ka hartuar vetëm Relacionin përmbledhës mbështetur mbi shënimet tek kartela kontabël e vënë në dispozicion nga zyra e financës.
- Nuk janë kërkuar dhe administruar të dhënat brenda muajit Qershor të vitit 2025, nga shoqëritë tregtare në të cilat Bashkia Dropull zotëron kuota apo të drejta (SHRUK Gjirokastër), si kopje të pasqyrave financiare vjetore të vitit paraardhës, si dhe të vendimit të asamblesë se përgjithshme për miratimin e pasqyrave financiare, rezultatit vjetor dhe destinacionin e fitimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, Manualin e MFK si dhe Udhëzimin e MF nr. 30/2011.
- Nga auditimi u konstatua se njësia shpenzuese Bashkia Dropull ka bërë procesin e inventarizimit, por nuk ka kryer procesin e vlerësimit të aktiveve dhe të nxjerrjes jashtë përdorimit e asgjësimin të aktiveve të dëmtuara e që janë jashtë funksionit.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar neni 8 germa (ç) neni 9 germa (ë) dhe UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 23, 74, 85/c.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 57-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
18.1. Rekomandimi: Bashkia Dropull të marrë masa të standardizojë dhe dokumentojë procesin e inventarizimit të aktiveve, duke siguruar zbatimin e të gjitha fazave të tij *(inventarizim, vlerësim, rakordim, nxjerrje jashtë përdorimit dhe asgjësim)*, si dhe të vendosë mekanizma monitorimi për administrimin e dokumentacionit financiar të entiteteve ku Bashkia zotëron pjesëmarrje. Në këtë kuadër, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të Bashkisë Dropull, të marrin masa për ngritjen e komisionit për vlerësimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të dëmtuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezultoi se, Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Dropull është dërguar me shkresën nr. 320/10, datë 22.09.2025, (protokolluar në këtë institucion me nr. 753/25, datë 25.09.2025). ku janë lënë për zbatim 22 rekomandime.
Nga verifikimi rezultoi se nga ana e Bashkisë Dropull nuk është dërguar informacion në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. *154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*
Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit:
a. Janë rekomanduar 15 masa organizative, (6 prej tyre te lidhura me Auditimin Financiar);
b. Janë rekomanduar 5 masa shpërblim dëmi (0 prej tyre te lidhura me Auditimin Financiar)
c. Janë 2 dy rekomandime për Kryetarin e Bashkisë Dropull që të shqyrtojë raportin përfundimtar të auditimit dhe ti kërkojë komisionit vendosjen e masave disiplinore për personat të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar.
-Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH është 100 %.
-Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara, që i përkasin auditimit financiar paraqitet si më poshtë: Nga 7 masa organizative janë zbatuar pjesërisht 6 dhe 1 masë e pa zbatuar; Për masat disiplinore nga 2 masa të rekomanduara rezultojnë 2 masa të pa zbatuara.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 4, faqe 112-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
19.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë, duke marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe atyre në proces zbatimi si më poshtë:

Masa Organizative
1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull, Drejtorët e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me qëllim funksionimin e tyre dhe plotësimin me aktet e nevojshme, si dhe të merren masa për:
-Hartimin e planeve operacionale të konsoliduar të punës, me tregues performancë, ku përgjegjësitë për zbatimin e objektivave të jenë ndarë në mënyrë të qartë dhe të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.
-Përditësimin e regjistrit të konsoliduar të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.
-Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike.

-Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që me hartimin e PBA-së dhe Planit vjetor të buxhetit, të sigurojë planifikimin dhe ndarjen e fondeve në përputhje me funksionet e vetëqeverisjes vendore.

- Në ketë kuadër, të sigurohet vlerësimi dhe financimi i programeve që aktualisht janë neglizhuar ose me planifikim të ulet, si: menaxhimi i ujerave të zeza dhe kanalizimeve, ndërgjegjësimi mjedisor, shërbimi mjedisor, marrëdhëniet në komunitet dhe mbështetja për zhvillimin ekonomik dhe inspektimi i tregjeve.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Dropull dhe Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifave Vendore, të ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e arkëtimit të detyrimeve të prapambetura duke përfshirë hartimin e një plani veprimi për arkëtimin e borxheve, dërgimin e njoftimeve formale për detyrimet e prapambetura si edhe vendosjen e afateve për pagesë vullnetare dhe ndjekjen me masa ligjore në rast mospagimi. Gjithashtu, të merren masa për krijim e një sistemi të përditësuar elektronik për monitorimin e raportimit të brendshëm.

4.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masat e duhura për regjistrimin e 198 objekteve të pasurive të paluajtshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim dokumentimin me akte pronësie të aktiveve kapitale në pasqyrat financiare të Njësisë.

8.1 Rekomandimi (*rikërkuar*): Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, të kryhej analizat e situatës së aktiveve të Njësisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masat e duhura për evidencimin e sipërfaqeve të pyjeve e kullotave të kaluara në administrim të Bashkisë Dropull me VKM përkatëse, edhe nëse ato janë të pa vlerësuara, të evidentohen në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull nëpërmjet Sektorit të Buxhetit dhe Menaxhimit të Asteve të ndërmarrë veprime për pajisjen me certifikata pronësie për asetet publike në përdorim dhe pronësi, duke ndjekur procedurat dhe duke koordinuar punën në mënyrë të vazhdueshme me DVASHK Gjirokastër për sigurimin e dokumentacionit vërtetues me titull pronësie për pronat;
"toka, troje, terrene, pyje, plantacione, ndërtesa dhe konstruksione", për garantimin e sigurisë juridike mbi pronat, pasqyrimin e saktë kontabël dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore për menaxhimin e pasurisë publike.

11.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të kryejë ristrukturimin e strukturës organizative me qëllim krijimin e një sektori të posaçëm për administrimin e aseteve publike. Ky sektor duhet të ngarkohet me përditësimin e regjistrit të aseteve, ndjekjen e procedurave për regjistrim dhe pajisje me tituj pronësie, vlerësimin financiar të pronave dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare.

Njoftimi i Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Mbikëqyrjes të Shërbimit Civil

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, Bashkia Dropull pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me përgatitjen, paraqitjen dhe depozitimin të Pasqyrave Financiare Vjetore të mbyllur më 31 dhjetor 2025, rezultoi një nivel i lartë i detyrimeve debitore ***(llog.468)*** në Bashkinë Dropull në vlerën **12,469,452 lekë**. Detyrimet debitorë janë pakësuar gjatë vitit vetëm për - 457,233 lekë, (ose - 3.5 % më pak se fundi i vitit të mëparshëm), ku shtesat e llogarisë së debitorëve janë 3,064,255 lekë dhe likuidimet/ shlyerjet për 3,521,488 lekë. Në këtë llogari përfshihen detyrime të mbartura nga abonentët familjarë dhe subjektet e biznesit, si dhe detyrime të subjekteve të evidentuara në raportet e auditimit të KLSH-së ndër vite.

-U konstatua një nivel i lartë i detyrimeve të mbartura e të trashëguara për taksat e tokës bujqësore, të biznesit, të ndërtesave etj., nga vitet e mëparshme *(2011-2024),* në shumën **6,810,589 lekë** ose 54.6 % e shumave të regjistruara në llog. 468. Rezultoi se për Njësitë Administrative Dropull i Poshtëm, Pogon dhe Dropull i Sipërm detyrimet debitore që lidhen me mos likuidimin e taksës së tokës dhe të ndërtesës, i përkasin periudhës 2011-2024**.** Ky problem është trajtuar edhe në raportet e mëparshëm të auditimit të KLSH-së, ku është rekomanduar për gjetjen e origjinës nga ka lindur detyrimi, arkëtimin e këtyre vlerave, deri në ngritjen e padive gjyqësore, por mungojnë veprimet korrigjuese për sa më sipër.

-Detyrimet e papaguara për taksa dhe tarifa vendore më datë 31.12.2024 janë **7.204.061 lekë**.

-Detyrimet e likuiduara gjatë vitit 2025 janë në shumën **2.671.821 lekë**.

-Detyrimet e krijuara gjatë vitit 2025 prej **2.278.349 lekë**, *përbëhen nga,*

- Detyrimi që subjektet fizikë/juridikë kanë ndaj Bashkisë Dropull për taksa e tarifa në fund të vitit 2025 është 341.262 lekë.
- Detyrimi që subjektet familjare kanë ndaj Bashkisë Dropull për taksa e tarifa në fund të vitit 2025 është 1.937.067 lekë.

Gjendja progresive e detyrimeve tatimore më datë 31.12.2025 prej* 6.810.589 lekë*, përfshin:

- Gjendjen e detyrimeve për taksa e tarifa, që në trajtë progresive në fund të vitit 2025 për subjektet fizikë/juridikë është **1,134,390 lekë.**
- Gjendjen e detyrimeve për taksa e tarifa,që në trajtë progresive në fund të vitit për abonentët familjarë është **5,676,199 lekë.**

Nga ana e Bashkisë së Dropullit nuk janë kryer procedurat e kërkimit të detyrimeve në rrugë administrative e gjyqësore. Mosarkëtimi në afat i debitorëve sjell riskun e parashkrimit për arkëtimin e të drejtave dhe të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit dhe veprime në jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë "i ndryshuar*; nenet 8, 9, 10, 11, 12 dhe 27 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, si dhe Manualit të Menaxhimit Financiar e Kontrollit, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 26.01.2024 të Ministrit të Financave, (Kreu II, paragrafët 2.4.4 dhe 2.4.6 dhe aneksi nr. 6); Udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "*Për nëpunësin zbatues të të gjitha niveleve",* Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 3.12.2024 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe*

koordinatorit të riskut në njësitë publike"; pikën 7, të Udhëzimit të MF nr.5, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*
(*Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 57-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për të ardhurat dhe financat, të marrë masa për evidentimin, ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve debitorëve në shumën **12,469,452 lekë,** (ku nga kjo, gjendja progresive e detyrimeve tatimore të papaguara më datë 31.12.2025 është 6.810.589 lekë), duke vendosur procedura të dokumentuara për monitorimin periodik të debitorëve dhe marrjen e masave ligjore për arkëtimin e tyre. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi, të cilat janë të parashkruara dhe të paarkëtueshme dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitore, me qëllim paraqitjen sa më të saktë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE
Mbështetur në Nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "*Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Dropull, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkallën e shkeljes.

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT